




Republika e Serbisë  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS  
DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË  
SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PËRMBLEDHJE DETYRASH NGA

# GJUHA SHQIPE

PËR PROVIMIN E FUNDIT NË ARSIMIN DHE EDUKIMIN FILLOR  
PËR VITIN SHKOLLOR 2013/2014





Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK

ENTI PËR VLERËSIM TË CILËSISË  
SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PËRMBLEDHJE DETYRASH NGA

# GJUHA SHQIPE

PËR PROVIMIN E FUNDIT NË ARSIMIN DHE EDUKIMIN FILLOR  
PËR VITIN SHKOLLOR 2013/2014

## *Autorë*

Dr. Naile Mala Imami, Fakulteti Filologjik në Beograd

Qenan Hetemi, Shkolla fillore “Dituria”, Corroticë, Preshevë

Naser Zairi, Shkolla fillore “Muharrem Kadriu”, Tërrnoc, Bujanoc

Daljan Saliji, Shkolla fillore “Ali Bektashi”, Bujanoc

Mentor Nuhiu, Preshevë

Ymer Kamberi Shkolla fillore “Ibrahim Kelmendi”, Preshevë

Hidajete Haliti, „Shkolla e Mesme Teknike”, Preshevë

Bejzad Abdullahu, Shkolla e Mesme “Sezai Surroi”, Bujanoc

Beograd, 2014

**PËRMBLEDHJE DETYRASH NGA GJUHA SHQIPE  
PËR PROVIMIN E FUNDIT NË ARSIMIN DHE EDUKIMIN FILLOR  
PËR VITIN SHKOLLOR 2013/2014**

**Botues**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Zhvillimit Teknologjik e Republikës së Serbisë  
Enti për Vlerësimin e Cilësisë së Arsimit dhe të Edukimit

**Për botuesin**

Dr. Tomislav Jovanović, ministër i Arsimit, Shkencës dhe i Zhvillimit Teknologjik  
Mr. Dragan Baniqević, drejtor i Entit për Vlerësimin e Cilësisë së Arsimit dhe të Edukimit

**Redaktore**

Naile Mala-Imami

Lektor:

Mentor Nuhiu

## Të dashur nxënës

Para jush e keni Përmbledhjen e detyrave nga gjuha shqipe. Përmbledhja do t'ju ndihmojë që të ushtroni dhe të verifikoni njohurinë për dhënien e provimit të fundit. Sipas ndërlikueshmërisë së kërkesave detyrat janë radhitur në nivel bazë, të mesëm dhe të përparuar. Në kuadër të secilit nivel detyrat janë grupuar në katër fusha? Shkathësia e të lexuarit dhe të kuptuarit e tekstit të lexuar, Të shprehurit me shkrim, Gramatika, leksiku, gjuha popullore dhe letrare dhe Letërsia. Në pjesën e fundit të Përmbledhjes gjenden zgjidhjet e detyrave, si edhe lista e standardeve arsimore e cila anketohet me detyrat nga Përmbledhja.

Testi të cilin do ta zgjidhni në provim të fundit i përmban detyrat me të cilat anketohet realizueshmëria e standardeve arsimore në të tri nivelet – bazë, të mesëm dhe të përparuar.

Ju dëshirojmë punë të mbarë dhe të suksesshme!

Autorët

t



Përmbajtja

<b>NIVELI BAZË</b>	<b>7</b>
Shkathësitë e të lexuarit dhe të kuptuarit e leximit	7
Të shprehurit me shkrim	20
Gramatika, leksiku, gjuha popullore dhe letrare	25
Letërsia	39
<b>NIVELI I MESËM</b>	<b>46</b>
Shkathësitë e të lexuarit dhe të kuptuarit e leximit	46
Të shprehurit me shkrim	57
Gramatika, leksiku, gjuha popullore dhe letrare	60
Letërsia	69
<b>NIVELI I PËRPARUAR</b>	<b>81</b>
Shkathësitë e të lexuarit dhe të kuptuarit e leximit	81
Të shprehurit me shkrim	89
Gramatika, leksiku, gjuha popullore dhe letrare	90
Letërsia	97
Zgjidhjet	115
<b>LISTA E STANDARDEVE PËR ARSIM TË CILAT ANKETOHEN ME DETYRAT NË PROVIMIN E FUNDIT</b>	<b>135</b>
NIVELI BAZË	135
NIVELI I MESËM	137
NIVELI I PËRPARUAR	139



# NIVELI BAZË

## Shkathtësitë e të lexuarit dhe të kuptuarit e leximit

1. Lexo tekstin e mëposhtëm dhe rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

Filmi “Harry Potter And The Order Of The Phoenix” ka grumbulluar jo më pak se 140 milionë dollarë në kinematë amerikane, për pesë ditë të shfaqjes së tij, përfshirë këtu edhe 77 milionë të fituar gjatë fundjavës.

Vazhdimi i pestë i serisë për magjistarin e ri, e ka thyer rekordin e premierave në mesin e javës së kaluar, duke sjellë përfitime më të mëdha nga “ish-kampioni” i përfitimeve, vazhdimi i dytë i filmit “Shrek” i cili, për pesë ditë nxori përfitime prej rreth 129 milionë dollarësh.

Teksti i dhënë:

- a) Përshkruan
  - b) Komenton
  - c) Përkufizon
  - d) Informon
- 

2. Lexo poezinë dhe shkruaj se çfarë teksti është:

Në mes tuaj kam qëndruar  
E jam duke përvëlur  
Që t’u ap pakëz dritë  
Natën t’ua bënj ditë

Do të tretem, të kullohem  
Të digjem të përvëlohem  
Që t’u ndrinj mirë e të shihni  
Njëri tjatin të njihni...

N.Frashëri

- a) jo letrar
- b) letrar



3. **FILMI “Djemtë e Rrugës”** i regjisorit Halil Budakova nga Kosova i ka grumbulluar rreth 200 mijë euro në kinematë kosovare brenda një jave sa është shfaqur, pa i llogaritur edhe 50 mijë euro të tjera të cilat i ka grumbulluar brenda javës së fundit të janarit.

**FILMI** në fjalë ka arritur popullaritet të madh dhe nga kritika është vlerësuar njëri ndër filmat më të mirë të realizuar në dhjetëvjetëshin e fundit.

Teksti i dhënë është

- a) Përshkrues
- b) Informues
- c) Përkufizues
- d) Kritikë

4. Janë dhënë dy shpjegime. Rretho shkronjën para përgjigjes në të cilën bëhet fjalë për argumentim:

- a) Paraqit argumente për një çështje, vërteto me argumente, sill prova.
- b) Pjesë e një teksti të shkruar, që përfshin fjalitë nga njëra kryeradhë te tjetra dhe që shpreh një mendim pak a shumë të plotë e të pavarur; nëndarje e një kapitulli, e një ligji etj., që fillon me kryeradhë dhe me një shenjë të posaçme.

5. Ilira dhe Genti janë motër e vëlla. Ata jetojnë në Tiranë në një apartament në qendër të qytetit. Dëshira e tyre më e madhe është të kenë një qen me të cilin të kalojnë ditën.

Një ditë ata ua shprehën prindërve dëshirën e tyre. Mami dhe babi i dëgjuan me vëmendje. Në fund ata u thanë se s'mund t'ua plotësonin këtë dëshirë. Qenushi kërkonte kujdes. Shtëpia e tyre ishte shumë e vogël dhe gjatë ditës aty nuk kishte njeri. Donte edhe kohë për t'i përgatitur ushqimin, për ta larë, për ta shëtitur etj.

Genti u mërzi shumë. Papritur iu kujtua diçka. Mori albumin e fotove dhe menjëherë shkoi pranë mamit. Në një foto kishte dalë mami e vogël me një qen me emrin Tomo. Mami i kishte treguar histori shumë të bukura për qenin e saj. Ai i mbante mend të gjitha dhe kënaqej sa herë i dëgjonte.

- Mami, unë dhe Ilira duam që ju ta mendoni dhe një herë dëshirën tonë.

Pas disa ditësh Ilira dhe Genti mbetën të habitur kur panë mamin dhe babin me një qen të vogël në dorë.

- Tani kujdesuni dhe kënaquni me qenin tuaj, ashtu sikur jam gëzuar unë kur kam qenë e vogël, - iu tha mami.

Sa shumë u gëzuan fëmijët!

Lexo tekstin e dhënë dhe shkruaj llojin e fjalëve të nënvizuara. Ato janë:

- a) Folje
- b) Emra
- c) Mbiemra
- d) Lidhëza

6. Nëse teksti është administrativ, pas tij në vijë shkruaj "A", nëse është publicistik, shkruaj "P", e nëse është shkencor, shkruaj "SH":

a) Paraqitja për sezonin e sivjemë të kampioneve të ne dhe në botë ka filluar në fillim të marsit dhe deri më tani, siç mësojmë nga organizuesit e shoqatës "Hulumtuesit e rinj", janë paraqitur 430 vullnetarë të rinj. Janë edhe 1.700 vende të lira, dhe paraqitja mund të bëhet derisa të plotësohen të gjitha kampet. \_\_\_\_\_

b) Fjalët *u, do, të, me, për, pa, duke*, më përfshihen të pjesëzat që shërbejnë për të ndërtuar forma gramatikore foljore dhe shkallët e mbiemrave e të ndajfoljeve. Kur përdoren një varg kallëzuesish homogjenë, pjesëzat që shërbejnë për të ndërtuar forma gramatikore të foljeve përsëriten para çdo kallëzuesi:

Pjesëza *të* para lidhore shkruhet gjithmonë kur përsëritet trajta foljore:

*Unë mendoj të takohemi e të bisedojmë të gjithë bashkë sa më shpejt.*

Po kështu shkruhen të plota me *do të* dhe format foljore të së ardhmes dëftore dhe të kushtores:

*Do të shkoj, do të studioj gjendjen dhe pastaj do të të informoj për gjithçka.*

*Po të kisha ditur, do të kisha nxituar e do të kishim vajtur bashkë atje.* \_\_\_\_\_

c) Mbrojtësi i qytetarëve është organ i pavarur shtetëror i cili i mbron të drejtat e qytetarëve dhe e kontrollon punën e organeve të administratës shtetërore, organit kompetent për mbrojtjen juridike të të drejtave pronësore dhe interesave të shtetit, si edhe organeve dhe organizatave tjera, ndërmarrjeve dhe institucioneve të cilave u besohen autorizimet publike. \_\_\_\_\_

7. Dy tekste të poshtëshënuara janë të ndryshëm në mes veti, njëri është administrativë (A), Ndërsa tjetri është publicistik(P)

a) Sezoni i këtij viti do të jetë i veçantë, sepse tek ne ka filluar në fillim të janarit anëtarësimi i të rinjëve për punë vullnetare. Për punë vullnetare shoqata "Bamirësia" ka arritur t' i regjistrojë mbi 350 të rinjë, të moshave të ndryshme. Në shoqatë mund të regjistrohen edhe 150 të rinjë dhe paraqitja mund të bëhet derisa të plotësohet numri i përgjithshëm prej 500 vetash

\_\_\_\_\_

b) Liria dhe të drejtat e njeriut janë të garantuara me ligjet ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara. Ky organ e përcjell shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut në botë dhe çdo herë kritikon shtetin nga i cili vijnë këto shkelje.

\_\_\_\_\_

Lexo tekstet e lartshënuara dhe në vijat përkatëse shëno shkronjën e duhur.

## 8. Radioja

Radioja (lat.: radius = rreze) është një aparat elektronik marrës - dhënës i rrezeve elektromagnetike, të ashtuquajtura radiovalë. E thënë më saktë, nëse një radioaparaturë është i aftë vetëm të lëshojë valë quhet radiotransmetues, dhe nëse është i aftë vetëm të zërë radiovalët e lëshuara quhet radiomarrës, dhe në qoftë se është i aftë të marrë dhe të lëshojë radiovalë, quhet radiomarrës-dhënës, ose shkurtër radio.

Lexo përsëri tekstin e dhënë dhe trego cilit stil i takon?

- a) shkencor, joletrar
- b) politiko - shkencor
- c) letërsisë artistike

## 9. Para teje është një pjesë e përmbajtjes së një libri. Shikoje dhe përgjigju pyetjeve:

10	PASQYRA E LËNDËS
	c) Me qiellzorëzim të bashkëtingëllores dhe me prapashtesën -e njëkohësisht (me ose pa ndërrim të zanores) . . . . . 103
	C. Shumësi me ndërrime të tjera tingujsh . . . . . 103
3.3.3.	Emrat që përdoren vetëm në njëjës. . . . . 104
3.3.4.	Emrat që përdoren vetëm në shumës. . . . . 104
3.4.	KATEGORIA E RASËS . . . . . 105
3.4.1.	Njohuri të përgjithshme. . . . . 105
3.4.2.	Kuptimet kryesore të rasave. . . . . 107
	Rasa emërore . . . . . 108
	Rasa gjimore . . . . . 108
	Rasa dhanore . . . . . 109
	Rasa kallëzore . . . . . 110
	Rasa rrjedhore . . . . . 110
3.5.	TIPAT E LAKIMIT . . . . . 111
3.5.1.	Klasifikimi i emrave sipas tipit të lakimit. . . . . 111
3.5.2.	Lakimi i parë. . . . . 113
3.5.3.	Lakimi i dytë. . . . . 115
3.5.4.	Lakimi i tretë. . . . . 115
3.5.5.	Lakimi i katërt. . . . . 117
3.5.6.	Lakimi i emrave në numrin shumës. . . . . 118
3.6.	KATEGORIA E SHQUARSISË DHE E PASHQUARSISË . . . . . 120
3.6.	Njohuri të përgjithshme. . . . . 120
3.7.	PËRDORIMET KRYESORE TË TRAJTËS SË SHQUAR E TË TRAJTËS SË PASHQUAR . . . . . 121
3.7.1.	Rastet e shquarsisë. . . . . 121
3.7.2.	Shquarsia tek emrat e përveçëm. . . . . 125
3.7.3.	Trajta e shquar me kuptim përgjithësues. . . . . 126
3.7.4.	Kuptimi dhe përdorimi i trajtës së shquar. . . . . 127
3.7.5.	Njëjtësimi formal i gjimores dhe dhanores së shquar me gjimoren dhe dhanoren e shquar në numrin shumës. . . . . 131
3.8.	FORMIMI I EMRAVE . . . . . 132
3.8.1.	Mënyrat fjalëformuese. . . . . 132
3.8.2.	Formimi prapashtesor. . . . . 133
	1. Emrat e përgjithshëm të vetave . . . . . 133
	a) Me prapashtesën -(ë)j . . . . . 133
	b) Me prapashtesat -ar, -tar (-atar), -or, -tor (-ator), -ak, -as, -an (-jan), -it, -iot . . . . . 134
	c) Me prapashtesë të reja të burimit të huaj, si: -ist, -ik, -ant, -ent, -ier (-er) . . . . . 135
	2. Emrat e sendeve me prapashtesat -ë(s)e, -or(e), -ar(e), -esë, -je, -ishte, -urina, -(ë)si(r)ë, -aç(e), -ashkë, -aç, -e . . . . . 136

a) Në cilat faqe mund të lexosh për kuptimet kryesore të rasave? Nga faqja 105-?

b) Në cilën faqe fillon teksti për rrjedhoren?

**10.** Pjesë e shkurtër e nxjerrë fjalë për fjalë nga një vepër ose nga një tekst i shkruar, pra riprodhim i fjalë për fjalë quhet:

- a) parathënie
- b) subjekt
- c) citat
- d) epilog

**11.** Lexo me kujdes pjesën e shkëputur nga një tregim dhe rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

-Ç'muaj është tani ?

- Janar.

- Sa ka muaji sot ?

- Sot ka pesëmbëdhjetë ditë.

- Ka bërë mot i mirë.

- A dalim nesër për gjah ?

- Dalim.

- Në ç'anë ?

- Vemi në mal të Tomorrit.

- Po, atje vemi të gjuajmë, sepse atje ka mjaft egërsira.

Atje ka edhe bisha, atje ka edhe derra të egër e ujq, e çakej, arusha, e drerë, e kaproj, dhi të egra, dhelpra e lepuj. Në marrshin erë qentë, e bien në ndonjë tufë të madhe, kemi për të vrarë shumë prej tyre. Nesër, pra, të dalim për gjah...

- Cilin të vëmë të parë në gjah, të prijë përpara e të urdhërojë ?

- Vëmë Mark Shalgjatin.

- Ai është gjahtar i vërtetë, atij si trembet syri, është edhe trim...

.....

- Lëshoni qentë e langonjtë të prijnë përpara.

- Ty, ty, ty – trumbeta e bririt.

- Ha, ha, ha – ndërsejnë qentë.

- Taf tuf, taf tuf, - kërcasin pushkët...

Nuk po gjuajmë me, se s`ka mbetur kohë. Prini përpara, o gjahtarë, ecni me vrap, të zëmë fshatin me kohë.

**Tregimi është marrë nga:**

- a) Lahuta e Malcisë
- b) Gjahu i malësorëve
- c) Nipi i minatorit

**12.** Pjesë e shkurtër e nxjerrë fjalë për fjalë nga një vepër ose nga një tekst i shkruar; riprodhimi fjalë për fjalë i një shprehjeje ose i një mendimi të një tjetri është:

- a) Citat
- b) Parathënie
- c) Kapitull
- d) Përmbajtje

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**13.** Lexo tekstin e mëposhtëm dhe rretho shkronjën para përgjigjeve të sakta.

Kur kullosnin delet dhe qengjat në lëndinë, ne nuk frikësoheshim fare se do të na humbshin... Ishim më të qetë për t'u marrë me ndonjë nga lojërat e shumta që dinim. Kur gjendeshin delet në lëndinë tërë përkuqdesjen e ruajtjes së tyre ia lënim qenit tonë i cili linte të shpërndareshin. Posa hetonte se ndonjëra nga delet ose qengjat, lakmonte kah dushkaja –qeni i dilte përpara dhe, me dy të lehura, e kthente prapë në kope. Meqenëse të gjitha delet frikësoheshin nga qeni, shpesh as që provonin të futeshin në dushkajë. Prandaj, edhe qeni, kur delet s'lakmonin dushkajën- pushonte; shtrihej në ndonjë hije dhe nga aty përgjonte çdo lëvizje të deleve. Kësisoj, pra, delet hanin bar në lëndinë, ne luanim lojërat që dinim, kurse, qeni pushonte nën hije...

Por kjo nuk ndodhte gjithëherë, sepse në kope gjendej edhe qengji të cilin e thërritnim Curr. Këtë emër ia patëm ngjitur për shkak se ishte më i vogli i kopes dhe më lazdrani. Nuk qetësohej fare, por gjithnjë kërkonte hapësirë për të vrapuar, kërcyer; për t'u grindur me ndonjë mocanik të tij e për të bërë telashe. Ne e duronim qengjin, atë Currin tonë; e lënim të kërcëjë e të bëjë ç'të dojë... por qeni jo se jo. Qeni gjithnjë e ndiqte. Në fillim nuk e kuptonim pse vallë e ndiqte qeni qengjin, por më vonë krejt e kuptuam. Ja ku ishte shkaku.

Rretho shkronjat para deklaratave që përshaten me tekstin që e ke lexuar.

- a) Qengji që ra në ujë quhet Curri
- b) Djemtë nuk mundnin të luanin rehat derisa qeni e ruante kopenë
- c) Qengji ishte i lazdruar dhe të gjithë e donin
- d) Qeni ishte dembel dhe nuk bëri asgjë t'i ndihmonte Currit

**14.** Filmi shqiptar

Filmi shqiptar e ka zanafillën më 1907, me "Lymierët e parë shqiptarë", vëllezërit Manaki, të cilët realizuan një sërë dokumentarësh në qytetin e Korçës. Po kështu Mihallaq Mone e Adem Mani e radhitën filmin shqiptar krahas atij të vendeve më të zhvilluara të botës. Kjo dëshmon se, që në fillim të shek. XX, Shqipëria ishte ndër shtetet e para në botë që njohu "kutinë magjike". Xhirimet e filmave të vëllezërve Manaki ruhen ende në arkivat e filmit. Ata njihen që më 1942.

Në Shqipëri ka pasur salla kinemaje që në vitin 1930, ku shfaqeshin shumë filma.

Lexo tekstin e dhënë dhe në vizat e mëposhtme shkruaj përgjigjen:

1. Cila është zanafilla e filmit shqiptar? \_\_\_\_\_
2. Kush janë realizatorët e filmit të parë? \_\_\_\_\_
3. Nga cili vit në Shqipëri ka pasur salla kinemaje? \_\_\_\_\_

## 15.

### Bie çmimi i mallrave me shumicë

Shtetet e Bashkuara thonë se çmimi i mallrave me shumicë ka rënë muajin e kaluar, shenjë kjo që tregon se inflacioni mbetet i ulët. Çmimi që fabrikat i paguajnë për mallra dhe materiale para se ato të arrijnë te konsumatorët ka rënë në 0.1 % në dhjetor. Ekonomistët kanë pritur një rritje për 0.2 % duke përfshirë kategoritë e ushqimit dhe të energjisë elektrike. Ky indeks kryesor që vëzhgohet nga afër u rrit në 0.3. % gjë që është rritja më e madhe nga muaji korrik.

Lexo tekstin a lartshënuar dhe trego se çfarë teksti është:

- a) Shkencor
- b) Informativ
- c) Letrar

## 16. Lexo tekstin me vëmendje dhe veço fjalët-fjalitë më të rëndësishme në tekst:

### Molla e La Fontenit

Poeti francez La Fonteni e kishte zakon të hante çdo mëngjes nga një mollë të pjekur. Kështu një ditë ai lë mollën që të ftohet mbi oxhak dhe vetë shkon në bibliotekë për të gjetur një libër.

Në këtë kohë një mik i tij hyn në dhomë, sheh mollën, e merr dhe e ha. Kur kthehet La Fonteni e vëren se molla nuk është në vendin ku e ka lënë dhe e kupton se çfarë ka ndodhur. Atëherë i drejtohet me mallëngjim mikut;

- Ah, kush e paska ngrënë mollën që gjendej mbi oxhak?

- Unë jo! -përgjigjet miku.

- Aq më mirë, miku im.

- Sepse, -shtoi La Fonteni - kam futur helm brenda në të për të helmuar minjtë.

- Ah, i gjori unë, arsenik? - klithi miku- qenkam helmuar!

- Mos u frikësoni, mik i dashur, - tha La Fonteni - duke qeshur, kjo nuk është e vërtetë. Desha të di kush e ka ngrënë mollën.

## 17. Lexo me vëmendje tekstin e mëposhtëm dhe përgjigju në pyetje:

\*\*\*

Pas afro një ore sa ishim duke kërkuar, arritëm te përroi i madh, aty ku grumbulloheshin edhe shumë përronj të tjerë. Por prapë qenin e qengjin nuk i gjetëm. Pas pak, andej kah majat e bjeshkëve - u ngritën disa re të mëdha; disa re të zeza të cilat na bënë me dije se, pas pak do të binte shi... Njëmend ashtu ngjau: njëherë mbi ne u sulën do pika të vogla, pastaj ato pika jo vetëm që u rritën, por edhe u shumuan... Pas një shkrepitje të rrufesë sikur u bë rrëmujë e vërtetë... U strehuam nën degët e një lisi për t'u mbrojtur nga shiu. Aty para nesh hetuam se si uji i përroit sa vinte shtohet edhe më shumë. Mandej ai ujë nisi të sjellë edhe degë të drunjeve; rrënjë të ndryshme. Për pak, krejtësisht harruam se ishim duke kërkuar qengjin dhe qenin e humbur... Dhe ndoshta, nga frika e madhe që kishim prej asaj vërshime edhe do të harronim sikur të mos e kishim vërejtur, matanë përroit qengjin e lagur që priste mu në breg të përroit. Kur pa se nëpër përrua kalonte vërshimë e madhe, u step qengji dhe ktheu kokën prapa, andej kah i vinte qeni... Mandej qengji bëri edhe dy hapa. Tash u gjend krejtësisht afër ujit, afër atyre dallgëve të mëdha, veç sa nuk i sharronte këmba në ujë.

“I pafati unë, më shkoi qengji! Më shkoi Curri im!”-klithi shoku,-“Oh, çfarë do të them në shtëpi kur të më pyesin prindërit e mi?”

Sa i humbëm të gjitha shpresat e në anën tjetër shokut tim i shkonin lotët faqes, edhe qengji njëmend rrëshqiti me këmbët e para dhe u gjend në atë valë përrockës...

“Ku-ku për mua!”-klithi edhe shoku im.

Edhe vetë qeni u gjuajt mbi valë.

“Oh, tani edhe qeni im i mirë u mbyt!”-vazhdoi klithmën ai shoku im.

Edhe unë mendova njëherë se, vërtet, edhe qeni u mbyt. Por nuk ngjau ashtu. Përndryshe po të ndodhte ashtu, siç mendonim ne gjatë atyre pak çasteve, kur qeni e qengji gjendeshin duke u kacafytur me dallgë, ky tregim do të përfundonte dhimbshëm. Por, për fat të mirë të qenit, qeni arriti me kohë dhe e kapi qengjin për qafe. Kur e shihnim qafën e qengjit në gojë të qenit mendonim se po e hante por, pas pak kohe, kur pamë se qeni e tërhoqi qengjin dhe e qiti në breg të përroit, u gëzuam pa masë. Curri ynë shpëtoi. Edhe shoku im i fshiu lotët... Krejtësisht harruam se ishte duke rënë shi i madh. Ashtu, nëpër shi- u nisëm andej kah bregorja, kah ajo lëndinë e madhe ku ishte kopeja, ku ishte edhe ai shoku ynë që e ruante kopenë. Qengjin e mbanim në dorë, sepse ishte lagur e lodhur sa që nuk mund të mbahej në këmbë të veta, kurse pas nesh vinte qeni ynë, ai qeni i guximshëm.

Në tekstin e dhënë më lartë informacioni më kryesor është:

- a) Një nga djemtë u frikësua që e humbi qengjin
- b) Qeni vërtet e urrente qengjin
- c) Qeni e shpëtoi qengjin
- d) Qengji ishte i lazdruar, kërcente dhe bënte ç'donte

**18.** Lexo tekstin dhe nënvizo në tekst veçoritë më të rëndësishme:

“Gjatë njëzet minutave të fundit, - ne ju paraqitëm shkaqet kryesore pse fëmijët po i braktisin shkollat gjithnjë e më shumë. Të dhënat e mbledhura tregojnë qartë se shkaqet kryesore janë varfëria në rritje, niveli i ulët i mësimdhënies dhe i kushteve të mësimin në shkolla, si dhe problemet esenciale në familje. Çështja është se çfarë duhet bërë përtej këtij konstatimi. Të gjithë, që nga organet e larta të pushtetit deri te qytetari më i thjeshtë, kemi përgjegjësi për fatin e këtyre fëmijëve. Përgjegjësia e disave është ligjore. – e të tjerëve, morale. Edhe sa kohë do të vazhdojmë kështu, duke bërë një sy qorr dhe një vesh shurdh?”

**19.** Lexo tekstin dhe nënvizo veçoritë më të rëndësishme:

Të ndalohet ngrohja globale

Në Berlin u mbajt Konferenca Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për mjedisi jetësor. Në të morën pjesë 2000 veta nga 17 vende të botës. Konferenca u drejtoi një apel vendeve të industrializuara dhe vendeve tjera që të mbrojnë mjedisin jetësor dhe të pakësojnë gazin karbonik të hedhur në hapësirë, që shkakton efektin serë. Vendet e Bashkimit Evropian kanë vendosur që pas vitit 2000 të mos e rrisin sasinë e gazit karbonik që hedhin në hapësirë. Këtë shembull duhet ta ndjekin edhe vendet e tjera të industrializuara.

**20.** Lexo tekstin dhe nënvizo veçoritë më të rëndësishme:

Lojërat pozitive

“Është provuar se neurogjenezja, simptomi i mirëqenies së trurit zgjat gjithë jetën”, pohojnë mjekët. Kjo mund të arrihet duke mos e lënë trurin të gjenerojë drejt plakjes. Mirë është ta stërvitësh atë pavarësisht moshës, por jo me aktivitete pasive si shikimi i televizorit, por me stimuj të rinj kulturorë, si loja me letra, zgjidhja e fjalëkryqeve dhe njohja e njerëzve të rinj. Por sot dihet edhe një tjetër faktor i rëndësishëm: kujdesi i nënës në fëmijëri.

**21.** Në tekstin e dhënë dallohen 3 pjesë. Cakto radhitjen e tyre me numra nga 1 deri te 3.

\*\*\*

Pas afro një ore sa ishim duke kërkuar, arritëm te përroi i madh, aty ku grumbulloheshin edhe shumë përronj të tjerë. Por prapë qenin e qengjin nuk i gjetëm. Pas pak, andej kah majat e bjeshkëve - u ngritën disa re të mëdha; disa re të zeza të cilat na bënë me dije se, pas pak do të binte shi... Njëmend ashtu ngjau: njëherë mbi ne u sulën do pika të vogla, pastaj ato pika jo vetëm që u rritën, por edhe u shumuan... Pas një shkrepitje të rrufesë sikur u bë rrëmujë e vërtetë... U strehuam nën degët e një lisi për t'u mbrojtur nga shiu. Aty para nesh hetuam se si uji i përroit sa vinte shtohet edhe më shumë. Mandej ai ujë nisi të sjellë edhe degë të drunjtë; rrënjë të ndryshme. Për pak, krejtësisht harruam se ishim duke kërkuar qengjin dhe qenin e humbur... Dhe ndoshta, nga frika e madhe që kishim prej asaj vërshime edhe do të harronim sikur të mos e kishim vërejtur, matanë përroit qengjin e lagur që priste mu në breg të përroit. Kur pa se nëpër përrua kalonte vërshimë e madhe, u step qengji dhe ktheu kokën prapa, andej kah i vinte qeni... Mandej qengji bëri edhe dy hapa. Tash u gjend krejtësisht afër ujit, afër atyre dallgëve të mëdha, veç sa nuk i sharronte këmba në ujë.

“I pafati unë, më shkoi qengji! Më shkoi Curri im!”-klithi shoku,-“Oh, çfarë do të them në shtëpi kur të më pyesin prindërit e mi?”

Sa i humbëm të gjitha shpresat e në anën tjetër shokut tim i shkolin lotët faqes, edhe qengji njëmend rrëshqiti me këmbët e para dhe u gjend në atë valë përrockës...

“Ku-ku për mua!”-klithi edhe shoku im.

Edhe vetë qeni u gjuajt mbi valë.

“Oh, tani edhe qeni im i mirë u mbyt!”-vazhdoi klithmën ai shoku im.

Edhe unë mendova njëherë se, vërtet, edhe qeni u mbyt. Por nuk ngjau ashtu. Përndryshe po të ndodhte ashtu, siç mendonim ne gjatë atyre pak çasteve, kur qeni e qengji gjendeshin duke u kacafytur me dallgë, ky tregim do të përfundonte dhimbshëm. Por, për fat të mirë të qenit, qeni arriti me kohë dhe e kapi qengjin për qafe. Kur e shihnim qafën e qengjit në gojë të qenit mendonim se po e hante por, pas pak kohe, kur pamë se qeni e tërhoqi qengjin dhe e qiti në breg të përroit, u gëzuam pa masë. Curri ynë shpëtoi. Edhe shoku im i fshiu lotët... Krejtësisht harruam se ishte duke rënë shi i madh. Ashtu, nëpër shi- u nisëm andej kah bregorja, kah ajo lëndinë e madhe ku ishte kopeja, ku ishte edhe ai shoku ynë që e ruante kopenë. Qengjin e mbanim në dorë, sepse ishte lagur e lodhur sa që nuk mund të mbahej në këmbë të veta, kurse pas nesh vinte qeni ynë, ai qeni i guximshëm.

- Qeni po e ruante kopenë e djemtë po luanin rehat \_\_\_\_\_
- Qengji ( Curri ) ra në ujë \_\_\_\_\_
- Qengji ( Curri ) i afrohej qenit kur ishte duke fjetur dhe ia prekte bishtin \_\_\_\_\_
- Djemtë u mërzitën shumë për qengjin ( Currin ) dhe qenin \_\_\_\_\_
- Qeni e shpëtoi qengjin ( Currin ) \_\_\_\_\_



**22.** Lexo me kujdes paragrafët e dhënë dhe konstato radhitjen e tyre, duke e shkruar para secilës numrin 1, 2, ose 3.

\_\_\_\_\_ Unë në këtë tregim nuk do të merrem me shumë gjëra, por do t'u rrëfej vetëm një esnafllek të Shegës, atë të byrekbërjes. Ky esnafllek ndodhte aty nga mesi i çdo jave, herë të mërkurën e herë të enjten, rreth orës njëzet e një, kur të gjitha dyqanet e ushqimoreve ishin mbyllur. Shega, me ndonjë filxhan çaji, filxhan kafeje apo gotë uji në dorë, trokiste te dera e njëres nga fqinjët dhe kërkonte atë për çka kishte nevojë.

\_\_\_\_\_ Javën e parë të muajit që shkoi, fiks në orën njëzet e një e pesë minuta, trokiti në derën tonë dhe, pa hyrë mirë brenda, duke buzëqeshur e tërë përkëdhelka, i tha gruas sime:

\_\_\_\_\_ - Uuu, pika më rëntë, moj Shanisha, si paskësja harruar të blija miell? E dija se kisha, po kur hapa dollapin, shiko e shiko, nga të gjitha llojet e ushqimeve kishte aty brenda, vetëm miell s'kishte... Mirëpo dua t'u bëj një byrek kalamajve, se u kam dhënë llafin. I thashë tim shoqi, Rustos: "T'u bëfsha, hidhu një vrap deri te dyqani i ushqimores dhe blija një qillo miell, se më paska mbaruar!..." Ai ma ktheu: "Po ku ka dyqan hapur në këtë orë, moj të qëlloftë! Merr ndonjë gotë te komshinjtë, pa ua kthen nesër..." E, ja, erdha, moj Shanisha motra... Të ndodhet ndonjë gotë miell? Ta bie motra nesër...

\_\_\_\_\_ Shega është një fqinja jonë me një moshë rreth të pesëdhjetave. Fqinjësia është goxha e vjetër, mbi njëzetëvjeçare dhe, si i thonë, i njohim dhëmbë e dhëmballë njeri-tjetrit e njëra-tjetrës. E si të mos njihemi aq mirë, kur kemi marrë pjesë nëpër dasmat e secilës palë, kemi lindur fëmijët në të njëjtin pallat e në të njëjtin maternitet?... Edhe fëmijët aty u rritën e u bënë ca nga tetëmbëdhjetë e ca nga njëzetvjeçarë. E, pra, ne i njohim shoshokit edhe kollën kur ngjitemi nëpër shkallë, të mos themi se i njohim edhe ato "kollitjet" e zonës së poshtme...

**23.** Shiko se si është ndërthurur tregimi i një aventure me "fund të lumtur".

- a) basti që unë dhe xhaxhai vumë me miqtë se do t'ia dilnim mbanë të kalonim me barka me vela nga brigjet e Vlorës deri në Sarandë;
- b) nisja me barka me vela nga porti i Vlorës në orën 10 të 16 korrikut; kohë e qetë dhe erë e mbarë;
- c) pas dy orësh lundrimi ndryshon era dhe na shtyn larg, në det të hapur, peripecitë, ana dramatike, ana komike;
- d) Vetëm pas perëndimit të diellit një motovedetë e rojës bregdetare, e lajmëruar nga një peshkatar, na arrin në veriperëndim të ishullit të Sazanit e na sjell shëndosh e mirë në bregun e Radhimës;
- e) Vërejtjet e ndihmësve, çlirimi nga ankthi i familjarëve dhe i shokëve, parashikimet për të nesërmen, të qeshurat e talljet etj.
- f) Përcaktoni skemën e rrëfimit. Zakonisht një ngjarje ndahet në faza të përcaktuara mirë: parashtrimi, pika e lidhjes, ndodhia qendrore, zgjidhja e konfliktit dhe përfundimi.

Rrethoni shkronjën para së cilës gjendet:

- parashtrimi
- zgjidhja e konfliktit

**24.** Teksti përbëhet nga tri situata: fillestare, ngjarja kryesore dhe përfundimi.

**ÇLIRIMI NGA ANKTHI**

Atë natë fjeta shumë keq: më zuri gjumi vetëm ndaj të gdhirë dhe pashë ca ëndrra të tmerrshme. Ishte më se e qartë se nuk isha i qetë e ndoshta e kisha edhe ndërgjegjen jo të pastër. Në orën shtatë u ngrita. Ishte një ditë e bukur. U veshja me nxitim dhe dola. Qytetin, që si gjithnjë zgjohej herët, e përshkrova në pak minuta. Ndihesha i tensionuar e nuk mund të mos mendoja se fundja ishte vetëm faji im që gjërat shkuan ashtu siç shkuan, natyrisht, në të ardhmen nuk do të ndodhte më.

Në tetë isha para shkollës, ku u futa mes nxënësve, të cilët ndanin të njëjtën ndjenjë frike me mua: dyshonin se mos mbeteshin në ndonjë lëndë dhe prisnin me ankth rezultatet përfundimtare. Zura vend pranë Evës dhe Artinit që ishin mbështetur te muri pranë derës së hyrjes. Në vend që të fjaloseshim e të qeshnim, siç bënim pak a shumë zakonisht, rrinim të heshtur, duke shkëmbyer në të rrallë ndonjë fjalë.

Para disa minutash u përhap zëri se lista e notave u afishua. Para se të vendosja të shikoja rezultatet, mora frymë thellë disa herë rresht e pastaj, me hap të vendosur, iu afrova stendës. Kërkova listën e klasës sime. E lexova: F.R. Kalon.

Për një çast mbeta si i ngrirë, pastaj vrapova jashtë, duke bërëtitur nga qejfi e duke përqaftuar të gjithë ata që takoja. Gjithçka kishte shkuar për mirë. Në rregull. Por vitin tjetër nuk dua ta përsëris më këtë përvojë të keqe.

Nënvizo ose shkruaj paragrafin i cili e tregon përfundimin:

---

---

---

**25.** Shiko në vijim tabelën e mëposhtme:

Prona e gjinisë femërore				
Rasa	Prona njejës		Prona shumës	
Emërore	shoqja ime	imja	shoqet e mia	të miat
Gjinore	i shoqes sime	i simes	i shoqeve të mia	i të miave
Dhanore	shoqes sime	simes	shoqeve të mia	të miave
Kallëzore	shoqen time	timen	shoqet e mia	të miat
Rrjedhore	prej shoqes sime	prej simes	prej shoqeve të mia	prej të miave

Në tabelë nënvizo përemrin – imja – në numrin njëjës, në gjininë femërore, në rasën dhanore.

26. Lexo tekstin e mëposhtëm dhe rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:


Në qershor Këshilli i Bashkimit Evropian mund të miratojë disa dokumente, të cilat mund të jenë pozitiv për Shqipërinë dhe për të ardhmen e saj, u shpreh përfaqësuesi i Bashkësisë Evropiane në një deklaratë për mediet shqiptare në Bruksel

Eurodeputeti vlerëson se plotësimi i tyre kërkon një kohë të caktuar, por beson se kjo mund të arrihet para raportit të përvitshëm të Komisionit Evropian, që publikohet në tetor.

Teksti është:

- a) Administrativ
- b) Shkencor
- c) Tekst gazetaresk
- d) Letrar

27. Në tabelën e mëposhtme rretho trajtat e shkurtra të bashkuara:



**28.** Njëqind qytetarë të rastësishëm të pyetur sa e shikojnë programin televiziv, janë përgjigjur:

Aktivitetet	Përqindjet
Shikoj TV	17,4%
Shoqërohem me shokë	(13,3%)
Lexoj libra	(11,1%)
Shëtis	(7,2%)
Fle/pushoj	(6,6%)
Merrem me sport	(4,4%)
Kujdesem për fëmijë	(3,9%)
Shkoj në gjueti/peshkim	(3,2%)
Dëgjoj muzikë	(2,6%)
Në rrethin familjar	(2,5%)
Punoj në kompjuter	(2,2%)
Lexoj gazeta	(2,0%)
Punoj në kopsht	(2,0%)
Shikoj filma	(1,8%)
Merrem me punë dore	(1,8%)
Luaj shah, letra	(1,2%)
Bëj punët e shtëpisë	(1,0%)
Rri me partnerin	(1,0%)
Merrem me art	(0,9%)
Aktivitete të tjera	(5,4%)
Nuk kam kohë të lirë	(3,4%)
Nuk kam përgjigje	(5,1%)
Gjithsej	(100%)

Sa përqind e qytetarëve e kalojnë kohën duke shikuar TV?

---

## Të shprehurit me shkrim

29.

Shkruaj pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratës në vizat e mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

30. Këtu më poshtë kemi një formular të cilin duhet ta plotësoni ashtu siç kërkohet:

- Emri dhe mbiemri \_\_\_\_\_
- Shkolla dhe vendi \_\_\_\_\_
- Klasa \_\_\_\_\_
- Sa lëndë keni pasur në klasën e VIII-të \_\_\_\_\_
- Me çfarë suksesi keni mbaruar klasën e VIII-të \_\_\_\_\_
- Çfarë note mesatare keni pasur \_\_\_\_\_
- Cila lëndë ju ka pëlqyer më shumë \_\_\_\_\_

31. Detyra jote është të përshkruash katër fjali lidhur me temën.

Në shkollë, gjatë kohës së pushimit të madh

Në hartim shpjego ndonjë ngjarje e cila ka ndodhur në oborrin e shkollës gjatë kohës së pushimit të madh. Mund të zgjedhësh një ngjarje në të cilën je pjesëmarrës ose dëshmitar.

Përgjigjja do të vlerësohet në bazë të asaj sa ke kujdes ti për strukturën e fjalisë dhe kuptimin e saj.

---

---

---

---

32. Në sa mënyra u bë përngjitja e shkronjave të gjuhës shqipe?

Cilat janë ato?

---

---

---

---

**33.** Detyra jote është të shkruash katër fjali lidhur me temën.

Në shkollë, gjatë kohës së pushimit të madh

Në hartim shpjego ndonjë ngjarje e cila ka ndodhur në oborrin e shkollës gjatë kohës së pushimit të madh. Mund të zgjedhësh një ngjarje në të cilën je pjesëmarrës ose dëshmitar. Përgjigjja do të vlerësohet në bazë të asaj sa ke kujdes ti për strukturën e fjalisë dhe kuptimin e saj.

---

---

---

---

**34.** Shkruaj një fjali për shkollën ose për klasën tënde, e cila do të ketë së paku dhjetë fjalë. Fjalja duhet të jetë e kuptueshme dhe sipas rregullave gramatikore.

---

**35.** Shkruaj shumësin për emrat e poshtëshënuar:

babai/i ati \_\_\_\_\_

**36.** -Ishin kone tre vllazen. E kishin pase baben e nanen. Baba para se me deke i thirri djemt. Ma s'pari e thirri t'madhin dhe i tha.

- Bir, un po des. A po i do niqin lira t'haramit a nja t'hallallit

-Pi i due niqin t'haramit,-ja ktheu i biri. Edhe baba ja dha niqin lira.

- Edhe i dyti i deshti niqin lira t'haramit. Kur e veti te tretin, ai tha:

-Valla, un po e due nja t'hallallit. Atëherë baba ja dha sall ni lire e i tha;

Qyre shka po t'thom kur t'jesh ma s'ngushti shko ndollap mas deres s'shpise e gjan diçka...

Lexo tekstin e lartshënuar me kujdes dhe trego se teksti është i gjuhës:

a) Formale

b) Jo formale

**37.** Shkruaj drejt fjalitë e mëposhtme, duke marrë parasysh rregullat e drejtshkrimit.

1. Kjo pun nuk ka me u maru mrena ni dite, as edhe ni nate.

2. Ti ke me menue gat me i xhet idet per ta sajue ni tregim fantastik si ki.

---

---

**38.** Nga 29 shkronja bashkëtingëllore sa ka gjuha shqipe 24 janë gjuhore, kurse pesë janë buzore. Trego cilat janë bashkëtingëlloret buzore-dhëmbore;

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

a) r , rr

b) n , nj

c) p , b, m, f, v

d) k, g, h

**39.** Shkruaj pa gabime dhe me shkronja dore fjalinë e dhënë:

Unë jam nxënës në shkollën dituria

---

**40.** Përdor forma të ndryshme të gjuhës së shkruar: fjalinë e shkruar me shkronja të shtypit, mund ta shkruajë edhe me shkronja të dorës:

Prandaj, shkruaj me shkronja të dorës këtë fjali:

1. Taulanti dhe Leonora, në orën e gjuhës shqipe treguan tregime të bukura.

1. \_\_\_\_\_

**41.** Komunikimi gjuhësor me anë të gjuhës së shkruar sot është një praktikë e përditshme: Lexo tekstin më poshtë dhe përgjigju çfarë forme e komunikimit gjuhësor është:

Kuvendit Komunal në Bujanoc  
(Komisionit për shqyrtim të kërkesave)

Lënda: Paraqitje në konkursin e shpallur për punët dhe detyrat e referentit administrativ

Në të përditshmen “Koha ditore” të datës p.sh., 20.01.2012 është shpallur konkursi për punët dhe detyrat e referentit administrativ. Me që konsideroj se i plotësoj kushtet e kërkuara me konkurs, lus titullin e lartshënuar që të marrë në shqyrtim kërkesën time.

Jam i(e) lindur më \_\_\_\_\_ në fshatin \_\_\_\_\_  
kk \_\_\_\_\_

Kam kryer shkollën e mesme juridike, drejtimi administrativ me sukses shumë të mirë. Tani jetoj në Bujanoc. Jam i papunë.

Kërkesës ia bashkëngjes këto dokumente:

- Çertifikatën e lindjes;
- Diplomën origjinale;
- Çertifikatën e gjendjes ekonomike;
- Çertifikatën se nuk jam i dënuar ose nën hetime;

Shpresoj se kërkesa ime do të merret në shqyrtim.

Në Bujanoc,  
Më 24.01.2012

Shpend Kastrati  
Rruga e Kosovës 2, Bujanoc

- a) ankesë
- b) padi
- c) letërkëmbim
- d) kërkesë (lutje)

**42.** Plotëso këtë formular me të dhënat e një personi të imagjinuar:

Paraqitem për regjistrim në _____ (emërtimi i shkollës së mesme)	
në Profili arsimor për shkollë profesionale, përkatësisht për gjimnaz:	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	
Dita, muaji dhe viti i lindjes	
Emri dhe mbiemri i babait, profesioni i tij dhe adresa	
Emri dhe mbiemri i nënës, profesioni dhe adresa	
Emri dhe mbiemri i kujdestarit, profesioni i tij dhe adresa (nëse nxënësi nuk ka prindër)	
Adresa e nxënësit: komuna, vendbanimi, rruga dhe numri	

**43.** -Para teje është një fletëpagesë Të njëjtën duhet të plotësosh me të dhënat e tua të sakta.

- Emri e mbiemri \_\_\_\_\_
- Datëlindja \_\_\_\_\_
- Vendi i lindjes \_\_\_\_\_
- Qëllimi i pagesës \_\_\_\_\_
- Kujt i dedikohet \_\_\_\_\_
- Xhirologaria \_\_\_\_\_
- Data dhe vendi i pagesës \_\_\_\_\_

**44.** Këtu më poshtë kemi një formular të cilin duhet ta plotësoni ashtu siç kërkohet:

- Emri dhe mbiemri \_\_\_\_\_
- Shkolla dhe vendi \_\_\_\_\_
- Klasa \_\_\_\_\_
- Sa lëndë keni pas në klasën e VIII-të \_\_\_\_\_
- Me çfarë suksesi keni mbaruar klasën e VIII-të \_\_\_\_\_
- Çfarë note mesatare keni pasur \_\_\_\_\_
- Cila lëndë ju ka pëlqyer më shumë \_\_\_\_\_

**45.** Përpiquni t'i vini presjet në vendin e duhur në tekstin që pason:

“Në mbrëmje pasi u ngrys sosën në kështjellën e Shteluzit. Para se të hynin brenda dëgjuan tinguj fyejsh lahutash çiftelish dhe zhurmë lodrash që përziheshin me zërin ushtrues të këngëve. Flaka e pishave që përhapej nga kopshti i një shtëpie ua tregoi valltarëve tanë vendin e dëfrimit.



- 46.** Në tekstin e dhënë më poshtë përmirëso gabimet gjuhësore duke i respektuar rregullat drejtshkrimore;

“Githnji m’ka pëlqy futballi por ndeshja e zhvillueme të dillën isht shumë tërheqse. Si skuadra jon ashtu edhe ajo e “besës” lujshin mjaft mir. Loja u boke ma e rrept dhe ma e bukur mbas cdo golli”

**47.**

Tërrnoc, më: 10 janar 2012

Më e dashura ime

Tani s’mund ta marrësh me mend se sa të dua, më shumë se malet dhe bjeshkët e larta. Të gjithë e dinë se për dashurinë tënde jam në gjendje të bëje gjithçka. Vazhdimisht po sillem vërdallë rreth boshtit tënd trigonometrik, ndaj të lutem, më trego emrin e përbashkët të dashurisë sonë, të vuajtjeve të mia që po shkojnë drejt infinitit...

Nëse plotësohet kjo dashuri, jeta ime do të jetë e lumtur dhe filli i jetës sime do të jetë sikur uji që rrjedh pa u ndal. E nëse nuk realizohet ëndrra e dëshirave të mia, atëherë vlera e dashurisë sonë do të jetë barazi me zero, ndërsa zemra ime do të bëhet copë e thërrmi. Po e përfundoj me dëshirat më të mëdha për Ty, i yti....

Lexo tekstin e lartshënuar dhe trego se çfarë teksti apo zhanër është:

- a) Lutje
- b) Ankesë
- c) Letër

- 48.** Numrat e dhënë arabë shkruaj me numra romakë:

1999

15

447

12

## Gramatika, leksiku, gjuha popullore dhe letrare

- 49.** Zanorja ë e patheksuar nuk shkruhet në fjalët:
- a) Dhëndëri, motëri, sipëri
  - b) Dimëroj, numërim, femërore
  - c) Tregti, arsye, trathti
  - d) Etërit, prindërit, shtretërit.
- 50.** Cilat trajta të foljeve *ziej* dhe *ndiej* duhen shkruar me je:
- a) E tashmja dëftore veprore
  - b) E pakryera e dëftores
  - c) Vetat e njëjësit të së kryerës së thjeshtë
  - d) Vetat e shumësit të së kryerës së thjeshtë
- 51.** -Nga fjalët e mëposhtme ndani fonemat zanore dhe fonemat bashkëtingëllore.
- a) Fonemat zanore: arë, erë, ëndërr, orë, urë, syri
  - b) Fonemat bashkëtingëllore: bëj, copë, çaj, derë, dhëmb, rrotë, xham, zhduke.
- 52.** Në cilin rast është shkruar drejt kjo fjalë:
- a) në qoftëse
  - b) nëqoftë se
  - c) n.q.s.
  - d) në qoftë se.
- 53.** Rendit fjalët sipas llojit, sipas shembullit të dhënë:
- Ju jeni një shok i mirë.
- Ju – përemër  
jeni –  
një –  
shok –  
i mirë -
- 54.** Në cilin rast emërtimi gjeografik është shkruar drejt:
- a) Bregu i Fildishtë
  - b) bregu i Fildishtë
  - c) bregu i fildishtë
  - d) Bregu i fildishtë.

55. Në vargjet “Se të qante kur **të qeshnin**, se të veshte kur **të zhveshnin**”, fjalët me të zeza janë?

- a) Sinonime
- b) Antonime
- c) Homonime
- d) Metonimi

56. Nënvizu rrënjët e foljeve të dhëna

Vrapoj, shqep, trimëri

57. Trego se cilës pjesë të ligjeratës i takojnë fjalët e nënvizuara në fjalinë e dhënë:

Përse shkove tek Agroni?

Shkruaj për secilën fjalë cilës pjesë të ligjeratës i takon:

---

---

---

58. Sipas kumtimit dhe intonacionit fjalitë e thjeshta ndahen në fjali:

- a) dëftore
- b) dëftore-thirrmore
- c) nxitëse
- d) nxitëse thirrmore
- e) pyetëse
- f) pyetëse-thirrmore
- g) dëshirore

Rretho shkronjën para atyre të cilat në fund marrin pikëçuditjen (!)

59. Lexo me kujdes shembujt e mëposhtëm :

*Baltë e kuqe*

*Shkruaj letër*

***i ri** nga mosha*

Shkruaj çfarë togfjalësha janë:

---

---

---

60. Përdorimi i regjistrave të ndryshëm varet nga:

- a) Veçoritë gramatikore të gjuhës
- b) Niveli kulturor i folësit
- c) Situata e komunikimit
- d) Niveli kulturor i dëgjuesit

**61.** Në fjalët e mëposhtme nënvizo rrënjën e tyre:

1) Punoj, punim, i papunë, punëtor, punësoj, përpunoj

2) Shkruaj rrënjët e fjalëve:

Padrejtësi \_\_\_\_\_

Këngëtar \_\_\_\_\_

Fletorja \_\_\_\_\_

Zhvendosje \_\_\_\_\_

Këmbësorët \_\_\_\_\_

Nëntokësor \_\_\_\_\_

**62.** Më shumë ndryshime midis dialekteve të shqipes vërehen në:

1)

a) Fonetikë

b) Morfologji

c) Sintaksë

d) Leksik

2) Dy dialektet e shqipes janë:

a) me bazë territoriale

b) me bazë sociale

c) me bazë profesionale

d) me bazë kulturore

3) Si kufi natyror midis dialekteve të shqipes merret:

a) Vjosa

b) Semani

c) Shkumbini

d) Mati

**63.** Fjalët e mëposhtme shndërroni në trajtën e shquar.

Vegël \_\_\_\_\_

Gogël \_\_\_\_\_

Pupël \_\_\_\_\_

Vepër \_\_\_\_\_

Kokërr \_\_\_\_\_

Kabëll \_\_\_\_\_

I sotëm \_\_\_\_\_

Nxënës \_\_\_\_\_

cinizëm \_\_\_\_\_

Njerëz \_\_\_\_\_

I cekët \_\_\_\_\_

Kur humbet zanorja -ë?

- 64.** Lexoni me kujdes këto dy fjali dhe shkruani në vizë cila është fjali kalimtare dhe cila jokalimtare:
- Hape dritaren, Agron! \_\_\_\_\_
- Kam lindur në Krujë. \_\_\_\_\_
- 65.** Cilës klasë i përkasin antonimet: përpjetë, tatëpjetë, afër, larg.
- Mbiemra
  - Emra
  - Ndajfolje
  - Parafjalë
- 66.** Si quhet njësia sintaksore që merr pjesë në ndërtimin e fjalisë dhe që përbëhet, nga dy a më shumë fjalë kuptimplota, të cilat kanë lidhje të ngushta gramatikore e kuptimore me njëra tjetrën ?
- P.sh.,  
detyra të mëdha, bukë gruri, dy nxënës, mot me diell, shumë ditë etj.).
- Këto fjalë quhen: \_\_\_\_\_
- 67.** Pranë emrit të nënvizuar shkruaj rasën e tyre:
- Prej **luleve** morën nektarin. \_\_\_\_\_
- Aty takova **shokët** e klasës. \_\_\_\_\_
- Degët **e lisit** ishin thyer. \_\_\_\_\_
- Ca **lule** nuk kanë aromë. \_\_\_\_\_
- 68.** Lexo fjalitë e dhëna dhe trego cila prej tyre është nxitëse;
- Zemra i dridhej kur kujtonte vendlindjen.
  - A mos e kishte marrë malli për tingëllimën e zileve e për zërat e barinjve?
  - Nisemi, pra! –foli Albani.
- Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**69.** Në tekstin e shkruar gjeji fjalitë pyetëse.

- Osmanët na dogjën fshatin dhe morën gjithë bagëtinë.

Skënderbeu i përkëledhi flokët.

Si të quajnë o trim.

Tanush.

Mirë, Tanush i vogël. Si munde të vish deri këtu.

I di të gjitha rrugicat.

A mundem të vij edhe unë me ju. ....

---

---

---

**70.** Cilat trajta të pjesores janë të rregullta:

a) ngjallë, mbyllë, çelë, korrë

b) dalë, marrë, vjelë, sjellë,

c) dalur, vjellur, ndjellur

d) goditë, përplasë, falë, hapë

**71.** Cilat trajta të urdhërores së foljeve që vijojnë janë të rregullta:

a) hyrë, folë, bjerë, shpjerë,

b) zur, vur, nxë, vër

c) bjer, n xirr, lër, vër

d) mirr, kreh, jip

**72.** Lexo fjalitë e poshtëshënuara dhe dallo fjalinë e vetme burokratike

a) Ju jeni i mirëseardhur në shtëpinë tonë.

b) Nuk kam kohë të merrem me punët e tua, dil jashtë!

c) Dëshiroj edhe unë të vij me ju.

**73.** - Shkruaj fjalët sinonime të fjalëve të mëposhtme:

rrugë \_\_\_\_\_

trim \_\_\_\_\_

filloj \_\_\_\_\_

zë \_\_\_\_\_

duroj \_\_\_\_\_

**74.** Dallo fjalitë me një gjymtyrë kryesore nga ato me dy gjymtyrë kryesore.

- a) Heshtja e gjatë.
- b) Dimër i ashpër.
- c) Majat e maleve u mbuluan nga dëbora.
- d) Përreth tij qëndrojnë malet e patundura.

Cilat fjali janë njëkryegjymtyrëshe, dhe cilat dykryegjymtyrëshe?

---

---

**75.** Cila formë e pronorit është përdorur drejt:

- a) Ia dhashë mikes tënde,
- b) Ia dhashë mikes Tuaj
- c) Ia dhashë mikes sate
- d) Ia dhashë mikes tate

**76.** Lexo fjalinë e dhënë dhe trego llojet e fjalëve me të cilat është ndërtuar kjo fjali.

Ua! Mos jeni ju ata dy valltarët e vegjël.

p.sh.

Ua ----- pasthirmë;

Mos ----- \_\_\_\_\_;

jeni ----- \_\_\_\_\_;

ju ----- \_\_\_\_\_;

ata ----- \_\_\_\_\_;

dy ----- \_\_\_\_\_;

valltarët ---- \_\_\_\_\_;

e vegjël ----- \_\_\_\_\_.

**77.** Vendose në rasën e duhur përemrin në kllapa:

Ha!Ha!Ha! Ti shportë e vogël do të ma plotësosh  
....(unë) dëshirën?! Largohuni tani! – dhe bëri një  
gjest që u thoshte .....(ata) të largoheshin.

Era gënjeshtare lot me .....(unë) dhe shpërndan  
mall e këngë të vjetra luftime. Përse, fjala vjen, të mos  
dal unë bashkë me .....(ti) dhe Jakobin në shëtitje?  
Vetëm disave iu dha e drejta t'ua bashkoheshin ....(ata).

Po as ti nuk u ndihmon .....(ata) për të kuptuar

**78.** Në cilën fjali përemri lidhor është përdorur gabim:

- a) Populli ynë është mikpritës
- b) Populli i ynë është mikpritës
- c) Popullit tonë i duhet të ruajë virtytet e vjetra.
- d) Popullin tonë nuk e njohin mirë.

**79.** Në vijat përkatëse përballë fjalive të poshtëshënuara shkruaj rasën e emrit të nënvizuar:

Mësuesin e pashë para oborrit të shkollës. \_\_\_\_\_

Detyra e mësuesit është e shenjtë. \_\_\_\_\_

Mësuesi im është i sjellshëm. \_\_\_\_\_

Prej mësuesit mësojmë shumë gjëra. \_\_\_\_\_

Mësuesit i dhanë një dhuratë. \_\_\_\_\_

**80.** Në cilën fjali përemri lidhor është përdorur gabim:

a) Ishte kali luftëtar i Skënderbeut, që vajtonte të zotin.

b) Ishte kali luftëtar i Skënderbeut, i cili vajtonte të zotin.

c) Një emër që duhet t'i besoni.

d) Një emër të cilit duhet t'i besoni.

**81.** Në vend të pikave vendos njërën nga foljet në kllapa:

(Qenka prishur, u pastruaka, qenkëshin, qoftë gëzuar, u plakshin)

Ato punë .....bërë lëmsh.

Më pëlqen urimi: “.....bashkë!”

Si ..... moti kaq shpejt?

.....ai që na solli këtë lajm të mirë!

Mos u mërzit, se kjo njollë ..... shpejt.

**82.** Foljet e mëposhtme ktheji nga forma veprorë në formën joveprorë duke ruajtur vetën, numrin, kohën dhe mënyrën:

- të kishit dëgjuar .....

- kënduaka .....

- do të kishe parë .....

- pastruan .....

- ka veshur .....

- haptë .....

- do të pëlqesh .....

- mbarojnë .....

**83.** Në vend të pikave vendos njërën nga foljet në kllapa: (do të ishim mbledhur, të mbushet, do të shërohesh, të njihej, do të isha zgjuar, të hidheshin)

Sot të kërkoj ..... shporta me florinj.

Po ta dija, .....më herët atë ditë.

Mbreti i urtë urdhëroi që copat e atij poçi të shtrenjtë ...

në det. Po të kishe ardhur edhe ti, .....të gjithë bashkë si dikur.

Ajo e ka takuar kalorësin përpara se.....me ty.

Po të tregohesh më i rregullt me ilaçet,.....më shpejt.



**84.** “Çdo çifti të fjalive që është shkruar me gjuhë burokratike hiqja një vizë:

- a) Meteorologët presin se koha do të ftohet. – Meteorologët presin se do të vijë një periudhë me temperatura të ulëta.
- b) I kryejmë punët rreth veshjes së mobilieve. – I veshim mobilet.
- c) Nuk kemi mjaft mjete financiare. – Nuk kemi mjaft të holla.
- d) Çmimet janë rritur përsëri. – Përsëri është bërë rritja e çmimeve.

**85.** Fjalinë e mëposhtme shkruaj sipas normave dhe mirësjelljes:

Hiqe (largoje) nga koka këtë problem. Këtë e vendos unë.

---

**86.** Pasi të gesh emrat në fragmentin e mëposhtëm, ndaji dhe nënvizoji emrat e gjinisë mashkullore dhe femërore:

Fusha!... Jo, o djem të lumtur e të shëndoshë të fshatit, që me të kapërcyer pragun e shtëpisë dilni në mes të lëndinave të hapura, nën atë kupën e kaltër e qiellore, ju o syshqiponja, të mësuara të kundroni atë det të pamatur gjelbërimi, ju që nuk jetoni të ndrydhur në mes të shtëpive të larta, jo, ju nuk e merrni me mend se çdo të thotë një shesh i hapur për një djalë të Budapestit.

Emrat e gjinisë femërore	Emrat e gjinisë mashkullore

**87.** T’i bëjmë sytë katër = T’i hapim sytë.

Vëri gishtin kokës! = Mendo.

Mos ia qani hallin = Mos e ankoni.

Nuk futen të gjithë njerëzit në një thes = Nuk barazohen të gjithë njerëzit.

Shembujt e paraqitur janë:

- a) sinonime
- b) antonime
- c) shprehje frazeologjike
- ç) homonime

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**88.** Në ç' mënyrë dhe kohë është folja e shkruar me shkronja të zeza: "Skënderbeu do të kishte rënë në pusi, sikur **të** mos e kishte shpëtuar një ushtar besnik."?

- a) Më se e kryer dëftore
- b) E kryer kushtore
- c) E kryer lidhore
- d) Më se e kryer lidhore

**89.** Në cilin rast janë përdorur drejt nyjat e përparme:

- a) Gjatë shëshitjes së së dielës
- b) Gjatë shëtitjes së të dielës
- c) Gjatë shëtitjes të të dielës
- d) Gjatë shëtitjes të së dielës

**90.** Cilës njësi leksikore i takojnë fjalët e mëposhtme:

Verë (stinë) – Verë (pije)

Fletë (prej letre) – fletë (si gjeth)

Çam (lloj bredhi) – Çam (banor i Çamërisë)

- a) sinonimisë
- b) antonimisë
- c) homonimisë

Rretho shkronjën pranë përgjigjes së saktë.

**91.** Në tekstin e mëposhtëm është nënvizuar një frazë.

Të lutem, **mbushja mendjen** se nuk bën ndryshe.

Cili është kuptimi i fjalës **mbushja mendjen**:

- a) Mendo mirë
- b) Mos u anko
- c) Bindeni

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**92.** Pranë fjalës së huaj shkruaj fjalët shqipe:

Elementar – \_\_\_\_\_

Bajrak – \_\_\_\_\_

Konkluzion – \_\_\_\_\_

Qorr – \_\_\_\_\_

**93.** Nënvizu fjalët shumëkuptimshe:

- a) faqe (njeriu, mali, libri)
- b) grykë (njeriu, shisheje, pushi, lumit)
- c) makinë, trup, jetë, ujë, tokë, i bardhë.

Rretho shkronjën para së cilës janë fjalët shumëkuptimshe?

**94.** Tregoni kuptimin e frazës që kemi nënvizuar në tekstin e mëposhtëm:

Dukesh shumë i shqetësuar. Çfarë të ka ndodhur? E pyeti Ana?

Eh, ulu se do t'i them një për një!

- a) Do t'i thotë diçka të rëndësishme.
  - b) Do t'ia thotë të gjitha
  - c) Do ta qortoj.
- 

**95.** Në planin kuptimor si ndahen shprehjet frazeologjike:

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_

**96.** Në tekstin e mëposhtëm është nënvizuar një frazë

- Ç'pate që e humbe gojën, Luis? – i tha pronari.
- Apo edhe ti je përzier në këto punë?

Çfarë është kuptimi i frazës – e humbi gojën?

- a) kemi bërë pauzë në të folurit
- b) u bëmë memec, nuk na shkon fjala
- c) kemi harruar çka donim të thoshnim
- d) ndërpres dikë në të folurit

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**97.** Lexo fjalët e huaja dhe shkruaj kuptimin e tyre në gjuhën shqipe:

- Barrierë –
- Devijoj –
- Moment –
- Ofendoj –
- Bulevard –
- Kolonë –
- Presion –

- 98.** Lexo fjalitë e dhëna dhe në vend të fjalëve të nënvizuara shkruaj fjalët përkatëse shqipe.
- a) Një pjesë e anëtarëve të këshillit të klasës morën pjesë direkt / \_\_\_\_\_ në mbledhje.
  - b) Nxënësit u adaptuan/ \_\_\_\_\_ shumë shpejt në shkollë.
  - c) Tufani përplas penxheret/ \_\_\_\_\_ e shkallmuara të shtëpive.

**99.** Cilat tipare i përkasin mënyrës lidhore:

- a) Tregon një veprim të mundshëm
- b) Ka përpara pjesëzën do të
- c) Shpreh një dëshirë të folësit
- d) Shpreh një veprim të papritur

**100.** Në çfarë marrëdhënie të ndërsjellë janë fjalët:

gëzim-hidhërim  
ditë-natë  
dritë-errësirë  
verë-dimër

- a) Homonime,
- b) Sinonime,
- c) Antonime.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**101.** Lexo këtë fragment nga vepra “Arti dhe historia e tij”.

“Megjithatë, tipari më i rëndësishëm i arkitekturës romake, është përdorimi i harqeve. Kjo shpikje ka luajtur rol krejtësisht të vogël ose nuk ka luajtur fare në ndërtimtarinë greke, edhe pse, me siguri ka qenë e njohur për ndërtuesit grekë. Të ndërtosh harkun nga gurët trapezoidalë është shkathhtësi mjaft e ndërlikuar në ndërtimtarinë”.

1. Fjala “ndërtues” domethënë:

- a) Skulptor
- b) Historian
- c) Ndërtimtar
- d) Hartues

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

2. Shkruaj fjalën e cila e ka kuptimin e njëjtë si fjala “tipar” nga fjalia e parë.

---

**102.** Lexo kuptimet e mëposhtme të fjalës kuzhinë të cilat janë nxjerrë nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* dhe përgjigju në pyetjen: Cili është kuptimi i saktë i fjalës kuzhinë?

KUZHINË f. sh.

1. Kthinë e veçantë në një shtëpi a në një ndërtesë, pranë një ndërmarrjeje prodhimi etj., me pajisjet e nevojshme (me sobë, enë etj.), ku përgatiten dhe gatuhën gjellët; vendi ku gatuhën gjellët. *Kuzhinë e madhe (e vogël). Kuzhina e kantierit (e spitalit, e konviktit). Kuzhinë me aneks. Dy dhoma e një kuzhinë. Dollap kuzhine. Enë kuzhine.*
2. Mënyra e përgatitjes dhe e gatimit të gjellëve, mjeshtëria e gatimit; përmb. gjellët e gatuar sipas kësaj mënyre; gjellët më karakteristike për një popull. *Kuzhinë e mirë (e lehtë). Kuzhina shqiptare. Kuzhina evropiane (orientale). Arti i kuzhinës.*

---

**103.** Lexo me vëmendje tekstin e mëposhtëm dhe zëvendëso ato me fjalë shqipe sipas shembullit të dhënë:

Kreshniku është një nxënës që ka influencë të madhe te shokët dhe shoqet e klasës. Ai nuk abuzon mirësinë e shokëve dhe të shoqeve dhe i aprovon kritikën dhe vërejtjet e tyre.

Influencë                      – **ndikim**  
\_\_\_\_\_ – \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ – \_\_\_\_\_

**104.** Lexo me vëmendje përkufizimet e mëposhtme:

a) Vepër e madhe shkencore që përfshin njohuri për të gjitha fushat e jetës e të veprimtarisë të sistemuara në mënyrë të përmbledhur në trajtën e një fjalori; vepër e tillë që përfshin njohuri për një degë të veçantë të shkencës, të artit, të teknikës.

b) Tërësia e dijeve që ka dikush në një fushë të caktuar; tërësia e ideve dhe e nocioneve bazë të një shkence a të një fushe të caktuar; dituri.

Rretho shkronjën para nocionit që ka të bëjë me enciklopedinë.

Kujt i referohet shprehja \*enciklopedi e gjallë:

---

**105.** Nga pikëpamja kuptimore kundrinori tregon:

- a) Atë që kryen veprimin
- b) Cilësi të emrit
- c) Objektin e veprimit
- d) Atë që pëson veprimin

**106.** Kallëzues i kundrinorit të drejtë nuk mund të jetë:

- a) Një mbiemër
- b) Një emër
- c) Një grup emëror
- d) Një grup parafjalor

**107.** Cila nga veçoritë e mëposhtme i përket rrethanorit:

- a) Lidhet me kryefjalën
- b) Nuk mund të hiqet lehtësisht nga fjalia
- c) Tregon rrethanë veprimi
- d) Përshtatet në gjini, numër dhe rasë me kryefjalën

**108.** Cili nga mbiemrat në fjalitë e mëposhtme shërben si përcaktor:

- a) Agroni ishte shumë i sjellshëm
- b) I dua mollët të mëdha
- c) Ujërat e rrëmbyera përmytën të mbjellat
- d) E gjeti dritaren të hapur

**109.** Thoni ç'gjymtyrë e fjalisë është fjala me të zeza: "Fëmijët ishin përhapur **fushës**"?

- a) Kundrinor i zhdrejtë
- b) Rrethanor vendi
- c) Përcaktor
- d) Kundrinor i drejtë
- e) Atë që pëson veprimin

**110.** Janë folje kalimtare ato që:

- a) Tregojnë lëvizje
- b) Tregojnë gjendje
- c) Janë në formën pësore
- d) Marrin kundrinorë

**111.** Kur fjalia shndërrohet nga veprorë në pësore, kryefjala bëhet:

- a) Kundrinor i drejtë
- b) Kundrinor me parafjalë
- c) Rrethanor
- d) Kundrinor pa parafjalë

**112.** Fjalja pyetëse tërësore përqendrohet te:

- a) kryefjala
- b) përcaktori
- c) kundrinori
- d) kallëzuesi

**113.** Shënoni fjalitë dëftore:

- a) Ç'fytyrë engjëllore që kishte
- b) Sjellja e zbukuron njeriun
- c) Po ky ç'kërkon këtu
- d) Ah, sikur të kisha një pikë ujë

**114.** Fjalisë pa folje i mungon:

- a) Uniteti i kuptimit
- b) Lidhja gramatikore
- c) intonacioni
- d) kallëzuesi

**115.** Në cilën fjali folja është jokalimtare:

- a) Vanjka hodhi sytë nga dritarja.
- b) Tani gjyshi rri te porta.
- c) Gjyshi kapsallit sytë.
- d) Ai bën shaka me portierin.

## Letërsia

**116.** Lidh me vijë lidhëse titujt e veprave artistike me autorët përkatës: Një titull i veprës është i tepërt.

- |                            |                                     |
|----------------------------|-------------------------------------|
| 1. Konstantin Krisoforidhi | 1. “Poema e mjerimit”               |
| 2. Andon Z.Çajupi          | 2. “Anës lumenjve”                  |
| 3. Migjeni                 | 3. “Trimi i mirë me shumë shokë”    |
| 4. Fan S. Noli             | 4. “14 vjeç dhëndër”                |
| 5. Hivzi Sulejmani         | 5. “Gjahu i malësorëve”             |
| 6. Sulejman Pitarka        | 6. “Njerëzit”                       |
|                            | 7. “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” |

**117.** Krijimi letrar “14 vjeç dhëndër” i Andon.Z.Çajupit është:

- a) Poezi epike
- b) Poezi dramatike
- c) Poezi lirike

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**118.** Lidh titujt e veprave letrare me anë të vizave me emrat e autorëve

- a) Ismail Kadare \_\_\_\_\_ “Sarajet e bardha”
- b) Vehbi Kikaj \_\_\_\_\_ “Bagëti e bujqësi”
- c) Naim Frashëri \_\_\_\_\_ “Zogu dhe kulla2
- d) Xhani Rodari \_\_\_\_\_ “Kështjella”
- e) Rrahman Dedaj \_\_\_\_\_ “Aventurat e Çipolinos”

**119.** Kush është autor i Gramatikës së gjuhës shqipe “Shkronjtore e gjuhës shqipe” (1886)?

- a) Konstandin Kristoforidhi
- b) Jeronim de Rada
- c) Sami Frashëri
- d) Naim Frashëri

**120.** Para vetes i ke dy vjersha të shkruara në dy krijimtari letrare. Cila prej tyre i takon asaj gojore?

- a) - Ç’ke, o flamur, që s’valon?  
- Jam sëmurë e po rënkoj,  
jam goditur brinjë më brinjë,  
që kur sollën Italinë...”
- b) “Tokë e dashur,  
Ti diçka ke kërkuar nga unë.  
“Ndryshomë, o bir” – më ke thirrur nga grykat e maleve.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.



**121.** Këngët e kreshnikëve, këngët për Mujin dhe Halilin dhe kreshnikëve të tjerë janë këngë që i takojnë:

- a) Lirikës
- b) Epikës
- c) Dramës

**122.** Lexo me kujdes vargjet e mëposhtme:

Dheu m`ka mlue, e fat s`i qita vedit  
Po s`mora Tanushën e krajlit.  
E unë Tanushën vetë e ko`pa,  
Kur kena pas besë me krajli:  
Gja ma t`mirë s`sheh njeriu nën kët qiell!  
Vetulla e saj drejt si fiskaja,  
Shteku i ballit, si shteku i malit  
Kur nerr hana me prarue;  
Syni i saj, si kokrra e qershisë,  
E ka qerpikun, si krahi i dallëndyshës;  
Ftyra e saj, si kuqet molla n`degë  
Hunda e drejtë-o, si kalemi Tanushës;...

Trego cilit cikël të këngëve popullore u takojnë këto vargje:

- a) ciklit të këngëve të kreshnikëve;
- b) ciklit të këngëve legjendare;
- c) ciklit të këngëve baritore;
- d) ciklit të këngëve të djepit.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**123.** Shkrimi i cili paraqet njerëzit, ngjarjet dhe dukuritë e ndryshme në çastin kur shihen, i cili shkrim dallon shumë nga romani, tregimi, novela, etj., sepse këtu ngjarjet paraqiten me më shumë saktësi dhe përshkrimet janë të vërteta. Në këto shkrime nuk ka trillime, pavarësisht se autori i shkruan ato nga këndvështrimi i tij.

Si quhet ky lloj shkrimi?

- a) Ditar;
- b) Kronikë;
- c) Reportazh;
- d) fejton.

**124.** 1. Cilës gjini letrare i takon përralla?

---

**125.** Lexo fjalitë e dhëna dhe qarko përgjigjen e saktë:

- a) Kënga e Dhoqinës trajton motivin e mikpritjes. Po Jo
- b) Gjergj Fishta ishte prift. Po Jo
- c) Zoga është shkëputur nga poema “Andrra e jetës”. Po Jo
- ç) La Fonteni është shkrimtar anglez. Po Jo
- d) Emri i vërtetë i Lasgush Poradecit është Dhimitër Pasko. Po Jo

**126.** Në cilën fjali kemi fjalë onomatopeike:

- a) Flokë-flokë, ngadalë, po bie borë.
- b) Bletët zukatnin në lëndinën me bar e lule.
- c) Zogjtë vërtetin rreth e rrotull.
- d) Bora shkruan trëndafila të argjendtë

**127.** Lexo me kujdes vargjet e mëposhtme dhe shkruaj sa rrokëshe janë:

Do të shkrihem  
Të Venitem,  
Si kandili kur s’ka vaj,  
Balt’ e pluhur  
Do të bëhem,  
Të më shkelnjë këmb’ e saj.

(“Bukurija”, 10, Naim Frashëri)

**128.** Vargu apo strofa e cila përsëritet disa herë në një poezi a këngë popullore quhet:

- a) Figurë stilistike;
- b) Rimë;
- c) Refren;
- d) Varg.

**129.** Përputhja e tingujve në fund të vargjeve formon:

- a) Figurën stilistike;
- b) Rimën;
- c) Strofën;
- d) Vargun.

**130.**

a) „Mori Shkodër, moj mizore,  
Pak u duke e shumë na dole;  
Tan asqeri na e mbarove,  
Tu ba luftë me shtatë tabore.”

b) “ zbret thëllëzë ‘e malit,  
Zbret duke kënduar;  
N’odë të beharit  
Dy qilima shtruar.”

Ju keni për detyrë t’i lexoni vargjet e të dy poezive dhe të thoni se prej sa rrokjesh përbëhen vargjet e poezisë së parë dhe prej sa rrokjesh përbëhen vargjet e poezisë së dytë:

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

**131.** Lexo me kujdes vargjet e poezisë së dhënë dhe dallo se me çfarë lloji të rimës janë ndërtuar:

Përmbi za që lshon bylbyli,  
gjuha shqipe m’shungullon;  
përmbi er’ që jep zymbyli,  
pa da zemren ma ngushllon.

- a) rima të puthitur (aa/bb);
- b) rimë të ndërlikueme(ab/ab);
- c) rimë të grumbullueme(aaa);
- d) rimë vargnore(aba/bcb/mnmm/).

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**132.** Në linjë pas secilit fragment shkruaj si quhet forma e të folurit (monolog, dialog, përshkrim, rrëfim)

Kur kullosnin delet dhe qengjat në lëndinë, ne nuk frikësoheshim fare se do të na humbshin... Ishim më të qetë për t'u marrë me ndonjë nga lojërat e shumta që dinim. Kur gjendeshin delet në lëndinë tërë përkujdesjen e ruajtjes së tyre ia lënim qenit tonë i cili linte të shpërndaheshin. Posa hetonte se ndonjëra nga delet ose qengjat, lakmonte kah dushkaja –qeni i dilte përpara dhe, me dy të lehura, e kthente prapë në kope. Meqenëse të gjitha delet frikësoheshin nga qeni, shpesh as që provonin të futeshin në dushkajë. Forma e të folurit është \_\_\_\_\_

Nuk duhet menduar shumë – tha me vete dhe hyri në librari. Ndoshta nuk do të jetë aq e shtrenjtë, ndoshta... – tha me vete. Forma e të folurit është \_\_\_\_\_

-Po besa... Në tren!... Në tren do të kishte qenë më mirë se aty do të na kishin zënë si lepujt: kap e hajt! Pa bileta në xhep – në tren!

-E edhe po të na zinin pa bileta.... çdo të bëhej?... Asgjë. Na zbresin e hajt!

-Ti je i marrë!

-Pse?- pyeti Urimi. –I marrë, po thua? Premtim, shumë po tutesh. Nuk të bën kjo, s'të shkon. Na zënë pa bileta...

- Po, ani de! Në na zënçin, vetëm na zbresin e kurrigjë kurrkujt! Forma e të folurit është \_\_\_\_\_

Mbante në dorë një ombrellë të kaltër, në qafë kishte lidhur një shall të madh të gjelbër, i cili ishte shumë i bukur dhe valëvitej nga puhia e lehtë. Kishte mbathur këpucë me take të larta dhe pak të çuditshme, por edhe ato ishin të bukura shumë. Fustanin e kishte të bardhë, të gjatë dhe më të bukur se çdo gjë tjetër që vishte. Në kokë kishte një kapelë të rrumbullakët prej kashte. Në të kishte ngjitur edhe ca lule, për të cilat nuk dinte askush se ishin artificiale apo të vërteta. Forma e të folurit është \_\_\_\_\_

**133.** Elefanti është kafshë barngrënëse që jeton në Afrikë e Azi. Është kafsha më e madhe në tokë. Meshkujt elefantë janë të mëdhenj dhe mund të arrijnë peshën gjer në 9071 kg. Ata kanë një hundë të gjatë me të cilën kryejnë një seri veprimesh. Elefanti konsiderohet si kafsha e katërt më e zgjuar në botë, pas shimpanzës, balenës dhe delfinit. Elefanti me gjithë peshën e tij të rëndë mund të vrapojë me shpejtësi rreth 40 km/h duke ia kaluar edhe njeriut. Elefantet u tremben lepujve dhe qenve qofshin këta edhe të vegjël.

Lexo tekstin që ka të bëjë me elefantin dhe trego cilit lloj të tekstit i takon?

- a) Deskriptiv;
- b) Narrativ;
- c) Informativ;
- d) Tekstit argumentues.

**134.** -Në fund të fragmentit trego se cilës formë të të folurit (të rrëfyerit) i përket (monologu, dialogu ose përshkrimi);

-Ja, futuni aty nën tryezë!

-Si?

- E do puna që ta fshehni mirë.

-Pse nën tryezë?

-Bëni siç ju thonë;

-E di unë pse, dhe kini për të parë.

-Pa futuni aty dhe ruajuni

-Që mos t'ju shohin e mos t'ju dëgjojnë.

-Po bëj siç thoni, s'jua prish:

-Të shohim çfarë do të na nxirrni në shesh, vallë.

- a) Monolog
- b) Përshkrim
- c) Dialog

**135.** Në fund të fragmentit trego se cilës formë të të folurit (të rrëfyerit) i përket shkrimi;

-Nuk di si t'ia bëj, do të filloj të bërtas. Dua t'ia them një nga një dhe do ta marr me të mirë. Sa kollaj që gënjehen këta burra! Mirë thonë se gruaja është vetë dreqi, ia fut burrit të dy këmbët në një këpucë. Vera që shkoi e kalova me dhjetë napolona gjersa i shpura në tridhjetë e pesë; ashtu do të bëj edhe këtë radhë, por ndoshta mos zemërohet e s'bëhet gjë! Sa për atë, e dimë ne gratë, sështë nevoja të na mësojë njeri!

- a) Komentit
- b) Dialogut
- c) Monologut

**136.** “Atje lind dielli i qeshur dhe hëna e gëzuar

Fat'i bardhë mirësija n'atë vend janë mbuluar”

N.Frashëri

Lexoni vargjet e lartshënuara të N.Frashërit dhe shkruaj se cilën figurë stilistike e përdor poeti;

- a) Antitezën
- b) Epitetin
- c) Alegorinë

**137.** - Lexoji vargjet e poshtëshënuara, të cilat janë nxjerrë nga poezia “Dashuria”

e Andon Z.Çajupit dhe shkruaj se cila figurë stilistike është përdorur në këto vargje:

...ballet si diell, faqet si mollë  
qafa jot e gjatë, mesi yt i hollë  
sisetë si shegë, dhëmbët si thelpInjë  
buzët si burbuqe, sytë si gështenjë:

- Në këto vargje është përdorur:

- a) Epiteti
- b) Krahasimi
- c) Onomatopea

**138.** - Lexo vargjet e poshtëshënuara dhe shkruaj cila figurë është përdorur:

- Sytë e zinjë  
- flokë të mëndafshtë  
- sy të bukur e të mëdhenj  
- buzë të kuqe

- a) Krahasimi
- b) Epiteti

**139.** - Në tekste të ndryshme letrare shpeshherë autorët përdorin shprehje që përshkruajnë cicërimën e zogjve, hingëllimën e kuajve, gurgullimën e ujit... etj

- Pra, shprehjet e këtilla në letërsi quhen:

- a) Epitet
- b) Onomatope
- c) Krahasim

## NIVELI I MESËM

### Shkathësitë e të lexuarit dhe të kuptuarit e leximit

**140.** Lexo këto fjali. Njëra prej tyre është reklamë, kurse të tjerat janë përshkrime teknike, udhëzime. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) Shiko këto kombinime të thjeshta
- b) Bëhu aktiv, fol me miq!
- c) Mos e prekni pa nevojë antenën!
- d) Shifra e sigurimit ju ndihmon të ruani telefonin tuaj.

**141.** Ndërmarrja tregtare “Besa”

Kjo organizatë tregtare është e njohur jo vetëm në qytetin tonë, por edhe më gjërë. Prodhimet e kësaj ndërmarrjeje gjithnjë janë cilësore dhe me afat të paraparë të përdorimit të tyre.

Ne sot po bëjmë prezantimin e mallrave dhe të artikujve tanë me qëllim të njoftimit të konsumatorëve tanë të rregullt se çfarë janë artikujt me të cilët ata pajisen gati çdo ditë.

Ju mirëpresim në shitoret tona.

Ndërmarrja “Besa”

Lexo tekstin e lartshënuar dhe shkruaj cilës gjini i takon:

- a) Letrare
- b) Jo letrare

**142.** Lexo me kujdes tekstin e mëposhtëm dhe shkruaj cili përkufizim është përshkrim:

- a) Lloj tregimtar i prozës së shkurtër letrare a publicistike, në të cilin jepen, pa hyrë në analizën e lidhjeve të brendshme të gjërave, tiparet e një njeriu, të natyrës etj. ose përshkruhet një dukuri e jetës, një ngjarje.
- b) Vepër e vogël letrare në prozë, në të cilën përshkruhet zakonisht në një vijë një çast ose një ngjarje me rëndësi nga jeta e një heroi a personazhi, pa dhënë në mënyrë të hollësishme se ç’ka ndodhur më përpara a më pas.
- c) Njoftim që marrim për diçka, të dhëna për gjendjen e punëve në një fushë të caktuar, për veprimtarinë e dikujt, për një ngjarje etj.; kumtim a lajm që jepet për dikë a për diçka

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë

**143.** Ki kujdes për stilin me të cilin është shkruar teksti i mëposhtëm:

Linda më 29 nëntor 1814 në Maqë, koloni e vogël arbëreshe e Kalabrisë, e vendosur mbi një kodrinë të hapët, përballë detit Jon. Nëna ime, prej shtëpisë Braille, atëherë trashëgimtare e dy familjeve të vjetra, Avaiti e Sqiljizi, kishte lindur në koloninë e afërt Strigari. Stërgjyshërit e babait rridhnin ndoshta nga njëfarë Pjetër Anton Rada nga Shqipëria, për të cilin në arkivin e Venedikut të vitit 1300 ndodhet një kontratë për shitblerje me Dogjen. Njëfarë Pjetër Antoni është i pari i shtëpisë Rada.

Paragrafi i mësipërm është tekst:

- a) Informativ
- b) Autobiografik
- c) Argumentues
- d) Paraqitës

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**144.** Ki kujdes për stilin me të cilin është shkruar ky tekst.

**Jam mirënjohëse për dashurinë që i dhe nënës dhe motrës sime”**

Nga dosja mbushur me materiale për Nënë Terezën dalin edhe dy letra drejtuar Marie Krajës. Është e njohur tashmë miqësia që artistja e njohur shqiptare ka pasur me familjen e bamirëses. Vetë Kraja ka rrëfyer pas vdekjes së Nënë Terezës kujtimet e ruajtura nga familja e saj, Nënë Lokja dhe motra Age, por edhe takimet e para. Letra e parë mban datën 15 gusht të vitit 1989, vetëm pak ditë pasi Nënë Tereza ishte larguar nga Shqipëria, pas vizitës së parë në atdheun që i ishte mohuar. Letra e dytë është dërguar po në tetor të atij viti, si përgjigje e letrës që Kraja i kishte dërguar bamirëses

Fragmenti i takon tekstit i cili, sipas stilit funksional hyn në:

- a) Letrar-artistik
- b) Letrar
- c) Shkencor
- d) Gazetaresk



**145.** Lexo tekstin e mëposhtëm dhe shkruaj cilit stil i takon teksti i mëposhtëm:

Këngëtarja Rita Ora, e cila çdo ditë e më shumë është duke pushtuar skenat më të mëdha në botë, pritet të performojë së shpejti edhe në Prishtinë. Burime të afërta me këngëtarën kanë thënë se të afërmit e Ritës janë duke bërë përgatitjet për një koncert të madh të saj, i cili pritet të mbahet në Stadiumin e qytetit të Prishtinës. Koncerti i Ritës në Prishtinë nuk është lehtë të realizohet, pasi ajo pritet të fillojë së shpejti një turne, i cili do të fillojë në Britani të Madhe dhe pastaj edhe në shtete të tjera.

Teksti i mësipërm është shkruar në stilin:

- a) Stilin shkencor,
- b) Bisedimor
- c) Administrativ
- ç) Gazetaresk

**146.** Bashko emërtimin e stilit me veçori të dhëna në përshkrimin 1), 2), 3):

- a) Stili letrar-artistik \_\_\_\_
- b) Shkencor \_\_\_\_
- c) Administrativ - afarist \_\_\_\_

- 1) objektiviteti, saktësia, logjikshmëria, fjalët dhe shprehjet terminologjike
- 2) shkurtësia, qartësia, saktësia, njëkuptueshmëria
- 3) subjektiviteti, figurativiteti, shprehshmëria, përdorimi i mjeteve shprehëse figurative

**147.** Në bibliografinë e dhënë nën cilin numër gjendet Albert Dauzat, me veprën *L'Europe linguistique*?

BIBLIOGRAFI

Tani desha të jap disa shënime bibliografike. Ata që interesohen mund t'i ndjekin në disa gjuhë të ndryshme. Në veprat që do të jap këtu gjendet bibliografi e mëtejme.

1. Vepra e ANTOINE MEILLET e MARCEL COHEN *Les langues dans l'Europe nouvelle*, tregon përhapjen e gjuhëve të ndryshme në Europë.

2. Pokëta dy autorë kanë dhënë në vitin 1952 veprën *Les langues du monde*, ku jepen orientime jo vetëm për gjuhët indoeuropiane, po edhe për familje të tjera gjuhësore. Janë vepra me rëndësi.

3. ALBERT DAUZAT, linguisti i njohur francez, në vitin 1953 botoi veprën *L'Europe linguistique*.

4. Për gjuhësinë historike, për studimin krahasimtar të gjuhëve indoeuropiane, lidhur jo vetëm me gjuhësinë, po edhe me problemet e prehistorisë, për grupimin e gjuhëve indoeuropiane, megjithëse është mjaft e vjetër, mund të përdoret edhe sot vepra e HERMAN HIRT, *Die Indogermanen, ihre Verbreitung, ihre Urheimat und ihre Kultur*, në dy vëllime, Strassburg, 1905-1907.

5. Për studimin e gjuhëve vetë, mbetet me vlerë, megjithëse në disa pika është e vjetëruar, A. MEILLET, *Introduction à l'étude des langues indoeuropéennes*, botimi i shtatë 1934.

6. I mirë, sepse shkruar në një gjuhë popullore e të kuptueshme, është edhe libërthi i P. KRETSCHMERIT, që është përkthyer edhe shqip, *Ditunija gjuhore indogjermane*, Tiranë,

257

**148.** Lexoje me kujdes tekstin dhe shkruaj çfarë është:

Kanë pushtuar popuj me miliona banorë, por kanë qenë rob i një njeriu të vetëm. Kanë qenë të lavdishëm e të papërkulshëm, po një njeri i vetëm i ka bërë aq sa melankolikë dhe të thyeshëm. Autorë të veprave më të mëdha pa limit fantazie, po aq sa pengje të një letre dashurie. “Zot, çfarë do të bëhet me mua, tani që ti më ke privuar nga arsyeja?” i shkruan mbreti i letërsisë franceze, Honore de Balzak konteshës polake Evelina Hanska. Një tjetër shkrimtar, Volteri, për hir të dashurisë do të arratiset nga burgu për të qenë pranë të dashurës së vet Olymbe Dunover, një vajzë e varfër që ai e dashuronte marrëzisht. “Unë jam burgosur këtu në emër të mbretit; ata mund të më marrin jetën, por jo dashurinë që ndiej për ty”, i shkruan në vitin 1713 të dashurës së tij, disa minuta para se të arratiset. Por dashuria nuk është e bukur vetëm në letrat e shkrimtarëve, por edhe në atë të udhëheqësve. “Ti je jeta në mua. Kur ti nuk je pranë meje, unë pres kthimin tënd që të filloj të jetoj sërish”, i shkruan presidenti amerikan, Ronald Regan, bashkëshortes së tij për 31 vjetorin e martesës. Edhe Napoleoni, perandori i egër francez i shkruante me ëmbëlsi Zhozefinës, bashkëshortes së tij të parë. “Zhozefinë, do të të shoh brenda tri orëve. Deri atëherë, e dashura ime e ëmbël të dërgoj një mijë puthje, por mos më jep asnjë si shkëmbim, pasi ato ma ndezin gjakun më keq”.

Kush ka shkruar letra të këtilla? \_\_\_\_\_

Kujt i kanë shkruar? \_\_\_\_\_

Me çfarë gjuhe janë shkruar? \_\_\_\_\_

## 149. Si shkruhet ndonjë burim nëse nuk ka autor?

204

Jani Thomai

### C

cakthi - 77, 78  
cakulthi - 74, 77  
cangël - 182  
capëthi - 171, 181  
caphi - 66  
capunthi - 66  
carazi - 168  
cazë - 182  
cbërthyetë - 172  
cbërthytë - 186  
cek - 187  
cekas - 54  
cecash - 157, 158, 160  
cekët - 150, 184  
ceparakthi - 77  
cepazi - 40, 44  
cërk - 177  
cikas - 54, 55  
cilësisht - 113  
cimb - 73  
cimbthi - 73, 77, 78  
cingël - 79  
cingëlthi - 65, 72, 78, 79, 170  
cinglapjekthi - 76, 77, 78, 79  
cinglash - 42, 79, 157, 158, 160  
cinglazi - 35, 42, 44, 61, 79  
cingthi - 64, 170, 181  
citazi - 56  
citur - 178  
copa-copa - 19  
copash - 157, 158, 161  
copë - 177, 182  
copëthi - 170  
cofët - 150  
cubnisht - 31, 104, 174  
cullak - 182  
cung - 177  
cup - 176, 177, 183

curril - 177  
cvarazë - 168

### Ç

çak - 75  
çakaçukthi - 76, 77, 78  
çakthi - 75  
çalakëmbëzi - 59, 169  
çalamanthi - 65, 74  
çalapatas - 79  
çalapatthi - 76, 79  
çalas - 33, 35, 45, 62, 79  
çalë - 34, 74  
çalthi - 62, 65, 74, 78, 79  
çamërisht - 89, 90, 113, 173  
çapëthi - 170  
çaphi - 65, 71, 77  
çarazi - 51, 52  
çartakandas - 33, 35, 36, 60, 169, 182  
çartaqefas - 36, 60, 169, 182  
çartaqejfas - 58  
çartas - 35  
ças - 187  
çast - 187  
çasthi - 78  
çastthi - 64  
çefas - 168, 181  
çefëtë - 171  
çekisht - 89, 90, 174  
çeku - 181  
çekû - 187  
çelambyllas - 58  
çelë - 178, 185, 187  
çelët - 187  
çelëtë - 183, 185  
çeltas - 46, 47  
çeltazi - 46  
çetash - 157, 160

- a) Në tekstin e mësipërm të bibliografisë gjeni ndajfoljen cilësisht:  
b) Si shkruhet ndonjë burim nëse nuk ka autor?

---

---

---

## 150. Lexo tekstin e mëposhtëm dhe shkruaj cilit stil i takon:

Zemra është një muskul që ka një detyrë thelbësore, atë të qarkullimit të gjakut në të gjithë trupin. Është e ndarë në katër dhoma: dy veshkore dhe dy barkushe. Puna e pompës zhvillohet nga barkushja e majtë, që e shtyn gjakun në qarkun arterial periferik dhe nga barkushja e djathtë që e shtyn gjakun në sistemin qarkullues pulmonar. Në zemër gjithashtu është prezent edhe një qark elektrik, që ka për detyrë të aktivizojë dhe rregullojë kontraktimin kardiak. Në kushte normale, impulsi elektrik lind në njëjën sinoatriale që ndodhet në pjesën e sipërme të veshkores së djathtë dhe që aty shkon në njëjën atrioventrikolare, vend në të cilin kanë pikën e kontaktit të katër dhomat që përbëjnë zemrën, dhe nga, pasi ka pësuar një ngadalësim prej pak të qindrash në sekondë, kalon në barkushe. Normalisht frekuenca kardiake varion nga 60 në 100 rrahje në minutë dhe kontraktimet kanë një mënyrë të rregullt. Flitet për aritmi kur frekuenca kardiake nuk hyn në intervalin e mësipërm ose kur impulsi nuk lind në njëjën sinoatriale. Aritmia ndahet në bradikardi, kur frekuenca është më pak se 60 rrahje në minutë dhe takikardi kur frekuenca kalon 100 rrahjet në minutë.

Teksti i takon stilit:

- a) Administrativ,  
b) Shkencor  
c) Gazetaresk  
d) bisedimor

## 151. Autori 1

Para pak kohe në 40 shkolla është bërë anketimi i cili ka të bëjë me dhunën e cila është e pranishme në mesin e nxënësve. Është konstatuar se në raportin midis viktimës-dhunuesit 58% e nxënësve nuk marrin pjesë. Me fjalë tjera, vetëm 58% e nxënësve nuk janë viktimë, as dhunues. Domethënë, pak më pak se gjysma e nxënësve, saktësisht 42% gjenden në “rrethin e dhunës”, qoftë si viktimë qoftë si dhunues. Në rolin e viktimës nga dhuna është një numër i madh i nxënësve, madje 37%.

Disa viktimë njëkohësisht janë edhe dhunues. Në grupin e anketuar janë 8% nxënës të tillë. Në këtë grup, format më të shpeshta të sjelljes së dhunshme janë të ofenduarit dhe të përqeshurit. Pra, këta nxënës sulmojnë me fjalë.

## Autori 2

Numri më i madh i nxënësve ka deklaruar se gjatë shkollimit të vet, gjatë kohës së mësimit ose pas tij, kanë qenë të nënshtruar të përqeshurit, ofendimit, nofkave përbuzëse. Gjithashtu i theksojnë edhe pakënaqësitë tjera: të të ngacmuarit pa vend, përhapjen e gënjeshtreve për ta, ndikimin të shokët tjerë që të mos shoqërohen me ta.

Edhe arsimtarët edhe të punësuarit e tjerë në shkollë konfirmojë se ofendimi dhe goditja fizike janë formë e përditshme e sjelljes së dhunshme në shkollë. Vetëm regjistrimi i problemit nuk domethënë se kemi arsye të ndihemi mirë. Përkundrazi, këto forma të dhunës lehtë mbulohen, kuptohen lehtë, “më lehtë” përballohen dhe “shërohen”, edhe pse mund të jenë mjaft të rënda dhe me pasoja mjaft të ndërlikuara.

Rretho shkronjën para pohimit/gjykimit të saktë.

Të dy autorët vetëm i kanë paraqitur të dhënat, pa pasur qëndrim për problemin të cilin e anketojnë.

- a) Autori 1 është i brengosur më shumë se sa autori 2.
- b) Autori 2 është i brengosur më shumë se sa autori 1.
- c) Të dy autorët njësoj janë të brengosur për shkak të dhunës në shkolla.

**152.** Lexo me kujdes paragrafët e dhënë dhe shkruaj në vija radhitjen e tyre, duke shkruar para secilit numrin 1,2,3,5,6 dhe 7.

\_\_\_\_\_Jam martuar herët, dhe sa mirë që njoha tek ime shoqe një gatishmëri të ngjashme me timen. Ajo e vuri re shpejt dobësinë time për kafshët shtëpiake, dhe nuk la rast t'i ikte për të kërkuar ato më të lezetshmet. Kishim zogj, peshk të kuq, një qen të zgjuar, lepuj, një majmun të vogël, dhe një mace.

\_\_\_\_\_Më vonë, macja jonë u rrit, u bë një kafshë e madhe dhe e bukur; e gjitha e zezë, dhe me një nuhatje mahnitëse. Kur fliste për inteligjencën e saj, gruaja ime, e cila ishte edhe disi supersticioze, kujtonte një pikëpamje të lashtë popullore, sipas së cilës, të gjitha macet e zeza ishin, thjesht, shtriga të maskuara. Jo se ajo e kishte fort seriozisht këtë ide... E përmenda, pa ndonjë arsye të veçantë, po ja që më erdhi ndërmend tani...

\_\_\_\_\_Si fëmijë kam qenë një natyrë e bindur dhe e brishtë. Kaq shumë binte në sy butësia e zemrës sime, sa që shokët më vinin në lojë. Isha i dhënë, veçanërisht, pas kafshëve, prandaj dhe prindërit ma bënë qejfin e më llastuan me shumë kafshë shtëpiake. Me to kaloja shumicën e kohës, dhe ndihesha aq i lumtur kur i ushqoja dhe i përkëdhelja! Unë rritesha, rritej edhe kjo veçanti e karakterit tim, dhe prej saj mora një nga burimet e mia kryesore të kënaqësisë. Për ju, që e keni provuar dhimbsurinë ndaj qenit besnik, nuk e kam hiç të vështirë t'ua shpjegojë llojin apo thellësinë e asaj kënaqësie të rrallë. Ajo dashuri bujare dhe vetëflijuese, që të godet mu në zemër, ve në provë edhe miqësinë e besnikërinë e njeriut.

\_\_\_\_\_Pluto, kështu quhej macja, ishte kafsha ime e preferuar dhe e kisha shok loje. E ushqoja vetë, dhe ajo më shoqëronte kudo nëpër shtëpi. Mezi e ndaloja të më vinte pas kur dilja në rrugë.

\_\_\_\_\_Në këtë mënyrë, miqësia jonë zgjati për shumë vite, gjatë të cilëve, temperamentit dhe karakterit im (më vjen turp ta rrëfej) pësoi një ndryshim rrënjësor për keq. Ditëpasdite, humori im ndryshonte. Me hënë, siç i thonë. U bëra gjaknxehtë, kisha më pak kujdes ndaj ndjenjave të tjerëve. Për një kohë të gjatë përdorja një gjuhë të papërmbajtur; madje, përdorja edhe dhunë. Sigurisht, kafshëve të mia iu desh të duronin ndryshimin e karakterit tim. Jo vetëm që i lashë pasdore, por u tregova edhe i ashpër ndaj tyre.

\_\_\_\_\_Një mbrëmje, kur po kthehesha në shtëpi nga një lokal i qytezës, xurxull fare, vërejta që macja më shmangej. E mbërtheva fort. Nga frika se mos e dhunoja, më kafshoi me dhëmbë dorën. Në çast, më pushtoi një tërbim djalli. Nuk e njoha më veten. Shpirti, dukej se më kishte dalë nga trupi, dhe diç më e fortë se ligësia mizore, e ushqyer edhe nga xhini që kisha pirë, më pushtoi çdo qelizë. Mora nga xhepi i jelekut një biçak, e hapa, rroka nga fyti kafshën e gjorë, dhe me ngadalë, ia nxora njërin sy nga zgavra! Po më vjen turp, digjem, ngjethem, teksa përshkruaj këtë egërsi të neveritshme.

\_\_\_\_\_Megjithatë, për Pluton kisha goxha merak se mos e keqtrajtoja. Ndërkohë, u tregova i paskrupullt edhe ndaj lepujve, majmunit, por, edhe ndaj qenit, kur ndonjëri më dilte përpara padashje, ose më përkëdhelte. Por, me kalimin e kohës, sëmundja m'u shtua- sëmundje si alkooli! Edhe Pluto, e cila kishte nisur të mplakej, ishte bërë ca grindavece. Kishte filluar t'i ndiente edhe ajo efektet e gjendjes sime të keqe shpirtërore.

**MACJA E ZEZË, tregim nga EDGAR ALLAN POE**

**153.** Lexo tekstet e mëposhtme. Për secilin tekst cakto me cilin stil është shkruar (administrativ, shkencor, letrar, publicistik).

1.

Gazrat e fisnikëruara më herët janë quajtur gazra inerte sepse është besuar se validiteti i tyre është zero dhe që nuk ndërtojnë bashkime organike. Heliumi është gaz inert kimik pa ngjyrë, pa shije dhe pa aromë, tretet dobët në ujë. Astronomi francez Pjer Zhansen e ka zbuluar në vitin 1868, me rastin e errësimit të plotë të Diellit, elementin e ri kimik në Diell, kurse kimisti anglez Eduard Frankland dhe astronomi Xhozef Norman Lokjer e kanë quajtur helium sipas fjalës greke helios, e cila domethënë Diell.

Stili: \_\_\_\_\_

2.

Përzierja e heliumit dhe e hidrogjenit quhet „ajër heliumi”. Heliumi është element me pikë më të ulët të shkrirjes. Edhe gazrat e tjera fisnikëruese i kanë pikat mjaft të ulëta të shkrirjes dhe të vlimit në krahasim me masën atomike.

Stili: \_\_\_\_\_

3.

Një nga aplikimet më interesante të heliumit ka të bëjë me mbushjen e balonave ajrorë. Deri në Luftën e Dytë Botërore balonat e mbushur me helium janë përdorur edhe për qëllime ushtarake – për mbikëqyrjen e terrenit. Sot tërë ekipet e shkencëtarëve marrin pjesë për konstruktimin e balonave gjithnjë e më të mirë, për pilotim me balon është mjaft modern sporti. Zvicerani Bertran Pikar dhe britaniku Brajan Xhons me balonë kanë fluturuar mbi tërë Globin Tokësor, pa ulje, dhe pas 19 ditësh janë lëshuar në një shkretëtirë të Egjiptit.

Stili: \_\_\_\_\_

**154.** Shikoje faqen e parë të romanit dhe në vizë shkruaj të dhënat bibliografike:

Të dhënat bibliografike: \_\_\_\_\_

**155.** Lexo me vëmendje këto përkufizime:

- a) Që gjykon drejt dhe nuk nisat nga interesat, nga ndjenjat ose nga qëllimet vetjake, që nuk ndikohet nga ndonjë paramendim; i paanshëm.
- b) Sendi a pika ku drejtohet syri i njeriut a një aparat optik për ta parë ose për ta fotografuar.
- c) Veprimtari e gjerë që zhvillohet me anë të shtypit, të radios, të fjalimeve etj. për të përhapur dhe për të ngulitur në masat një doktrinë a një ide të caktuar, dije të caktuara etj., për t'i bindur dhe për t'i mobilizuar ato për diçka etj.

Rretho shkronjën e cila e përkufizon objektivitetin e dikujt. Psh.

## 156. Të nderuar

Ju njohtojmë se është duke u përgatitur libri për grafitet në rrugë.

Nëse keni dëshirë të bashkëpunoni në këtë projekt interesant, ju ftojmë që me punën tuaj të angazhoheni në ekipin e ekspertëve të cilët po përpiqen të hulumtojnë këtë lloj të shprehjes artistike.

Mbledhja e ekspertëve të interesuar bashkë me udhëheqës të këtij projekti do të mbahet të martën më 22 shtator të vitit 2014, në orën 17.

Rretho shkronjën para pohimit i cili ka të bëjë me këtë tekst:

1.

- a) Teksti është shkruar në pajtim me drejtshkrimin, gramatikën dhe normën e gjuhës standarde
- b) Teksti është objektiv
- c) Në tekst ka shprehje terminologjike
- e) Teksti është i qartë, i shkurtër dhe korrekt
- f) Teksti është i shkurtër dhe i ndjeshëm.

2. Në bazë të pohimeve ky tekst i takon stilit \_\_\_\_\_

## 157. Lexo me kujdes këtë shkrim:

- a) Psh., kur Noli thotë: ...në Turqi kishte pashallarë vetëm me katëra tuje... ky është një fakt real, i vërtetë dhe ne nuk kemi të drejtë të shtrembërojmë atë.  
Ose p.sh., te vargu natyra e qeshur, ne nuk kemi të drejtë që këtë figurë letrare ta quajmë krahasim, pasi në këtë mënyrë gabojmë, ( e qeshur është epitet).  
\_\_\_\_\_

- b) Por nga ana tjetër, në shkrimin komentues ne sjellim dhe këndvështrimin tonë, i cili është i ndryshëm nga i tjetrit.  
Psh., kur Noli thotë: ...Kështu ne nuk e shpikëm patriotizmin shqiptar, e gjetëm. E vetmja gjë që bëmë është që...” Ky është këndvështrimi i Nolit ndaj mesazhit të kësaj poezie popullore.  
\_\_\_\_\_

Rretho dhe shkruaj përgjigjen e saktë në vizat e poshtëshënuara dhe përkufizo vlerësimin subjektiv dhe objektiv.

**158.** Lexo me kujdes këtë tekst dhe cakto qëndrimin e autorit të tekstit.

#### DHUNA NË SHKOLLA

Para pak kohe në 40 shkolla është bërë anketimi i cili ka të bëjë me dhunën e cila është e pranishme në mesin e nxënësve. Është konstatuar se në raportin midis viktimës – dhunuesit nuk marrin pjesë vetëm 58% të nxënësve. Me fjalë tjera, vetëm 58% e nxënësve nuk janë viktimë, as dhunues. Domethënë, pak më pak se gjysma e nxënësve, saktësisht 42% gjenden në “rrethin e dhunës”, qoftë si viktimë qoftë si dhunues. Në rolin e viktimës nga dhuna gjendet një numër tepër i madh i nxënësve, madje 37%.

Disa viktimë njëkohësisht janë edhe dhunues. Në grupin e anketuar janë 8% nxënës të tillë. Në këtë grup, format më të shpeshta të sjelljes së dhunshme janë të ofenduarit dhe të përqeshurit. Pra, këta nxënës sulmojnë me fjalë duke mos qenë të vetëdijshëm se me fjalë mund të shkaktojnë aq dhembje sa edhe me goditje, madje edhe më shumë. Sjellja e dhunshme e nxënësve nga ky grup i të të rriturve zakonisht quhet çapkenëri, gjallshmëri e tepruar e të ngjashme, duke e zvogëluar në këtë mënyrë seriozitetin e aktit të dhunshëm të cilin këta fëmijë janë në gjendje ta bëjnë.

Çfarë është raporti i autorit të këtij teksti sipas sjelljes së dhunshme të të rinjëve?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) Është indiferent ndaj dhunës së të rinjëve.
- b) I interesojnë të dhënat e mëtejme.
- c) Është i brengosur.
- d) Është i zemëruar për shkak të dhunës së të rinjëve.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**159.** Një dre, i sflitur nga etja, u afrua pranë një burimi; ndërsa pinte, imazhi i tij u shfaq në ujë e ai u ngazëllye duke parë se brirët e tij ishin kaq shumë të mëdhenj e të degëzuar. Por, i erdhi keq për këmbët e tij, të cilat ishin të dobëta e hollake. Dreri filloi të mburrte brirët dhe të shante këmbët e tij.

Ishte ende duke parë reflektimin e tij, kur ia behu një luan, i cili nisi të ndiqte. Dreri vraponte aq shpejt në fushën e gjerë, sa e la prapa luanin. Por kur filloi zona e pyllit, për shkak të brirëve, dreri ngeci mes degëve. Luani e arriti shumë shpejt dhe e mbërtheu.

Ndërsa luani po i ngulte dhëmbët, dreri bërtiti: - Oh sa budalla u tregova që shava këmbët dhe lavdërova brirët. Te ato që pata besim u bënë rrënimi im.

Shpesh na ndodh në jetë, që kur gjendemi në rrezik, bëhen shpëtuesit tanë ata që i kemi parë me dyshim, ndërsa ata që u kemi falur besimin, na kanë dalë tradhtarë.

a) Çfarë veçorie ka teksti rrëfimtar?

---

b) Çfarë qëllimi kanë tekstet letrare?

---

c) Pse i përdorim tekstet letrare dhe joletrare:

---



**160.** Llojet e tekstit tregimtar janë:

- a) Miti
- b) Legjenda
- c) Përralla
- d) Fabula
- e) Fjalët e urta
- f) Tregimi
- g) Novel
- h) Romani.

Rretho përgjigjen e cila shpreh një fjali të shkurtër e cila shpreh një mendim të mençur (që përmbledh një përvojë të madhe jetësore)?

## Të shprehurit me shkrim

**161.** Shkruaj një raport për koncertin i cili është organizuar lidhur me mbarimin e vitit shkollor. Raporti duhet të përmbajë: informatat e domosdoshme për ngjarjen, përshkrimin e ecurisë së koncertit dhe përfundimin.

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

**162.** Ju keni marrë pjesë në një konkurs për matematikë. Shkruaj me disa fjali një lajm për revistën e shkollës . Ki kujdes për të dhënat të cilat duhet t'i ketë lajmi.

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

**163.** Nëse veçoria e theksuar është tipike për gjuhën e folur, në vijën pranë saj shkruaj, **e folur**, e nëse është tipike për gjuhën **e shkruar**:

1. Fjalitë janë më të gjata dhe të më të ndërlikuara. \_\_\_\_\_
2. Fjalitë plotësohen me gjeste dhe mimikë. \_\_\_\_\_
3. Fjalitë janë të pambaruara dhe jo të plota. \_\_\_\_\_

**164.** Krahasoni këto dy tekste:

a) tash ngjante si t'ish lule tue luejt foshnjisht me përfytyrimin e saj në pasqyrën e një uji të kullute; mandej dukej të këputte rrembtha të lulzuem te u ngitë maje gishtave të vegël. Herë ngitte nëpër shtroje si të ndiqte ndonjë flutur ari, here valëvitej sit a përkundte jehu i një jonës së largët që ngjallë malle të parpitura.

(sipas Ernest Koliqit)

b) Rroftë jeta!” Ashtu më dukej sikur përsërisnin ditë e natë, e sidomos natën, kur oshëtima e tyre ishte më e fuqishme, dallgët e detit Jon, që përplaseshin në bregun shkëmbor të fshatit tim Dhrimadhe. Këtë refren të përhershëm të dallgëve të detit Jon më dukej sikur e shprehnin pa zë edhe fshatarët e mi, se lufta që bënin, atë moto kishte: “Rroftë jeta!” Jeta mbi gurë, jeta në dallgët e detit, jeta kur ishte zor të jetoje, zor të dashuroje, zor të ëndërroje e zor të vdisje.

(Sipas Petro Markos)

1) Ku është dallimi midis këtyre dy teksteve?

2) Me cilën formë të gjuhës është shkruar teksti i parë dhe me cilën teksti i dytë?

---

---

**165.** Lexoni këto dy poezi të ndryshme dhe krahasoni ato nga pikëpamjet gjuhësore:

1) Fliste. Flitnin. I dëgjonte.

Isa me sy plot mall  
Maste largësitë e dheut.

Me gishta të trashë  
Shkruante hartën e re  
Në dheun e kuq të udhës,  
Isa me sy të përmalluar  
Maste largësitë e atdheut.

(Sipas Sabri Hamitit)

2) Deshta, shumë kam dasht-dëshirue

që me kang të trimnoj,me fjalën tande të  
ndridhun

Të ngrej fuqit prej gjumit...

Këndova (dhe kur m'ishte ndalue)  
se edhe për ty, të përbuzun,do të vinte  
lirija

(Sipas Esad Mekulit)

1. Çfarë është dallimi midis këtyre dy teksteve?

---

---

2. Me çfarë forme të gjuhës është shkruar teksti i parë dhe me çfarë teksti i dytë?

---

---

**166.** Ku është dallimi midis gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar?

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

c) \_\_\_\_\_

**167.** Rretho përgjigjen e cila është shkruar sipas rregullave të drejtshkrimit:

a) Në dimën shiste gështeja të pjekme.

b) E shihja çdo mëngjes, kur shkoja në shkollë.

c) Të ftohtit ka ra.

ç) Marimanga vajti musafire ke brumbulli.

**168.** Shkruaj këtë fjali me shkronja të dorës dhe sipas normës letrare:

Do të shkojm në teatër për ta shiku dramën toka jon të kolë jakovës.

\_\_\_\_\_

**169.** Nëse shkurtesa është e shkruar si duhet në vizën pranë saj shëno S, e nëse nuk është shkruar saktë shkruaj G.

sh (shumës) \_\_\_\_\_

proof (profesor) \_\_\_\_\_

Prof.Dr.(profesor doktor) \_\_\_\_\_

Gjeol. (gjeologji) \_\_\_\_\_

**170.** Fjalët e mëposhtme që janë shkruar në gjuhën e folur, shkruani sipas rregullave të gjuhës letrare.

ámël \_\_\_\_\_; baj \_\_\_\_\_; dam \_\_\_\_\_

vlla \_\_\_\_\_; kângë \_\_\_\_\_; druni \_\_\_\_\_.

## Gramatika, leksiku, gjuha popullore dhe letrare

**171.** Nënvizto fjalët në të cilat teksti bie në rrokjen e fundit

- a) Librari
- b) Dora
- c) Djalë
- d) Lumturi

Rretho shkronjën para përgjigjeve të sakta

**172.** Foljet janë në formën veprare kur veprimi:

- a) Mbetet mbi kryefjalën
- b) Kalon te kryefjala
- c) Kryhet nga kryefjala
- d) Kalon te rrethanori i vendit

**173.** Shiko shembujt e mëposhtëm dhe vendos theksin mbi këto fjalë:

- Njeri – njerëz
- Lumë – lumenj
- Gjarpër – gjarpër
- Gish – gishtërinj

**174.** Cila karakteristikë nuk i përket foljes?

- a). Ndryshon sipas kohës
- b) Tregon cilësinë e frymorëve
- c) Ndryshon sipas vetës
- d) Është bërthamë e fjalisë tip.

Rretho shkronjën para përgjigjës së saktë

**175.** Bashkëtingëlloret b, f, m, p, v janë:

- a) buzore,
- b) grykore,
- c) dhëmbore,
- d) hundore,

**176.** Në ç'shikallë janë mbiemrat në fjalinë: “Kjo këngë u bë **më e përhapura** dhe **më e kënduara** nga të gjitha”.

- a) Shkalla sipërore
- b) Shkalla krahasore e barazisë
- c) Shkalla krahasore e përgjithësuar
- d. Shkalla krahasore e ultësisë

**177.** Bashkëtingëlloret t,d,th,dh,ll janë?

- a) hundore
- b) shtegore
- c) dhëmbore

**178.** Klasat fjalëve

Radhit pjesët e ndryshueshme të ligjëratës dhe trego se çfarë tregojnë ato:

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_
- 5) \_\_\_\_\_

**179.** Ç'të përbashkët kanë foljet: kam ngrënë, mbylla, kapa, pata, thënë, afrohem?

- a) Janë në formën joveprore
- b) janë në vetën e parë
- c) janë në kohën e kryer të thjeshtë
- d) janë në mënyrën lidhore

**180.** Sipas mënyrës së ndërtimit ndajfoljet e dhëna janë:

Fluturimthi, dorazi, trimërisht

- a) të thjeshta
- b) të prejardhura
- c) të përngjitura
- d) shprehje ndajfoljore

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**181.** Shiko formimin e këtyre fjalëve dhe trego si janë ndërtuar ato :

Përditë

Mospëlqim

Mospranim

Pabesi

a) Parashtesa + rrënja

b) Prapashtesa + rrënja

c) Prapashtesa + parashtesa

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**182.** Bashkatdhetar, lulekuqe, këmbëzbathur

a) të prejardhura

b) të thjeshta

c) të përbëra

d) të përngjitura

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

**183.** a. Vërtet po vdes/, por mos mbani zi.

b. Nga gjumi më zgjoi një krismë/ dhe një krismë po më vë në gjumë.

Çfarë fjalish janë këto?

---

---

---

**184.** Kur gjendej vetëm te mulliri, ia thoshte ndonjë kënge të vjetër.

Fjala e varur e nënvizuar është fjali:

a) qëllimore,

b) shkakore,

c) kohore,

ç) kushtore.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**185.** Vini trajtat e shkurtra në fund ose në trup të foljeve në mënyrën urdhërore:

1. Hap..... dritaret e dhomës!

2. Pyet .....shokun për orarin e trenit.

3. Ndihmo .....nënë!

4. Ha..... mollët, se janë të mira!

5. Vish..... pallton se është ftohtë!

6. Thuaj.....shokëve të më presin në hotel!

**186.** Fjalia e varur e nënvizuar është fjali:

Erdha në shkollë për të mësuar dhe për të nxënë dituri.

- a) qëllimore,
- b) shkakore,
- c) kohore,
- ç) kushtore.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**187.** Në vend të pikave vini trajtat e shkurtra të përemrave vetorë dhe emrat në kllapa i vini në rasën e duhur:

Inxhinieri .....u afrua (turma e vullnetarëve).

.....u thye gota, se.....ra nga dora.

..... pashë kur .....u afruan nxënësit dhe ..... uruan për (festa).

Shfaqja që pamë .....u duk e mirë.

(Genci) .....u shërua dora që kishte vrarë.

Ai po përgatitej për të .....u përgjigjur (pyetjeve të shokut).

**188.** Togfjalëshi është:

Njësi sintaksore që merr pjesë në ndërtimin e fjalisë dhe që përbëhet, nga dy a më shumë fjale kuptimplota, të cilat kanë lidhje të ngushta gramatikore e kuptimore me njëra tjetrën :  
*detyra të mëdha, bukë gruri, dy nxënës, mot me diell, shumë ditë etj.*

Çfarë lloj togfjalëshash ekzistojnë?

---

---

---

---

**189.** Rretho përgjigjet e sakta.

Veçori të testeve të stilit gazetaresk:

- a) objektiviteti
- b) përmbledhshmëria
- c) përdorimi i të gjitha mjeteve gjuhësore
- d) saktësia
- e) subjektiviteti
- f) logjikshmëria



- 190.** 1. Mos e bëj qimen tra.  
2. Mos e bëj mizën buall.  
3. Ditën punonte, natën studionte.

Shkruaj në cilën rasë janë përdorur emrat e fjalive të mësipërme të nënvizuara:

- a) emërore
- b) dhanore
- c) kallëzore
- d) rrjedhore

**191.** Kur duam të theksojmë kryefjalën, e vendosim:

- a) Në krye të fjalisë
- b) Pas foljes
- c) Në fund të fjalisë
- d. Në mes të fjalisë.

**192.** Shkruaj në numrin shumës emrat e mëposhtëm:

Popull	pellg	turk
Rrezik	akull	tog
Natë	peshk	ishull

**193.** Trego në cilën rasë është përdorur përemri në fjalinë e dhënë?

Cilin shok e takove sot?

\_\_\_\_\_

**194.** Për të qenë \_\_\_\_\_

Duke qenë \_\_\_\_\_

Qenë \_\_\_\_\_

Përballë formave të foljeve, trego cilave mënyra u përkasin ato?

**195.** *a/e bërtas > bërtet, cjak > cjep,*

*o/e: shoh > sheh, njoh > njeh*

*e/a: thes > thasë, rreth > rrathë,*

*e/i: dredh > dridhni, fshëh > fshihni, flet > flisni,*

*ë/i: lë > lini, zë > zini,*

Si quhet kjo dukuri e ndërrimeve fonetike të zanoreve në një fjalë:

**196.** Çfarë lloj foljesh janë “jam” dhe “kam”:

- a) folje këpujore
- b) folje ndihmëse

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**197.** Nënvizu foljet joveprore në mënyrën habitore dhe ato në mënyrën dëshirore.

Në ç’kohë, vetë e numër janë?

Ai qenkësh mësuar me këtë lloj jete.

U habita: ata u stërvitkëshin gjatë gjithë ditës.

Plaku nuk pushonte së uruari: “U gëzofshi e u trashëgofshi!”

I gjithë qyteti duket sikur qenka shkretuar.

E si u vendoskan kaq shpejt këto gjëra?

- Qofshi rregulluar dhe ju deri në atë kohë!

---

---

---

---

---

**198.** Vendos në kohën e kërkuar foljen në kllapa:

Fshati ku (*jetoj*, e pakryera) \_ djali i (*kam*, e pakryera) \_\_\_ shtëpitë e shpërndara.

Nënvizu foljen në të pakryerën.

**199.** Shkruaj çfarë kuptimi ka fjalia:

1. Kur autori thotë: “Edhe kur kryet do të na i mbulojnë thinjat...” mendon për:

- a) Flokët e thinjura
- b) Rininë
- c) Pleqërinë.

---

**200.** a) Çfarë figure është metonimia dhe si ndërtohet?

... mbi kokë i rrijnë pranë e pranë  
Naimi dhe Migjeni,  
Nga dora kurrë s'ju ka lanë,  
N' zemër të tij ju jeni.

b) Për kë e ka fjalën autori në këto vargje?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**201.** Me metonimi shprehen marrëdhëniet e shumta logjike, të cilat varen njëra prej tjetrës.

a). *Vera* na i thau bimët (thatësia e shkaktuar nga vapa e madhe e verës)

Vesa shkëlqeu nga *dielli* (rrezet e diellit)

b) Katundin e mbuloi *tymi* (prej zjarrit që i mori shtëpia)

Ushqehem me *djersën e ballit* (me punën që kryej)

Cila marrëdhënie është shprehur në fjalinë e parë e cila në të dytën:

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

**202.** Lidhni me shigjetë frazeologjizmat sipas kuptimit:

- |                        |                  |
|------------------------|------------------|
| a) Më bëhet zemra mal. | e ndihmon        |
| b) U bënë pikë e pesë  | e sjell vërdallë |
| c) Ia zgjat dorën      | u shpërndan      |
| d) E heq për hundë.    | gëzohem          |

**203.** Lexo me kujdes fjalinë:

*Fëmijtë vështruan me kujdes babanë e tyre me buzë të varura.*

1) Sa grupe të varura fjalish dallojmë në këtë fjali?

---

2) Kjo fjali nga cilat pjesë të ligjëratës është përbërë?

---

3) Çfarë kuptimi kanë njësitë frazeologjike:

- pa parë dritë me sy
- u bëra kockë e lëkurë

---

---

---

**204.**

1) Tërësia e togjeve dhe e thënieve a e shprehjeve të qëndrueshme të një gjuhe, të cilat janë të pandashme nga ana leksikore, kanë kuptim tërësor, të njësishtëm, të mëvetësishëm e gjithnjë të figurshëm, riprodhohen në ligjërim si njësi të gatshme dhe kryejnë funksionin e një fjale a të një fjalie të vetme.

2) Tërësia e fjalëve që përdoren në një fushë të caktuar të veprimtarisë shoqërore ose nga një rreth shoqëror i caktuar; tërësia e fjalëve që përdor një autor në veprën e tij, fjalori i një vepre.

3) Degë e gjuhësisë që studion prejardhjen e fjalëve të një gjuhe, duke u mbështetur në historinë e saj e në lidhjet me gjuhët e tjera.

Rretho përgjigjen që ka të bëjë me frazeologjinë.

**205.** Cili është kuptimi i shprehjeve frazeologjike të dhëna:

Rreh gjoks \_\_\_\_\_

E vuri gishtin në kokë \_\_\_\_\_

Nuk ma mban \_\_\_\_\_

I mbanin lotët \_\_\_\_\_

Shkruaj përgjigjet në vijat e mësipërme.

**206.** Lexo me kujdes fjalinë e mëposhtme dhe zgjidhe detyrën:

Në fund të shkurtit dhe në fillim të marsit, kohë e pazakonshme për këtë stinë të vitit, në Vlorë përnjëherë ka ndërruar moti, ka filluar të fryjë një puhë pranverore dhe drunjtë janë mbushur me gjelbërim.

Fjalët e nënvizuara kanë të bëjnë me:

- a) Erën e ftohtë të pranverës;
- b) Erën e nxehtë të vjeshtës;
- c) Erën e lehtë freskuese;
- d) Erën e dimrit mesatarisht të fortë.

**207.** Tekstin e paraqitur lexojeni me kujdes dhe tregoni domethënien kuptimore të fjalisë së nënvizuar se në ç'kontekst janë përdorur:

Ne dikur ishim tok more mik, por tani, tani jemi bërë pikë e pesë, as nuk duam të shikohemi mes vete e lëre më të flasim. Jemi bërë për të na qarë hallin.

Fjalja ka kuptimin e:

- a) Ndarjes së njërit me tjetrin
- b) Bashkimit mes veti
- c) Afrimit nga pikëpamje vllazërore
- d) Ndarjes nga jeta

Nënvizo shkronjën përpara përgjigjes së saktë.

**208.** Lexo fjalët e mëposhtme dhe shpjego kuptimin e tyre:

a) ëndrra në diell \_\_\_\_\_

b) si kalë pa fre \_\_\_\_\_

c) stan me lepuj \_\_\_\_\_

d) petulla me ujë \_\_\_\_\_

Në vija shkruaj përgjigjen e saktë.

## Letërsia

### 209. “Çeta e Profetënvet”

*/Fragment nga Vepra/*

Mbas-i të jetë shekulli gjithë djegunë me zjarm, ka me u kulluem dheu me gjithë të tjerë elementa mba-të mendyrë posi janë kjanë kur u krijuenë prej Sinëzot. Qielltë kanë me pushuem e nukë kan me u siellë kështu. Ashtu ende djelli, e hana, e yjetë kanë me pushuem i-sillido mbë vend të vet, e kanë me pasunë një shkëlqim ma të madh se i kanë sod. Ashtu ende gjithë elementatë, qi janë dheu, ajri, zjëtë e zjarmi kanë me u bamë ma të kulluem se janë, e nukë kanë me pasunë ma ato ndërrime posi mpari; nukë ka me lem ma njerii mbë shekullit, as peshk ndër deet, as zog nd-ajri, as baar, as gjeth ma ka me u rritunë përmbii dheet. Nukë kanë me kjanë ma vjettë, muejtë, dittë, as natë, po gthëherë dritë. Nuk ka me kjanë ma borë, akullë, shii, breshënë as baltë, as të ftofëtë, as të nxetë, po një aq e pushim të gjithë kafshëvet.

Pjetër Bogdani

Lexo fragmentin e dhënë dhe trego: Cilës periudhë të Letërsisë i takon kjo vepër?

- a) Rilindjes kombëtare;
- b) Letërsisë së vjetër;
- c) Letërsisë moderne;
- d) Letërsisë së sotme.

### 210. Në cilin vit është botuar “Meshari”?

- a) 1462
- b) 1504
- c) 1555
- ç) 1685

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

### 211. Përballë titullit të çdo vepre letrare (në katrorë), shkruaj numrin përkatës, i cili gjendet para emrit dhe mbiemrit të shkrimtarit që e ka shkruar veprën:

/ / “Kronikë në gurë”

1. Lasgush Poradeci

/ / “Gjahu i malësorëve”

2. Migjeni

/ / “Kroi i fshatit tonë”

3. Sabri Hamiti

4. Ismail Kadare

5. Çajupi

6. Konstantin Kristoforidhi

**212.** Ndër baladat më të njohura të poezisë popullore legjendare janë ato të murosjes së gruas:

Si quhet kjo?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

- a) Aga Ymeri
- b) Luto Fukaraja
- c) Kënga e Rozafatit

**213.** Numrat para emrit të personazheve shkruaj në vijat përballë titullit të veprës përkatëse. Kujdes, një personazh është më tepër.

- |                |                           |
|----------------|---------------------------|
| 1. Tana        | “Nita _____”              |
| 2. Asim Vokshi | “Këngët e Milosaos” _____ |
| 3. Zefi        | “Hasta la Vista” _____    |
| 4. Vangjeli    |                           |
| 5. Hajrija     | “14 vjeç dhëndër” _____   |
| 6. Nita        |                           |
| 7. Milosao     |                           |
| 8. Xhemal Kada |                           |
| 9. Rina        |                           |

**214.** Përballë titullit të çdo vepre letrare (në katrorë), shkruaj numrin përkatës, i cili gjendet para emrit dhe mbiemrit të shkrimtarit që e ka shkruar veprën.

- |                               |                  |
|-------------------------------|------------------|
| /___/ “Rrethimi” -            | 1.Qamil Batalli  |
|                               | 2.Vedat Kokona   |
| /___/ “Malësorja”             | 3.Tajar Hatipi   |
|                               | 4.Nazmi Rrahmani |
| /___/ “Aventurat e Cipolinos” | 5.Xhani Radari   |
|                               | 6.Esad Mekuli    |

**215.** Provinca i ka të mirat dhe të këqijat e veta. E mira e jetës në provincë e që të mban gjallë gjithnjë është se nuk kalon ditë pa ndodh ndonjë ngjarje. E ato rriten e rriten dhe zbukurohen gjatë rrëfimit. Ngjarjet vetvetiu fitojnë gjallëri dhe mbeten jetëgjata. Ndërsa e keqja, nëse mund të merret si e keqe, është, se provinca që identifikohet me një qytezë dhe fshatrat përreth, gjendet larg qendrës dhe duket se lihet pak anash, injorohet.

Derisa bluaja nëpër kokë të mirat dhe të këqijat e provincës, bashkëbiseduesi im më zgjoi kureshtjen duke thënë:

- Lagjja e jevgjve nuk kishte ndryshuar edhe aq shumë! -tha Ramadani i Fazë Kuqit, me një të folur të mirë të shqipes standarde.

- I kujtoj mirë ato shtëpi të vogla, çatitë e të cilave ishin të mbuluara me qeramidhe të maxhupit. -vazhdoi ai, pa pritur përgjigjen a vlerësimin tim. Kurse unë, ashtu i hutuar, ende nuk isha kthjell nga ato mendime që ma kishin pushtuar trurin, vetëm bëra me kokë në shenjë pohimi.

Njëmend ishin ende po ato shtëpi të ulëta, përdhese, me dritare të vogla të kthyer kah rruga e të cilat ishin të mbrojtura me cilindra të hollë hekuri. Gati tërë kohën, dritaret e shtëpive të jevgjve ishin të hapura dhe nga to dilte një erë kundërmuese. Dhomat e atyre shtëpive nuk ishin të dekoruara. Aty mund të shihej ndonjë vitrinë e vjetër, ku zakonisht i vendosnin gotat e çajit, disa filxhanë dhe ndonjë figurë tjetër. Nuk ishin të shtruara me dërrasa, por toka ishte mbuluar me një mushama e diku-diku ndonjë qilim i lirë.

- Pavarësisht nga kjo mënyrë e jetës së tyre, unë isha i motivuar nga jeta që bënin këta jevg, të cilët si duket, - tha ai duke më shikuar në sytë, -shumica më nuk ishin në mesin e të gjallëve. Pastaj, sevdalliu Zejna, ishte një ndër personazhet e mi. Dëgjova të ketë vdekur. E ka dashur jetën ai. -përkujtonte ditët e rinisë dhe qeshi.

Lexo fragmentin e dhënë dhe trego; titullin e veprës dhe emrin e autorit.

1. Gjininë letrare të veprës \_\_\_\_\_;
2. Titullin e veprës \_\_\_\_\_;
3. Emrin e autorit \_\_\_\_\_.

**216.** Hajria është personazh kryesor i veprës letrare?

- a). Kujtime të thinjura;
- b) Lumi i vdekur;
- c) Malësorja;
- d) Gavroshi.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.



**217.** Rikujto veçoritë e poemës, dhe në bazë të vargjeve cakto cili fragment i takon njërës poemë.

a)

Histori e Skënderbeut (pjesa e parë)  
Këndo, ëngjëll, urtësinë  
Edhe gjithë mirësitë,  
Skënderben' e trimërinë,  
Q'i dha Shqipërisë dritë.  
Të lumtë goja, këndona,  
Me gjuhë tëmbëlë si mjaltë,  
Skënderben' e madh tregona,  
Trimnë burrë, Zotn' e naltë.  
Punëtë që ka punuar  
Kordhëtari i vërtetë,  
Kombinë duke nderuar  
Dhe Shqipërinë përjetë.

b)

Gjuha jonë sa e mirë!  
Sa e ëmbël! Sa e gjerë!  
Sa e lehtë! Sa e lirë!  
Sa e bukur! Sa e vlerë!

Fragmenti me poemë është në shembullin\_\_\_\_\_.

**218.** Lexo me kujdes vargjet e mëposhtme:

“O, si nuk kam një grusht të fortë  
T' bij mu në zemër malit që s'bëzanë  
Ta dij dhe ai se Ç'domethënë i dobët,  
N'agoni të përdridhet si vigan i vramë”

Cila figurë është përdorur në këto vargje?

**219.** Ku është krijuar “Shoqata e të shtypurit të shkronjave shqip?

- a) Tiranë
- b) Stamboll
- c) Bukuresht
- d) Manastir

**220.** Që ditën që vdiqe, që kurrë s'të kam parë,

lotët që kam derdhur s'më janë dhe tharë,  
shumë vjet u bënë, sot u mbushën dhjetë,  
që kur më ke lënë dhe s'të shoh ndë jetë!

Çajupi "Vaje"

Lexo vargjet e mësipërme, të cilat janë shkëputur nga vjersha "Vaje" të poetit A.Z. Çajupi dhe trego cilit lloj të lirikës i takon kjo vepër. Rretho përgjigjen e saktë.

- a) Elegjisë;
- b) Poemës;
- c) Sonetit;
- d) Himnit.

**221.** Lexo këtë fragment:

Figura qendrore e letërsisë shqiptare të Rilindjes, ai që u bë shprehës i aspiratave të popullit për liri e përparim, si poet i madh i kombit, është Naim Frashëri, bilbili i gjuhës shqipe. Naimi lindi më 25 maj 1846 në Frashër, që ishte edhe një qendër bejtexhinjsh. Mësimet e para i mori tek hoxha i fshatit në arabisht e turqisht. Që i vogël nisi të vjershëronte. Studimet e mesme i kreu në Janinë, në gjimnazin e njohur "Zosimea". Aty horizonti i tij kulturor u zgjerua së tepërmi, njohu letërsinë, kulturën dhe filozofinë klasike greke e romake, ra në kontakt me idetë e Revolucionit Borgjez Francez dhe me iluminizmin francez. Duke përvetësuar disa gjuhë, si: greqishten e vjetër e të renë, latinishten, frëngjishten, italishten e persishten. Naimi, jo vetëm që mori bazat e botëkuptimit të vet, por njohu edhe poezinë e Evropës e të Lindjes. Të gjitha këto tradita poetike ndikuan në formimin e tij si poet. Më 1870, pas mbarimit të shkollës, shkoi për të punuar në Stamboll, por u prek nga turbekulozi dhe u kthye në Shqipëri në klimë më të shëndetshme.

Gjatë viteve 1872-1877 Naimi punoi në Berat e në Sarandë si nëpunës. Kjo periudhë pati rëndësi të veçantë në formimin e tij. Atdhetar e si poet. Ai njohu më mirë jetën e popullit, zakonet, virtytet dhe aspiratat e tij, gjuhën e bukur e shpirtin poetik të njerëzve të thjeshtë, krijimtarinë popullore, bukurinë e natyrës shqiptare.

Ky është fragment nga:

- a) Teksti shkencor
- b) Ditari
- c) Biografia
- d) Autobiografia

**222.** Lexo këto vargje dhe në vijën përkatëse nën vargjet e theksuara shkruaj figurën përkatëse stilistike e cila është përdorur në këto vargje të bukura të Asdrenit:

Dhe hije e murrme vjen me fletët hapur,  
me hovin e paprekur t'amëshimit,  
ndër thonjtë e saj shpirtin duke ma hapur,  
si bisha pa kurrfarë përdëllimi.

Nga vargu i fundit mund të shihet se poeti e ka përdorur: \_\_\_\_\_

**223.** Në vizën nën secilin fragment shkruani emërtimin e mënyrës përkatëse rrëfyese (monolog i brendshëm, dialog, rrëfim, përshkrim).

- E sheh ai po kujdeset! – pëshpërit ajo.

- E kam pasur parandjenjën atje në atë natë të tmerrshme se jam duke ia shpëtuar jetën njeriut më bujar në botë.

Mënyra e rrëfimit është \_\_\_\_\_ .

„Po i bëj vetes pyetje pse ka kërcyer“, mendonte plaku. „Sikur ka kërcyer për të më treguar sa është e madhe. Por unë këtë edhe ashtu e di“, mendonte.

Mënyra e rrëfimit është \_\_\_\_\_ .

Degët e zhveshura të drunjve nëpër të cilat kapeshin grimcat e vogla të brymës, tanimë gjithnjë e më shumë janë lakuar nën harkun e borës. Rrezet, retë... Çdo gjë është humbur nga bora që ka rënë...

Mënyra e rrëfimit është \_\_\_\_\_ .

Kam qenë i pasur. Kam pasur fat sepse e kam pasur shtëpinë pranë një lumi të madh. Kam pasur shokë dhe shoqe. Jemi rritur të lumtur.

Mënyra e rrëfimit është \_\_\_\_\_ .

## **224.** Shtëpia fluturuese

Zoti Pankraccio jetonte në një qytet të vogël të Italisë. Duke punuar gjatë kohës së lirë, ai ndërtoi një shtëpi për të kaluar pushimet, sipas një projekti të menduar që në fëmijëri. I kishte të gjitha kjo shtëpi: kuzhinën qilarin, dhomën e zotit Pankraccio e të zonjës Lucia, dhomëzën e Laurës dhe të Xhanetës... Vecantia e parë u pa ditën e parë të pushimeve kur zonja Lucia dhe fëmijët zunë vend te karriget e veta, ndërsa zoti Pankraccio u zhduk në një skutë të çuditshme prapa banjës dhe thirri:

- Gati ?

- Gati ! – iu përgjigjen zërat gazmorë të fëmijëve.

- Zoti Pankraccio ndezi motorin dhe shtëpia u ngrit fluturim si ndonjë pëllumb ose helikopter , duke lëshuar shtëllunga tymi. Fqinjët vrapuan në oborr me duar në kokë ...

- Roja e bashkësisë i fryu bilbilit;

- A keni patentë zoti Pankraccio?

- Çfarë patente, ju lutem?

- Desha të them dëshmi. Nuk lejohet të drejtoni aeroplanin pa dëshmi.

- Po ky nuk është aeroplan, është shtëpi. S'kam dëgjuar t'i kërkohet dëshmi babait për të drejtuar shtëpinë e vet .

Shtëpia fluturuese u zhduk prapa një reje të vogël. Në bard sundonte gëzimi, Zonjë Lucio që kishte ëndërruar nganjëherë të udhëtonte me aeroplan, dilte orë e çast nga kuzhina, ku po gatuate drekën dhe kërkonte nga i shoqi që t'i tregonte emrat e lumenjve e të maleve se i pëlqente shumë gjeografia. Laura dhe Xhanetoja zgjatimin nga ballkoni rrjetat e fluturave, më shumë për t'u zbavitur se sa me shpresë të zinin zogj; zogjtë, çështë e vërteta, rrinin shumë larg, përveç një trumcaku që kishte qëndruar mbi oxhak e shëtiste kështu falas duke fishkëllyer.

Xhani Rodari

**225.** Cilat figura stilistike janë përdorur në vargjet e mëposhtme:

Duaje atdheun si shqiponja folenë  
Puna vjen me këmbë të arta.  
S'tundet mali nga dëbora .  
Gënjeshtër i ka këmbët e shkurtra.  
Fjala e ligë, më e rëndë se plumbi.  
Qentë le të lehin, karvani shkon përpara.

---

---

---

---

Shkruaj në vija përgjigjet.

**226.** Kur erdhi radha, Gjergji e hodhi bukur topuzin e vet dhe e qëlloi Bajlozin në shteg të ballit. Ky u përkul e u gremis i vdekur. Kur u shemb për dhe u tund e tërë fusha! Kali mori arratinë. Gjergji nxori menjëherë shpatën e mprehtë dhe ia ndau kryet nga trunghi. Kryet ia vari në mollë të shalës, trunghun (trupin) ia hoqi zvarrë për këmbë, nëpër fushë, përmes ferrash e drizash dhe ia hodhi në një përrua. Gjaku i Bajlozit të zi rrodhi nëpër përrua, nxiu gjithë burimin. Tri vjet rresht vendi rreth e qark, kundërmoi ere të rëndë.

“Gjergj Elez Alia” - Mitrush Kuteli

Në pjesën e lartshënuar është përdorur figura stilistike:

- a) Personifikimi
- b) Metafora
- c) Hiperbola
- d) Gradacioni

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**227.** Para teje e ke fragmentin e një libri.

Në “Shtëpinë e kukullës”, pronar legjitim i kukullës, është një bashkëshort, një baba dhe një qytetar shembullor. Në shtëpinë e tij të vogël, me tre fëmijë dhe gruan, ne shohim strehën e ëmbël familjare, familjen e lumtur të ëndërruar. Zonja Helmer jeton e lumtur, e sigurt se i ka realizuar me të vërtetë të gjitha ëndërrat për të qenë bashkëshorte dhe nënë ideale, për të pasur një bashkëshort ideal, i cili, në rast nevojë, do të mundë të jepte edhe jetën për të shpëtuar nderin e saj.

Teksti i shkruar është:

- a) Përshkrim
- b) Shpjegim
- c) Analizë

**228.** Lidh me shigjetë figurat letrare me vargjet ku gjenden ato:

- |                                    |           |
|------------------------------------|-----------|
| 1. Që e përbuzë këtë gjuhë hyjnore | metaforë. |
| 2. Shuhet nata me ngadalë-         | krahasimi |
| 3. Vjen të merr por si pëllumbi    | epitet.   |

**229.**

#### Djali dhe deti

Kur u zgjua, dëgjoji zhurmën e dallgëve, po nuk u besoi veshëve. Iu duk sikur ishte në ëndërr. Në ëndrrat e tij deti e kishte bërë vazhdimisht atë zhurmë. Djali vështroi pishat. Pishat lëkundeshin. Qenka prishur me të vërtetë moti, tha ai dhe, si hëngri mëngjes, doli nga vila. Deti. Djali vrapoi drejt plazhit. Askush nuk lahej atë ditë. Kishte shumë dallgë. Ato ndiqnin njëra-tjetrën dhe treteshin në breg. Djali shkoi deri te trungu i kalbur dhe qëndroi aty. Vështronte dallgët dhe nuk e dinte përse ishte gëzuar aq shumë. Gëzimi po i fashitej ngadalë, gjersa e la fare. Djali e ndjeu veten të vetmuar e të braktisur. Kurse deti ishte aty pranë, si ditën e tretë të pushimeve, tërë dallgë. Djalin e pushtoi përsëri paniku i asaj dite. Hodhi sytë mos shihte në po lahej njeri apo jo atë mëngjes. Asnjëri. Era ngrinte rërën e plazhit të shkretë dhe e përplaste pas kabinave dhe drurëve. Pishat lëkundeshin si në një valle të vrullshme. Deti vinte deri te këmbët e djalit dhe aty fashitej, sikur tallej. Djali u zhvesh dhe hyri në ujë. Uji ishte i ngrohtë nga ditët me diell. Dallgët iu përplasën në gjoks dhe djali u zhyt. Notoi zhytas derisa nuk qëndronte dot dhe doli mbi ujë. Ktheu kokën nga bregu. Mbi trungun e kalbur zbardhnin këmisha dhe kanotiera e tij. Mendoi të kthehej, po ndërroi menjëherë mendje. Ai filloi të notonte duke çarë dallgët. “Do të notoj derisa të lodhem”, tha ai. Dhe nuk shikonte sa larg kishte ikur. Notonte lehtë, më lehtë se çdo herë tjetër. Djali dalloi se ajo që zbardhte mbi trungun e kalbur nuk ishte pulëbardhë, por ishin kanotiera dhe këmisha e tij. Edhe pak, tha. Edhe shumë pak më ka mbetur! Aty pranë ishte dhe pylli me pisha. Ishte aq pranë. Ai udha krahëve dhe, kur nuk kishte më forcë, lëshoi këmbët poshtë. Uji i goditi shpinën dhe djali e kuptoi se kishte mbërritur. Në breg doli duke u rrëzuar dhe duke u ngritur. Dhe u përplas mbi rërën e lagur. Qëndroi pa lëvizur. Iu duk sikur qëndroi gjatë. Kishte humbur idenë e kohës. Kur u përmend e ndjeu se po qante. Ishin lot krejt të ndryshëm nga ata që kishte derdhur deri atëherë. Djalit nuk i erdhi turp që po qante. Pastaj u çua, mori këmishën dhe kanotierën, dhe u nis për në vilën e pushimit.

Lexo fragmentin nga tregimi “Djali dhe deti” dhe rretho përgjigjen e saktë, duke treguar se përse djali lufton me detin?

1. I duket si një e keqe që do ta mundë? ose
2. Si një dëshirë që do ta arrijë?
3. Dhe si mund të mposhtet frika?

- a) Me gjakftohtësi
- b) Me gjaknxehhtësi
- c) Me guxim
- d) Me ankth

### 230. Epi i Gilgameshit

(fragment)

*Porsa ta hash ti at bar të rrallë,  
Jetë e rini t`përjetshme do të kesh.  
Kur Gilgameshi këto fjalë I dëgjon,  
Në rrugë t`largët niset nëpër det.  
Posa mbërrin në detin me uj` t`ëmbël,  
Shokën e heq e zhveshet deri n`brez,  
E n`të dy këmbët gurë t`rëndë lidh  
Dhe n`thelësi të detit t`madh lëshohet  
E kap me dorë dhe e shtrëngon me force  
Barin magjik të detit n`dorë e mban.*

.....

Lexo vargjet e mësipërme dhe shkruaj çfarë motiv kanë këto vargje?

- a) Motivin e fantastikës;
- b) Motivin e pavdekshmërisë;
- c) Motivin e aventurës;
- d) Motivin e dashurisë.

### 231. Soneti është lloj i poezisë të cilën e karakterizon:

- a) forma e përhershme e përcaktuar (e dy katrenave dhe e dy tercinateve);
- b) paraqitja e ngjarjeve dramatike lidhur me të cilat tregohen ndjenjat e forta;
- c) fabula e zhvilluar e përshkruar me motive lirike;
- ç) ankimi për diçka që është e pakthyeshme, e humbur dhe e kaluar (fëmijëria, rinia, dashuria).

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

### 232. Elegjia është lloj i poezisë të cilën e karakterizon:

- a) forma e përhershme e përcaktuar (e dy katrenave dhe e dy tercinateve);
- b) paraqitja e ngjarjeve dramatike lidhur me të cilat tregohen ndjenjat e forta;
- c) fabula e zhvilluar e përshkruar me motive lirike;
- ç) ankimi për diçka që është e pakthyeshme, e humbur dhe e kaluar (fëmijëria, rinia, dashuria).

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**233.** Në vijë nën secilin fragment shkruaj emërtimin e formës përkatëse të rrëfimit: (monolog, dialog, tregimin, përshkrim)

Shega është një fqinja jonë me një moshë rreth të pesëdhjetave. Fqinjësia është goxha e vjetër, mbi njëzetvjeçare dhe, si i thonë, i njohim dhëmbë e dhëmballë njëri-tjetrit e njëra-tjetrës. E si të mos njihemi aq mirë, kur kemi marrë pjesë nëpër dasmat e secilës palë, kemi lindur fëmijët në të njëjtin pallat e në të njëjtin maternitet?... Edhe fëmijët aty u rritën e u bënë ca nga tetëmbëdhjetë e ca nga njëzetvjeçarë. E, pra, ne i njohim shoqi-shoqit edhe kollën kur ngjitemi nëpër shkallë, të mos themi se i njohim edhe ato “kollitjet” e zonës së poshtme...

Forma e rrëfimit është \_\_\_\_\_.

- Mirëmbërëma, o mik!
- Mirëmbërëma, - iu përgjegj udhëtari.
- Nga vjen zotrote?
- Nga qyteti.
- Ke ndonjë mik këtu, apo...
- Jo, jam inspektor arsimit.

Forma e rrëfimit është \_\_\_\_\_.

Sabri Tulani nuk e pyeti mikun nga qyteti përse qe munduar, se te shtëpia e tij vinin vazhdimisht blerës leshi, gjalpi, lëkurësh ose mish në këmbë. Mysafiri mbase donte katër a pesë shelegë për dasmë a ndonjë festë familjare. Pas përshëndetjes së zakonshme, miku nga qyteti filloi të interesohej për punët e çobanit që ruante dhentë e tij.

Forma e rrëfimit është \_\_\_\_\_.

**234.** Te shtëpia e babazotit

Më pëlqente shumë të shkoja mysafir te babazoti (kështu e thërrisnim gjyshin nga ana e nënës). Më pëlqente, se atje vendi ishte më i qeshur dhe më i butë dhe kryesorja se atje nuk kishte uri si në shtëpinë tonë. Në shtëpinë tonë të madhe, ndoshta nga shkaku i korridoreve, hajateve, musëndrave e kuberave, uria ndihej edhe më shumë. Veç kësaj lagjja jonë ishte bojë hiri, me shtëpi të dendura, pothuaj të ngjitura me njëra-tjetrën. Këtu çdo gjë ishte e përcaktuar, e ngulur njëherë e përgjithmonë, qindra vjet më parë. Rrugët, kthesat, qoshet, pragjet e shtëpive, shtyllat e telefonit dhe gjithçka tjetër ishin si të derdhura në gur, në largësi të përcaktuara me centimetra nga njëra-tjetra. Kurse te babazoti çdo gjë ishte e butë dhe e ndryshme. Atje rrugët dhe rrugicat bënë sikur harronin vendin nga kalonin një javë më parë dhe qetë-qetë e pa bujë zhvendoseshin nga e majta apo nga e djathta. Kjo ndodhte, sepse atje asgjë nuk ishte shtruar me kalldrëm, por me tokë të shkrifët. Veç kësaj, toka këtu ishte e rrëshqitshme. Këtu vendi ishte si njeriu: shëndoshej, dobësohej, zbukurohej, vrenjtej, shëmtohej, sipas ndërrimit të stinëve. Kurse lagjja jonë ishte pothuaj indiferente ndaj këtij ndërrimi.

Në pjesën veriore të lagjes kalonte rruga e kalasë, që lidhte lagjet e sipërme të qytetit me qendrën. Rruga ishte shumë lart në krahasim me nivelin e çatisë së dy shtëpive të vetme të lagjes dhe njëherë një kamion që u rrëzua, dëmtoi rëndë hajatin e shtëpisë së babazotit. Nganjëherë qëllonte që rrëzohej ndonjë i pirë dhe çatia pikonte një javë rresht. Po këto ishin gjëra të rralla.

Lexo tekstin e dhënë dhe trego mënyrën e rrëfimit të autorit në këtë tekst letrar për shtëpinë e babagjyshit. A është:

- a) Dialog
- b) Përshkrim
- c) Reportazh
- d) Monolog

**235.** Në vijën nën tekst të secilit fragmenti shkruaj emërtimin e formës përkatëse të rrëfimit (monologu, dialogu, përshkrimi, naracioni)

A po vjen xhaxho?  
Po vij, po vij!  
A ke të ftohtë?  
Po!

**Forma e rrëfimit është** \_\_\_\_\_.

O Jeton: ...Ja, ku është peshku i kaltërt, duhet ta zëmë. Duhet ta joshim disi, ta fusim rrjetin në ujë, dhe të presim të qetë... ti fare, mos merr frymë... dhe kur të ngrit kokën peshku, ta zëmë!... Kur të kërcej na ta fusim në rrjetë ....!

**Forma e rrëfimit është** \_\_\_\_\_.

Përmes dritares së „dhomës së pritjes“ shihet një mollë e vjetër e cila është rritur vetëm disa metra larg shtëpisë, dhe pas saj gjendet kopshti me lule dhe me pemë, e ngjashme me një zabel.

Forma e rrëfimit është \_\_\_\_\_.

Pas një kohe u paraqit një piktor i ri. Mbajti një ekspozitë me piktura dhe iu nënshtroi vlerësimit të opinionit publik. Pikturat nuk ishin të këqia. Unë si i huaj i vetmi edhe i kam shikuar, kurse nga vendasit nuk deshi asnjëri t'i shkojë.

Forma e rrëfimit është \_\_\_\_\_.



### 236. Djali dhe deti

Djali ishte larguar shumë nga bregu dhe kishin lënë fare forcat. Ai ishte zhytur përsëri edhe pse i ishin errur sytë. Në një cast kishte menduar se po mbytej dhe i kishte dhënë trupit lart. I dukej se bregu here largohej e here afrohej. Më vonë filloi vetëm të largohej. Mund të notoj ende tha dhe notoi përsëri. Nuk e dinte sa, nuk e maste dot. Patjetër duhet të dal në breg, tha djali.

Dhe dikur dalloj se ajo që zbardhte në breg, mbi trungun e kalbur nuk ishte pulëbardhë, por ishin rrobet e tij, kanotiera dhe këmisha. Mendoi të notonte edhe pak, sepse shumë pak I kishte mbetur. Ishte shumë pranë bregut. Ai u dha krehëve dhe, kur mendoi se nuk kishte më force I lëshoi këmbët dhe këmbët e tij u përplasën me rërën e lagur. Nuk mbante asgjë në mend, kishte humbur idenë e kohës. Kur u zgjua e ndjeu se po qante. Ishin lot gëzimi dhe nuk ishin lot turpi, por lot gëzimi. U çua, mori rrobet e tij dhe u nis për në vilën e tij.

Përpara se të përgjigjesh lexo me kujdes tregimin e dhënë më lartë, “Djali dhe deti”, dhe trego ç`është ritregimi? Rretho përgjigjen e saktë.

- a) Ngjarje e dëgjuar, e parë ose e lexuar;
- b) Ngjarje e analizuar;
- c) Ngjarje e vlerësuar;
- d) Ngjarje e rishkruar.

### 237. Djali dhe deti

Djali ishte larguar shumë nga bregu dhe kishin lënë fare forcat. Ai ishte zhytur përsëri edhe pse i ishin errur sytë. Në një cast kishte menduar se po mbytej dhe i kishte dhënë trupit lart. I dukej se bregu here largohej e here afrohej. Më vonë filloi vetëm të largohej. Mund të notoj ende tha dhe notoi përsëri. Nuk e dinte sa, nuk e maste dot. Patjetër duhet të dal në breg, tha djali.

Dhe dikur dalloj se ajo që zbardhte në breg, mbi trungun e kalbur nuk ishte pulëbardhë, por ishin rrobet e tij, kanotiera dhe këmisha. Mendoi të notonte edhe pak, sepse shumë pak I kishte mbetur. Ishte shumë pranë bregut. Ai u dha krehëve dhe, kur mendoi se nuk kishte më force I lëshoi këmbët dhe këmbët e tij u përplasën me rërën e lagur. Nuk mbante asgjë në mend, kishte humbur idenë e kohës. Kur u zgjua e ndjeu se po qante. Ishin lot gëzimi dhe nuk ishin lot turpi, por lot gëzimi. U çua, mori rrobet e tij dhe u nis për në vilën e tij.

Lexo tekstin e dhënë dhe trego se kur rrëfen me shkrim ose me gojë diçka që ke lexuar, parë apo dëgjuar nga të tjerët, quhet:

- a) Analizë.
- b) Ritregim
- c) Tregim

### 238. a) Përsërit me fjalët e mia, me shkrim ose me gojë, një pjesë të lexuar ose diçka të parë a të dëgjuar.

- b) Zbërthimi i fjalëve ose i fjalive në pjesët përbërëse për të përcaktuar vlerat e tyre gramatikore, leksikore etj. veç e veç.
- c) Lloj tregimtar i prozës së shkurtër letrare a publicistike, në të cilin jepen, pa hyrë në analizën e lidhjeve të brendshme të gjërave, tiparet e një njeriu, të natyrës etj. ose përshkruhet një dukuri e jetës, një ngjarje.

Rretho shkronjën para përgjigjes së analizës.

# NIVELI I PËRPARUAR

## Shkathtësitë e të lexuarit dhe të kuptuarit e leximit

### 239. Autori 1

Manuali i djaloshit ambientalist

Nikolla ishte i gatshëm të mbronte me thonj idetë e tij ekologjike, por nuk e kishte pritur që do të zhvillonte një debat aq të ashpër me Leonardon, mikun e tij ambientalist.

Kishin bërë kutiza të vogla prej druri për mbledhjen e mbeturinave të letrës, që t'i vendosnin në çdo klasë. Ishin marrë vesh me përgjegjësit e Mirëmajtjes Urbane, që çdo javë ata të tërhiqnin mbeturinat. Sapo kishin mbaruar së lyesi me bojë vaji kutizat dhe kishin larë furçat, kur Leonardoja shkoi në tualet për të hedhur në WC bojën e mbetur.

-Mos je çmendur vallë? – shpërtheu Nikolla.

Ç'të gjeti kështu? – ia ktheu Leonardoja.

Ku kujton ti se përfundon gjithçka që hedhim aty?

S'e di. Në det ndoshta?

E saktë! Sipas teje peshqit kënaqen po të hanë bojë?

Ah, a nuk e shikon se çfarë është shkruar në etiketë!

-Leonardoja mori kutinë dhe e lexoi: "Produkt ngjyrues. Përmban nitrobenzinë. Përmban elemente helmuese dhe acarën lëkurën dhe sytë. Të mbahet larg fëmijëve. Nuk duhet të hani e të pini apo konsumoni duhan gjatë përdorimit. Mbetjet mos i hidhni në ujëra të qarkullueshme apo edhe në puseta. Mos e shpërndani atë në mjedis."

Nuk është e lehtë gjithmonë të kuptosh cilat janë gjërat që ndotin mjedisin. Prej disa vjetësh industrialistët janë të detyruar të shkruajnë në etiketa nëse produkti i tyre ndot shumë apo pak, nëse është i dekompenzueshëm apo nuk përhapet në mjedis, nëse është toksik ose i parrezikshëm. Por a jemi gjithmonë të kujdesshëm, kur lexojmë etiketat e çdo produkti që përdorim?

Autori 2

Vajza sapo hyri në oborrin e shkollës shkoi të kërkonte zotin Filip. E përshkoi mes përmes edhe një herë oborrin dhe vajti trokiti te dera me xhama e portierit. Dua të takoj zotin Filip, - i tha ajo.

- Portieri e pa me habi.

-S'ka ardhur ende, - i tha dhe, si u mendua pak:

- Po më duket se ty të kërkon drejtoresha. Eja me mua.

-Lyllabaj i vajti pas pa fjalë. Ai ndaloi para një porte të lustruar dhe trokiti. Pastaj e hapi dhe ia bëri me shenjë Lullabajt që të hynte brenda. Që pas tryezës drejtoresha e pa me atë shikimin e saj zhbirues.

-Hyr brenda dhe ulu. Po të dëgjoj!

Lullabaj kur u ul te një karrige e pa tryezën e lyer me bojë. Kjo gjë shqetësoi sepse iu kujtuan gjërat e papastra e të lyera me lloj lloj bojërash të cilat i kishte parë në ujin e detit.

-Doja të takoja zotin Filip, - tha, - Më ka shkruar një letër.

-Drejtoresha ia ndërpreu fjalën. Zëri i saj ishte i ftohtë dhe i ashpër njëlloj si shikimi.

-E di që ju ka shkruar. Edhe unë ju kam shkruar. Po sështë fjala aty, por te ti. Ku ke qenë gjithë këtë kohë? Me siguri që do të kesh për të na treguar gjëra interesante. E pra, po ju dëgjoj, zonjushë.

-Lullabaj foli ngadalë, duke i kërkuar nga pak fjalët, sepse sikur e kishte humbur zakonin e të folurit.

-U mundua t'i rrëfente drejtoreshës për detin e kaltër me reflekse diamanti, për zhurmën e thellë të dallgëve, për horizontin fill të zi, erën e kripur ku fluturonin kryezinjte e detit, por edhe për mbetuturinat të cilat ishin hedhur në të dhe për brengosjen e saj për papastërtinë e detit.

Rretho shkronjën para pohimit të saktë.

Të dy autorët vetëm i kanë paraqitur të dhënat, pa pasur qëndrim për problemin të cilin e trajtojnë.

Autori 1 është i brengosur më shumë se sa autori 2.

Autori 2 është i brengosur më shumë se autori 1.

Të dy autorët njësoj janë të brengosur për shkak të mbeturinave që hidhen në det.

**240.** Lexo katër paragrafë për shkencëtarin e greqishtes së lashtë Eratostenin, nga një libër për shkollë fillore, dhe tri tekste në të cilat flitet për këta paragrafë. Thuaj cili tekst e ka përmbledhjen më të plotë të të gjithë paragrafëve.

Shkencëtarin grek, filozofin dhe gjeografin Eratostenin (në vitin 276–196, para erës së re), drejtorin e Bibliotekës së Aleksandrisë, për shkak të punimeve të rëndësishme gjeografike e quajnë “ati i gjeografisë”. Eratosteni i pari i ka sistematizuar të gjitha njohuritë për botën deri atëherë të njohur.

I ka pasqyruar në një nga hartat e para gjeografike dhe i ka botuar në librin e quajtur *Gjeografika*.

Në librin e dytë të *Gjeografikës* Eratosteni i ka botuar të gjitha njohuritë e deri atëherëshme për formën dhe madhësinë e Tokës, por edhe matjen dhe llogaritjen e parë të perimetrit të rrethit meridional të Tokës të cilën e ka bërë ai.

Eratosteni e ka ditur se në Sijenë (Asuanin e sotëm në Egjipt), rrezet e diellit në mesditë më 22 qershor e ndriçojnë fundin e një pusi, përkatësisht bien nën kënd të drejtë. Njëkohësisht, në Aleksandri, rrezet e diellit bien nën kënd i cili është i barabartë me pjesën e pesëdhjetë të rrethit (7,20).

Duke e shumëzuar largësinë midis Sijenës dhe Aleksandrisë me 50, e ka fituar rezultatin në të cilin perimetri i rrethit meridional sipas meridianës është 39.816 km. Sot me siguri e dimë se perimetri i rrethit meridional sipas meridianës është 40.009 km, dhe prandaj habitemi se si Eratostenit i cili me instrumente mjaft të thjeshta, dhe vetëm me njohuri themelore të gjeometrisë, në mënyrë mjaft të saktë ka arritur të caktojë Perimetrin e rrethit meridional, me ç'rast ka gabuar vetëm për 193 km.

Rretho shkronjën para tekstit i cili e paraqet përmbajtjen më të plotë të këtyre paragrafëve për

Erastotenin.

a) Sot Erastotenin e quajnë ati i gjeografisë. Ai i ka sistematizuar njohuritë e deri atëhershme të gjeografisë dhe i ka botuar në një vepër të quajtur *Gjeografia*. I pari e ka bërë llogaritjen e perimetrit të rrethit meridional. E ka bërë atë ashtu që e ka matur largësinë midis dy vendeve në krahasim me këndet e rrezeve të diellit. Llogaria e tij ka qenë mjaft e saktë – ka gabuar vetëm për 193 kilometra.

b) Teksti është mjaft interesant sepse flet për shkencëtarin Erastoten, i cili ka jetuar para erës së re. Ky shkencëtar me instrumente të thjeshta e ka llogaritur perimetrin e rrethit meridional. Sot e dimë se perimetri i rrethit meridional është 40.009 km, kurse ai atëherë e ka llogaritur se perimetri është 39.816 km. Ka gabuar për gjithsej 193 km! Kjo mjafton që ta quajmë “ati i gjeografisë”.

c) Eratosteni ka jetuar para erës së re. Ka qenë shkencëtar grek, filozof dhe gjeograf. Ka qenë drejtor i Bibliotekës së Aleksandrisë, dhe është marrë me sistematizimin e njohurive gjeografike. E ka botuar librin *Gjeografia*. Prandaj sot e quajnë „ati i gjeografisë”. E ka ditur se si rrezet e diellit bien nën kënd të drejtë në një pus. Kjo është mjaft e rëndësishme për llogaritjen e tij të Perimetrit të rrethit meridional të Tokës.

**241.** Lexo tekstin me vëmendje dhe nënvizo në fund të tekstit katër fjalët që ti mendon se janë më të rëndësishme:

Poshtë meje, fare pranë, dy metra afër këmbëve, vinin vërdallë pesë ujq. Dy ishin më të mëdhenj dhe tre më të vegjël, që u shëmbëllenin këlyshëve të një bushtre. Ai më i egri duhet të ishte i ati i tre të vegjëlve, kurse ajo më e dobëta, që rrinte pranë të vegjëlve, ishte e ëma. Kisha dëgjuar për ujqit në përralla, por me ty kurrë nuk i kisha parë. Tani i kisha nën këmbët e mia. Ndoshta për të mos ishte ai lisi i madh, lisi i fortë, mua do të më kishin shqyer ata.

**242.** Lexo me kujdes këtë tekst dhe zgjidhi detyrat.

Duke lexuar ndotjen e atmosferës shkencëtarët kanë konstatuar se Australia hedh në atmosferë më shumë gazra të dëmshme për një banor nga secili shtet tjetër i zhvilluar industrialisht. Për shkak të shtimit të numrit të banorëve dhe rrahjes së pyetjeve gjatë tre dhjetëvjetëshave Australia është bërë një nga ndotësit më të mëdhenj të gazrave të cilat i kontribuojnë të të ashtuquajturit “efektit të serrës së ngrohtë “. Kështu në Australi në vitin 1990 janë hedhur në atmosferë 36.4 tonë dioksid-karboni për një banor, ndërsa njëkohësisht në SHBA kjo sasi ka qenë 25,3 ton, në Kanada 23,1 ton, në Gjermani 18 ton dhe në Norvegji 12,1 ton.

Thekso tri fjalë vendimtare nga ky tekst:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

**243.** Lexoje tekstin. Në të janë paraqitur dy mendime të kundërta për lidhshmërinë e programeve të dhunshme televizive dhe sjelljes së dhunshme.

Gjej në tekst argumentet me të cilat mbështeten këto mendime.

A ndikon dhuna në televizion te sjellja e dhunshme e shikuesve?

Ekzistojnë mendime të ndryshme për këtë se sa dhuna, e pasqyruar në emisione televizive, ndikon në sjelljen e dhunshme të shikuesve të emisioneve të tilla.

Gati të gjitha mediat janë përplot me përmbajtje të dhunshme. Madje edhe filmat vizatimorë për fëmijë, sipas vlerësimeve të numrit të madh të prindërve, kanë përmbajtje të dhunshme kështu që fëmijët nuk do të duhej t'i lejojmë që t'i shikojnë. Mirëpo, disa autorë pikërisht në përfaqësimin e madh të përmbajtjeve të dhunshme në programe gjejnë dëshmi për pohim se televizioni nuk ndikon në sjelljen e dhunshme të shikuesve. Shumë njerëz me dëshirë i shikojnë filmat me përmbajtje të këtyre. Por sikur televizioni njëmend do të shtonte prirjen për sjellje të dhunshme, këta të njëjtit njerëz ashtu edhe do të silleshin. Megjithatë, shumë njerëz të cilët me besnikëri i shikojnë filmat dhe seritë me përmbajtje të dhunshme nuk kanë ndryshuar si persona për shkak të përmbajtjeve të këtyre emisioneve, përkatësisht nuk mund të vërejmë ndonjë dallim të madh midis tyre dhe atyre të cilët nuk shikojnë emisione të tilla. Sikur të ishte ndikimi i programeve TV aq i madh, problemi me dhunën në popullsi do të shtohej shumë më tepër se sa që është duke u rritur tani. Pra, sipas kësaj pikëpamjeje, përmbajtjet e dhunshme në televizion nuk janë duke e shtuar sjelljen e dhunshme të atyre të cilët i përcjellin programet e tilla.

Në anën tjetër, studime të shumta të bëra me kujdes paraqesin dëshmi për ekzistimin e lidhjes së fuqishme midis dhunës në televizion dhe sjelljes së dhunshme të atyre të cilët i shikojnë programet e tilla.

Në hulumtimet të cilat merren me shqyrtimin e këtij problemi të anketuarit zakonisht ndahen në tri grupe: në ata të cilët shikojnë filma me përmbajtje të dhunshme, në ata të cilët shikojnë filma me përmbajtje të padhunshme dhe në ata të cilët gjatë sprovës nuk shikojnë asnjë film. Sadoherë që të përsëritet ky lloj i sprovës, rezultatet gjithnjë janë të ngjashme – shikuesit e programeve me përmbajtje të dhunshme më vonë sillen në mënyrë të dhunshme më shumë se sa të anketuarit nga dy grupet e tjera.

Duke iu referuar tekstit, thekso argumentet të cilat i mbështesin dy mendimet.

1. Mendimi i parë: Dhuna e pasqyruar në televizion ndikon në sjellje të dhunshme të shikuesve të këtyre emisioneve.

Argumenti: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

2. Mendimi i dytë: Dhuna e pasqyruar në television nuk ndikon në sjellje të dhunshme të shikuesve të këtyre emisioneve.

Argumenti: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**244.** Lexoje tekstin dhe përgjigju në pyetje.

Bëj mirë – e mira do të kthehet!

Flemingu ka qenë një fshatar i varfër skocez. Një ditë, derisa ka punuar në arë, ka dëgjuar klithmat për ndihmë të cilat janë dëgjuar afër një moçali i cili ka qenë afër.

Atje, gati krejtësisht i fundosur në baltë të zezë, ka qenë një djalosh i tmerruar, i cili ka bërë titur dhe është munduar që të dalë nga moçali. Fermeri Fleming e ka shpëtuar djaloshin nga vdekja e ngadalshme por e sigurt në baltën e moçalit.

Të nesërmen në oborrin e shtëpisë së tij modeste është paraqitur një karrocë elegante. Një njeri i veshur me rroba elegante ka zbritur nga karroca dhe është prezantuar si i ati i djaloshit të cilin një ditë më herët e ka shpëtuar fermeri.

„Dua t’ju shpërblej”, ka thënë ky njeri fisnik. „Ia keni shpëtuar jetën të birit tim!”

„Jo, nuk mund ta pranoj këtë”, është përgjigjur me krenari fshatari skocez, duke e refuzuar ofertën e tij.

Në atë moment i biri i fermerit është paraqitur në derën e hyrjes së shtëpisë.

„A është ky i biri juaj?”, e ka pyetur fisniku.

„Po”, është përgjigjur me krenari fermeri.

„Kam një propozim për ju”, i ka thënë fisniku. „Më lejoni që t’ia ofrojë mundësinë të shkollohet në shkollë në të cilat shkollohet edhe i biri im. Nëse ngjan në t’jatin, pa dyshim, ai do të bëhet njeri për të cilin të dytë do të jemi krenarë.”

Këtë ofertë fshatari e ka pranuar.

I biri i fshatarit Flemeng, Aleksandër Flemingu, është shkolluar në shkollat më të mira dhe brenda afatit të duhur ka marrë diplomën e Akademisë së Mjekësisë „St. Marus” në Londër. Është bërë i njohur në mbarë botën si zbulues i penicilinës.

Pas shumë vjetësh, këtij fisniku i është sëmure rëndë i birii nga mushkëritë, që në atë kohë ka qenë sëmudje vdekjeprurëse. Ajo që ia ka shpëtuar jetën në atë moment ka qenë - penicilina.

Ndoshta pyetni si është quajtur ky fisnik?

Lord Landorf Çerçili!

Po si është quajtur i biri i tij?

Vinston Çerçili!

1. Aleksandër Flemingu ka qenë:

- a) Fshatar i varfër skocez;
- b) I biri i fshatarit skocez;
- c) Fisnik;
- ç) i biri i lordit Landorf.

2. Aleksandër Fleming është i njohur për:

- a) Sepse ia ka shpëtuar jetën të birit të fisnikut;
- b) Kontribut në zhvillim të mjekësisë;
- c) Pasurinë e fituar nga prona;
- ç) Me nota të mira në studime.

Rretho shkronjën para pohimit të saktë.

## 245. Odiseu dhe Konstandini

Homeri rrëfen në librin e 23-të të Odisesë se si Odiseu, pas luftës së Trojës dhe pas peripecive të tij të shumta kthehet së fundi në atdheun e tij, në Itakë. Midis kthimit të Odiseut dhe kthimit të Konstandinit – Ymer Agos ka, besoj, mjaft pika kontakti:

- 1) Odiseu niset si burrë i ri për në luftë dhe lë në shtëpi gruan e tij të re e besnike Penelopën; Konstandin – Ymer Aga niset si dhëndërr i ri për në luftë dhe lë të shoqen besnike në shtëpi.
  - 2) Pasi Odiseu 20 vjet me radhë nuk kthehet, Penelopës i mblidhen rreth një tok kandidatës duke insistuar që të martohet me njërin prej tyre. Nusja e Konstandinit – Ymer Agos e pret të shoqin nëntë vjet ditë dhe së fundi e shpien të martojnë me një tjetër.
  - 3) Odiseu kthehet nga lufta, në fillim i panjohur prej njerëzve të tij. Konstandinin – Ymer Agua kthehet nga lufta dhe nuk e njohin as prindërit e vet.
  - 4) Odisenë e njeh së pari vajza e tij: Kjo sipas zakonisht grek ia lan këmbët mikut të huaj dhe atëherë e njeh Odisenë me një shenjë që ia kishte lënë në kofshë një derr i egër në një gjah.
- (...)

Thekso **katër** fjalë vendimtare nga ky tekst:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_

## 246. Lexo fragmentin me kujdes.

Kam zbuluar arsyen pse Dora ka ndryshuar kaq shumë ose më saktë, është kthyer siç ishte më parë, d.m.th., para dimrit të shkuar. Gjatë katër javëve në Francë ka gjetur te mami një shoqe të vërtetë! Sot e hodha llafin për Viktorin, dhe ajo menjëherë më tha vetëm: - Oh, nuk mbaj më korrespondencë me të.- Dhe kur e pyeta: - Bëtë llafë? I kujt është faji? – U përgjigj: - jo, jo, thjesht i dhashë duart. Çdo të thotë i dhashë duart? Nuk është nisur për në Amerikë, apo jo? – dhe atëherë u përgjigj: - E dashur Rita, është mirë ta sqarojmë njëherë e përgjithmonë këtë punë. E lashë fare duke iu bindur dëshirës së drejtë të nënës sonë të dashur. – Duhet të shtoj që edhe pse e dua me gjithë shpirt mamin, nuk mund ta mendoj ta kem për shoqe qoftë edhe një çast. E si mund të jesh shoqe me mamin tënd? Dora nuk e ka idenë se çështje miqësia e vërtetë. Ka gjëra të cilat një vajzë nuk mund t'i diskutojë me të ëmën, psh., nuk mund ta pyes: “E di çdo të thotë në të vërtetë ka ndodhur ndonjë gjë? Nuk jam madje as e sigurt nëse ajo e di çdo të thotë, sepse kur ajo ishte 13 ose 14 vjeç, me siguri njerëzit përdornin shprehje të ndryshme, dhe ndoshta këto që përdorim ne tani, në atë kohë kishin një kuptim tjetër. E ç'miqësi është ajo kur mami i thotë Dorës: - Nuk duhet të dalësh tani, sepse nga çasti në çast mund të plasë shtrëngata, ndërsa mbrëmë i tha: - Dora, shiko se duhet të vësh shallin. Miqësia mes nënës dhe vajzës është e pamundur, ashtu siç është edhe miqësia mes babait dhe djalit. Sepse mes shokësh nuk mund të ketë urdhra ose kufizime, dhe ajo që është më e rëndësishme, me prindërit nuk mund të bisedosh për të gjitha gjërat që do të doje të dije. Mbrëmë për shembull, i thashë: - Natyrisht që mami të ka ndaluar të flasësh për disa çështje, dhe ti këtë e quan miqësi? – Ajo u përgjigj ëmbël-ëmbël: Rita, mami nuk më ka ndaluar, por e kuptoj vetë se jam nxituar që të kam folur për disa gjëra. Serioziteti në jetë mësohet shpejt. – Ia plasa të qeshurit dhe thashë: - Dhe ti e quan serioziteti i jetës? Nuk të kujtohet se dikur na vinte për të qeshur me këtë gjë? Shpresoj vërtet që shoqja ime do të vijë, sepse kam aq shumë nevojë për të, siç ka dhe ajo për mua

Në fragmentin e dhënë vajza shpreh:

- opinionet dhe argumentet e shokëve të saj
- opinionet dhe ndjenjat e veta
- grykimet dhe vlerësimet e veta
- mendimet dhe ndjenjat e Dorës

247. Shiko me kujdes tabelën dhe përgjigju në pyetje.

**TABELA E KLASIFIKIMIT TË BASHKËTINGELLOREVE TË SHQIPES**

			BUZORE		PARAGJUHORE			Mesgjuhore	Të prepra- gjuhore	FARINGALE			
			Dy buzore	Buzore dhëmbore	Kakumi- nale	Apikale	Dorsale			Të sipërme	Të poshtëme		
<b>OKLUZIVE</b>	Të zhurmëta	Afrigate	<b>TË THJESHTA</b>										
			Dy vatërshë	Një vatërshë	Shtegrrafshta	p b			t d		q gj	k g	
				Shtegrrumbullakia			c x						
				Me vatrën e dytë të mesit			ç xh						
				Me vatrën e dytë të fundit									
	<b>SONANTE</b>			m			n		nj				
	Të zhurmëta	Dy vatërshë	Një vatërshë	Shtegrrafshta		f v		th dh				h	
				Shtegrrumbullakia				s z					
				Me vatrën e dytë të mesit				sh zh					
				Me vatrën e dytë të fundit									
<b>MESORE</b>							j						
Sonante	<b>ANËSORE</b>					l ll							
	Dridhëse	<b>TË ZHURMËTA</b>											
<b>SONANTE</b>					r rr								

Fig. 21

46 • FONETIKA E GJYRES SË SOTMË SHQIPË

- Cilat janë okluzive dybuzore? \_\_\_\_\_
- Rretho sonantet dridhëse



**248.** Shiko me kujdes tabelën e mëposhtme:

	Fjala	Fjala jo e parme ndahet në:
Fjala e prejardhur formohet	Fjala jo e parme formohet me:	
Parashtesë + temë fjalëformuese	Temë + temë	E prejardhur
Temë fjalëformuese + parashtesë	Emër + emër	E përbërë
Parashtesë + temëfjalëformuese + parashtesë	Emër+mbiemër	E përngjitur
	Emër+folje	
	Ndajfolje+emër	
	Përemër + emër	
		Të përngjitur janë: Të përngjitur janë: Emra, ndajfolje Përemjra Parafjalë Pjesëza pashthirma

Si ndahet fjala jo e parme? \_\_\_\_\_

**249.** Shiko me kujdes tabelën e mëposhtme:

Fjalët e ndryshueshme të ligjëratës	Fjalët e pandryshueshme të ligjëratës
Emri	Parafjalët
Mbiemri	Ndajfoljet
Folja	Lidhëzat
Përemri	Pjesëzat
numrat	pashthirrat

Nënvizo ku gjenden pjesëzat.

## Të shprehurit me shkrim

**250.** Vendos vetëm shenjat e pikësimit që janë karakteristike për ligjëratën e drejtë. Vendos ku duhet shenjat e pikësimit që mungojnë.

Sot e hodha llafin për Viktorin dhe ajo menjëherë më tha: Oh nuk mbaj më korrespondencë me të – dhe kur e pyeta: - Bëtë llafe? I kujt është faji? U përgjigj: jo jo thjesht i dhashë duart. – Çdo të thotë i dhashë duart?

**251.** Rretho shkronjën para fjalisë e cila është shkruar saktë, sipas rregullave të drejtshkrimit.

- a) Kush e di kur do të kthehet.
- b) Ai do të punojë në një ndërmarrje shumë të njohur.
- c) Për herë të parë kam dëgjuar për “Bashkimin Evropian”.
- d) Tridhjetëpesë mijë spektatorë ishin mbledhur në stadium.

**252.** Lexo dhe shkruaj në vijat e mëposhtme se cilat janë dëshirat a djaloshit në tregimin e mëposhtëm Vullneti

U mendova, u mendova dhe më në fund e gjeta atë që nuk shkonte, ishte vullneti. Domethënë se vullnetin e kam, po jo të fortë; madje a kam fare të dobët. Kur kam diçka për të bërë, nuk e urdhëroj veten që ta bëj. Dhe kur nuk duhet ta bëj një gjë, nuk e mbaj dot veten që të mos e bëj. Ja kur filloj të lexoj ndonjë libër interesant, lexoj, lexoj dhe nuk e lë dot. Sado që vjen koha të filloj detyrat ose të bie për të fjetur, vazhdoj leximin. Nëna më thotë të shkoj në shtrat dhe babai më lajmëron se ka ardhur koha e gjumit. Unë nuk tundem nga vendi. Kjo zgjat gjersa shuajnë dritën që të mos mund të lexoj më. Po kjo më ndodh edhe në futboll. Nuk kam aq vullnet sa të lë lojën në orën e duhur. Ç’ka ç’të bëj tjetër!

Madje jam çuditur shumë me veten time, si qenka kështu kjo punë. E dija se isha me karakter e me shumë vullnet, kurse unë qenkam një njeri i dobët. Kam marrë një vendim të forcoj vullnetin. Vallë ç’duhet bërë për këtë? Njeriu nuk duhet të bëjë vetëm atë që ia ka ënda, po edhe aqë që nuk i pëlqen.

Dhe pikërisht këtë mbrëmje nëna ka bërë ëmbëlsirën që më pëlqen më shumë për ta ngrënë me çaj. Më dha copën më të mirë, atë të mesit, por unë nuk e preka.

-Pse s’po e ha ëmbëlsirën? – më pyeti nëna.

-Do ta lë në pjatë gjer pasnesër në darkë, dy ditë. Pasnesër mbrëma do ta ha.

-Ke marrë ndonjë zotim, Viktor?

-Po, kam marrë një zotim. Në qoftë se nuk e ha përpara kohës që kam caktuar, do të thotë se kam vullnet.

-Po në qoftë se e ha? – më pyeti Lika. – Po ta ha, do të thotë se jam i dobët. A s’kupton?

---

---

---

---

## Gramatika, leksiku, gjuha popullore dhe letrare

**253.** Fjalët e dhëna ndaj në rrokje:

hekurudhë \_\_\_\_\_  
pasardhës \_\_\_\_\_  
bashkudhëtar \_\_\_\_\_  
vetëdukim \_\_\_\_\_

**254.** -Ndaj fjalët e poshtëshënuara sipas rregullave drejtshkrimore

- pushka
- kodra
- partia
- gjimnastika
- pranvera
- idustria

**255.** . Ç'lloj homonimesh janë: mund (folje) # mund (emër):

- a) Të mirëfillta
- b) Të pjesshme
- c) Të plota
- d) Gramatikore

**256.** -Trego si quhet fenomeni fonetik i ndërrimit të tingujve në fjalë me shembujt e shënuar më poshtë:

p.sh: arbitër-albiter, bilbil-birbil, gjarpër-gjalper, prite-priste, bodrum-budrun etj.

-Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

- a) Asimilim
- b) Apofoni
- c) Qiellzorizim
- d) Disimilim

**257.** -Bashkëtingëlloret k,g, h janë bashkëtingëllore:

- a) Paragjuhore
- b) Mesgjuhore
- c) Prapagjuhore

**258.** Në cilën nga fjalët e dhëna nuk është bërë qiellzorëzimi? Nënvizoni atë fjalë.

- a) kungull- kunguj
- b) lepur- lepuj
- c) peshk- peshq
- d) baba- baballarë
- e) breg-brigje

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**259.** Si quhet ndërrimi i këtyre bashkëtingëlloreve.

- k/q: plak – pleq, mik – miq, peshk, peshq
- g/gj: breg- brigje, shteg – shtigje, lëng - lëngje
- ll/j: shekull- shekuj, kunguj-kungull, portokall - portokaj
- r/j: bir – bij, lepur – lepuj, flamur – flamuj

Po ndërrimi i zanoreve (a/e) si quhet?

a/e: dash – desh, plak – pleq, natë - net, marr-merr

**260.** Shkruaj shumësin e këtyre emrave:

bujk \_\_\_\_\_

lak \_\_\_\_\_

çak \_\_\_\_\_

armik \_\_\_\_\_

sfurk \_\_\_\_\_

ermik \_\_\_\_\_

bakall \_\_\_\_\_

çakall \_\_\_\_\_

mashkull \_\_\_\_\_

shekull \_\_\_\_\_

**261.** Trego fjalitë e shënuara më poshtë çfarë theksi kanë:

drejtori, punëtori, lumturi, liri, pavarësi.

- a) theks fundor
- b) theks parafundor
- c) theks tejfundor

**262.** Cilat lidhëza janë lejore:

- a) në, po, nëse, kur
- b) kur, sa, tek, sapo
- c) ku, tek, nga, kudo
- d) ndonëse, edhe pse, edhe po.

**263.** Cilat lidhëza janë vendore?

- a) se, që, në, nëse
- b) gjersa, pasi, ndërsa, qëkurse
- c) kudo, ngado që, deri ku, nga
- d) qëkurse, sapo, teksa, që kur

**264.** Në fjalinë: "Pa cicërimat e zogjve, koria do të ishte e zbrazët" ka marrëdhënie:

- a) qëllimi
- b) shkaku
- c) kushti
- d) kundërshtimi

**265.** Në vend të pikave vendos njërën nga trajtat e shkurtra ose të shkurtra të bashkuara në kllapa (të, i, ia, e, më)

Atëherë ajo shkroi një copëz kartë,..... lidhi pëllumbit në këmbë dhe, në kohën që djalli hapi tokën për të dalë, e lëshoi fshehurazi zogun. Ja ku po të them se, ..... ka marrë uria shumë. Ti nuk do as ta vështrojnë, as të mos.....vështrojnë. Ti nuk do as të..... pyesin dhe as që të heshtin. Çfarë do ti, në të vërtetë? Ai puthi vajzën e vogël që..... hapi portën dhe i mori pallton t'ia varte.

**266.** Në vend të pikave vendos në trajtën e duhur emrat në kllapa:

Nëpër .....(rrugë) e vjetra dhe të heshtura të.....(qytete) të Shqipërisë, në .....(net) e freskëta të pranverës ose në .....(ditë) e ftohta të dimrit, populli e njihte tashmë (makinë) që mbante piano. Emrat dhe .....(vepra) e Moxartit, Rosinit, Verdit, Belinit, Bizësë e të shumë kompozitorëve të tjerë po dëgjoheshin edhe në .....(qytete) më të humbura të Shqipërisë. Ata po bëheshin të njohur nëpërmjet.....(këngëtarëve) shqiptarë.

**267.** -Në fjalinë e poshtëshënuar tregoni cila prej fjalive është e varur dhe cila kryesore:

1. Kur erdhi radha Gjergji e hodhi bukur topuzin e vet dhe e qëlloi Bajlozin në shteg të ballit.

a) Kur erdhi radha \_\_\_\_\_

b) Gjergji e hodhi bukur topuzin e vet dhe e qëlloi Bajlozin në shteg të ballit

---

**268.** Rretho pjesët e ndryshueshme të ligjëratës:

a) parafjala

b) emri

c) folja

d) lidhëza

e) mbiemri

f) përemri

g) ndajfolja

**269.** Sa folje mund të ketë fjalia e thjeshtë?

a) një folje,

b) dy e folje

c) dy e më shumë folje,

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**270.** Nënvizto fjalinë e cila e ka togfjalëshin e lirë:

a) *baltë baltë e kuqe, shumë ditë, bukë gruri*

b) *Kishte hyrë vjeshta e tretë . Vuante nga mëlçia e zezë.*

Rretho shkronjën para togfjalëshave të lirë.

**271.** Foljet në kllapa i vini në mënyrën urdhërore:

1. Artan (vjel) rrush!

2. Arta (sjell) sa lule!

3. Ajo (sheh) mirë punën e vet!

4. (ke) kujdes për veten!

5. (jam) mirë me shëndet

6. (Blej) diçka për ushqim.

7. I (bie) violinës!

**272.** 1) Sa folje mund të ketë fjalia e përbërë?

- a) një folje,
- b) dy folje
- c) dy e më shumë folje,

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**273.** Në vijat përkatëse përballë fjalive të poshtëshënuara shkruaji rasën e emrit të nënvizuar:

- a) Mësuesin e pashë para oborrit të shkollës. \_\_\_\_\_
- b) Detyra e mësuesit është e shenjtë. \_\_\_\_\_
- c) Mësuesi im është i sjellshëm. \_\_\_\_\_
- ç) Prej mësuesit mësojmë shumë gjëra. \_\_\_\_\_
- d) Mësuesit i dhanë një dhuratë. \_\_\_\_\_

**274.** Emrat e gjuhës shqipe ndahen dhe rretho shkronjën e saktë para emrave të cilët mbarojnë me zanore të theksuara dhe me bashkëtingëlloret k,g,h.

- a) emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me -i.
- b) emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me -u.
- c) emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me a ose ja.
- d) Emrat e gjinisë asnjënese që mbarojnë me -it, -ët, t.

**275.** Shkruaj foljen në kohën e duhur:

Plaku (mbështes – më se e kryer) \_\_\_\_\_ dorën në supin e Aurelit.

Një ditë , ndaj të ngrysur, teze Poli (dal – e kryera e tejshkuar) \_\_\_\_\_ me një letër në dorë.

Në atë kohë (jam – e kryera) \_\_\_\_\_ e re , e bukur e shëndetshme.

As ai nuk (kuptoj – e ardhmja e përparme) \_\_\_\_\_ përse isha i shqetësuar.

Ngrica filloj – më se e kryera) \_\_\_\_\_ të zbutej.

Në jetën tuaj nuk (dëgjoj – e kryera) \_\_\_\_\_ një gjë të tillë.

**276.** Lakoni emrin e gjinisë mashkullore vëlla, në trajtën e shquar dhe të pashquar, njëjës dhe shumës.

Rasat	Njëjësi		Shumësi	
	Trajta e pashquar	Trajta e shquar	Trajta e pashquar	Trajta e shquar

**277.**-Përballë fjalëve të poshtëshënuara shkruaj rasën e emrit të nënvizuar:

1. Librin e gjuhës ia dha shokut: \_\_\_\_\_
2. Shoku im recitoi bukur-\_\_\_\_\_
3. Shokun e klasës e takova në tren-\_\_\_\_\_
4. Recitimi i shokut tim më pëlqeu-\_\_\_\_\_
5. E mora fletoren prej shokut: - \_\_\_\_\_

**278.** Fjala e nënvizuar është::

Të ndalemi pak te çështja e Hydrocentralit  
të ndalojmë pak te Hydrocentrali  
Të merremi pak me çështjen e Hydrocentralit.  
Të ndalemi në Hydrocentral.

- a) pyetëse;
- b) nxitëse;
- c) dëftore; dhe
- d) dëshirore.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë

**279.** Lexo këtë tekst dhe zgjidh detyrën:

Muzika e Indisë në shekullin e vjetër

Muzika e Indisë së vjetër ka formë të veçantë. Melodinë indiane e karakterizon një spektër i gjerë, si edhe një ecuri e lirë ritmike dhe formale.

Indianët e vjetër e kanë bërë dallimin e madh midis muzikës spirituale dhe laike.

Meloditë shpirtërore bazoheshin në tekste të librave fetarë (Veda) dhe ishin të qeta, me ritëm të ngadalshëm dhe dinjitoz. Në brendi muzikat laike ishin melodike dhe mallëngjyese. Këto melodi gjithnjë i këndonin në kohën që më parë të caktuar.

Fjala e nënvizuar e nënkupton muzikën:

- a) Orientale;
- b) E qetë dhe me ritëm të ngadalshëm;
- c) Popullore, joreligjioze;
- d) Religjioze, kishtarë.



**280.** -Të gjitha foljet që kanë mundësi për të marrë ose jo kundrinë të drejtë, ndahen në folje kalimtare dhe jokolimtare.

-Në vijat përkatëse përballë fjalive të poshtëshënuar trego se folja e fjalisë është kalimtare apo jo kalimtare;

1. Kaloi klasën mirë \_\_\_\_\_
2. Kaloi rrugës me nxitim \_\_\_\_\_
3. Ajo humbi lapsin \_\_\_\_\_
4. Ajo humbi në gjumë \_\_\_\_\_

**281.** Lexo fjalët e mëposhtme që kanë prejardhje nga gjuhët e huaja dhe trego kuptimin e tyre përkatës:

- a) - diferencë
- b) - abuzim
- c) - urgjencë
- d) - agrokulturë
- e) - koktej

## Letërsia

### 282. Lexo vargjet e mëposhtme:

#### Marshi i Barabbajt

Allalla, o rezil e katil, allalla,  
Shtroni udhën me hithr' e me shtok turfanda,  
Gumëzhit, o zinxhir e kamçik, batërma,  
Lehni, laro, kaba: Hosanna, Barabba!

Tradhëtor, ti na nxive, na le pa atdhe,  
Ti na çthure, na çkule, na çduke çdo fe,  
Varfëri, poshtërsi, robëri ti na dhe,  
Derbeder, ujk e derr: Hosanna, Barabba!

O stërnip i Kainit, tepdil si bari,  
Ti na shtyp e na shtryth e ti gjakun na pi,  
Ti na ther e na grin e për qejf na bën fli;  
O kokuth e lubi: Hosanna, Barabba!

Në budrum, nëpër llom' e kufom' u-mallkofsh,  
Në skëterrën, katran e tiran, u-harbofsh,  
Me tam-tam e allarm' e me nëm' u-shurdhofsh,  
Në zëndan mbretërofsh: Hosanna, Barabba!

O i çgryer, i zhyer, i vyer për hu,  
Turp-e-ndot-kundërmonjës të krusen mbi gju  
Dallkaukët, kopukët e turmat pa tru,  
Zëmër-krund-e-gërdhu: Hosanna, Barabba!

Allalla, o rezil e katil, allalla,  
Shtroni udhën me hithr' e me shtok turfanda,  
Gumëzhit, o zinxhir e kamçik, batërma,  
Lehni, laro, kaba: Hosanna, Barabba!

(“Marshi i Barabbajt”, Fan Noli.)

Shkruaj cila figurë stilistike është përdorur në vargjet e kësaj vjershe të bukur?

---

---

---

---

**283.** Trego kuptimin e fjalës së nënvizuar në fjalinë e dhënë.

Mos na **shitë mend** – I tha Agroni – se ta dimë forcën dhe trimërinë.

- a) Iu është rritur mendja
- b) Është mendjemadh e mburret para të tjerëve
- c) Është i sëmurë dhe i dhemb koka

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**284.** Lexo vargjet e mëposhtme:

Nji sokol qi ishte mëseu  
Bate zheg-o te nji prrue.  
Shkoni fllanxa me pushue,  
Fllanxën ma ka rrejtun gjumi.  
Thotë sokoli: un' i lumi!

(Këngë popullore)

Shkruaj cila figurë stilistike është përdorur në vargjet e kësaj strofe?

- a) Metafora
- b) Simboli
- c) Alegoria
- d) Metonima

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**285.** Në një roman nga lektyra jote është përshkruar kështjella e lashtë shqiptare dhe rrethimi nga ana e turqve. Është përshkruar jeta e popullsisë shqiptare nën rrethim dhe përpjekjet e pashës së Turqisë të pushtojë kështjellën.

Për cilin roman është fjala? Kush e shkroi këtë roman?

Titulli i romanit: \_\_\_\_\_

Autori i romanit: \_\_\_\_\_

## 286. Më ktheni paqen time

Në zhurmën e mirënjohur lindi urna ime, ligësi.  
Burim që trazira gurgulloi në e parë e gjithnjë,  
Nga agimi në mbrëmje kërkova Pranverën time  
Nga mbrëmja në agim kot lëkundej qenia ime.  
U bë ç`u bë, do të lind Pranvera me lule!  
Jam duke ndjerë një jehonë që pas do të vijë –  
Jehona rritet dhe rritet përditë më shumë;  
Ju lutem, Pranvera jo, më ktheni paqen time.

Në njërën prej veprave letrare nga lektyra gjendet edhe poezia e lartshkruar, në të cilën autori tregon për jetën e vet. Shkrimtari është nga treva ku jeton edhe ti. Për cilën vepër bëhet fjalë? Trego titullin e veprës dhe kush është autori i saj?

titulli i veprës: \_\_\_\_\_

autori i veprës: \_\_\_\_\_

## 287. Fragmenti i romanit të Servantesit "Don Kishoti" e paraqet fillimin, pikën kulminante ose përfundimin e ngjarjes.

Për së largu u duken nja tridhjet a dyzet mullinj të erës, që ishin në atë fushë dhe posa i pa, Don Kishoti i tha shtizëmbajtësit të tij:

– Fati na i rregullon punët më mirë se ç`dëshirojmë vetë. Se, pa shiko atje, i dashur Panço, që na janë shfaqur nja tridhjetë e ca më tepër viganë, me të cilët kam ndërmend të bëj betejë dhe t`i vras që të gjithë, pastaj do t`i plaçkisim dhe kështu do të nisim të pasurohemi! Se kjo është një luftë e mirë duke e spastruar faqen e dheut nga njerëz të këqij.

– Ç`viganë? – tha Sanço Panço.

– Ata që shikon atje, – iu përgjegj Don Kishoti, – me krahë të gjatë prej afro dy kilometrash.

– Shiko mirë, imzot, – iu përgjigj Sançoja, – se ata që duken atje, nuk janë viganë, po mullinj të erës dhe ata që duken si krahë janë pëlhurat, të cilat vërtiten prej erës dhe rrotullojnë gurin e mullirit.

– Merret vesh, – iu përgjigj Don Kishoti, – që ti s`ke haber fare nga aventurat. Ata janë viganë. Po nëse ke frikë, largohu së këndejmi, kurse unë shkoj në betejë të egër dhe të pabarabartë me ta...

Ky fragment e paraqet:

- a) fillimin e ngjarjes
- b) ngjarja është në pikën kulminante
- c) fundin e ngjarjes
- d) nuk ka kurrfarë ngjarje

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**288.** Lexo vargjet e mëposhtme:

Në mes tuaj kam qëndruar  
E jam duke përvëlur,  
Që t'u ap pakëzë dritë,  
Natënë t'ua bënj ditë.  
Do të tretëm, të kullohem,  
Të digjem, të përvëlohem,  
Që t'u ndrinj mir' e të shihni,  
Njëri-tjatërin të njihni.  
Për ju do të rri të tretëm,  
Asnjë çikë të mos mbetem,  
Të digjem e të qanj me lot,  
Se dëshirën s'e duronj dot.  
Unë zjarrit nuk i druhem  
Dhe kurrë s'dua të shuhem,  
Po të digjem me dëshirë,  
Sa të munt t'u ndrinj më mirë.  
Kur më shihni se jam tretur,  
Mos pandehni se kam vdekur;  
jam i gjall' e jam ndë jetë  
jam në dritët të vërtetë,  
Unë jam në shpirtit tuaj,  
Mos më kini për të huaj,  
Mështë falurë durimi,  
Andaj po digjem si trimi,  
Se ma kënda t'u bënj mirë,  
Të mos mbeti nërrësirë.

Lexo me kujdes vargjet e lartshkruara:

Trego titullin e vjershës: \_\_\_\_\_;

Trego autorin e vjershës: \_\_\_\_\_;

**289.** Në cilin stil përdoren shpesh emrata prejfoljorë me **-im** dhe **-je**?

- a) Në stilin e letërsisë artistike
- b) Në stilin tekinko-shoqëror
- c) Në stilin politiko-shoqëror
- d) Në stilin fetar

**290. Marshi i Barabajt**

Allalla, o rezil e katil, allalla,  
Shtroni udhën me hithr' e me shtok turfanda,  
Gumëzhit, o zinxhir e kamçik, baterma,  
Lehni, laro, kaba: Hosanna, Barabba!  
Tradhëtor, ti na nxive, na le pa atdhe,  
Ti na çthure, na çkule, na çduke çdo fë,  
Varfëri, poshtërsi, robëri ti na dhe,  
Derbeder, ujk e derr: Hosanna, Barabba!  
O stërnip i Kainit, tepdil si bari,  
Ti na shtyp e na shtryth e ti gjakun na pi,  
Ti na ther e na grin e për qejf na bën fli;  
O kokuth e lubi: Hosanna, Barabba!  
Në budrum, nëpër llom' e kufom' u mallkofsh,  
Në skëterrën, katran e tiran, u harbofsh,  
Me tam-tam e allarm' e me nëm' u shurdhofsh,  
Në zëndan mbretërofsh: Hosanna, Barabba!  
O i çgryer, i zhyer, i vyer për hu,  
Turp-e-ndot-kundërmonjës të krusen mbi gju  
Dallkaukët, kopukët e turmat pa tru,  
Zëmër-krund-e-gërdhu: Hosanna, Barabba!  
Allalla, o rezil e katil, allalla,  
Shtroni udhën me hithr' e me shtok turfanda,  
Gumëzhit, o zinxhir e kamçik, batërma,  
Lehni, laro, kaba: Hosanna, Barabba!

Lexo poezinë e dhënë dhe trego llojin letrar të saj. Poezia e dhënë është:

- a) Poezi refleksive;
- b) Poezi satirike;
- c) Poezi idilike;
- d) Patriotike.

**291.** Shiko dhe trego raportin midis autorit, subjektit lirik dhe tregimit në vargje:

Në mes tuaj kam qëndruar  
E jam duke përvëlur,  
Që t'u ap pakëzë dritë,  
Natënë t'ua bën ditë.  
Do të tretëm, të kullohem,  
Të digjem, të përvëlohem,  
Që t'u ndrinj mir' e të shihni,  
Njëri-tjatërin të njihni.  
Për ju do të rri të tretëm,  
Asnjë çikë të mos mbetem,  
Të digjem e të qanj me lot,  
Se dëshirën s'e duronj dot.  
Unë zjarrit nuk i druhem  
Dhe kurrë s'dua të shuhem,  
Po të digjem me dëshirë,  
Sa të munt t'u ndrinj më mirë.  
Kur më shihni se jam tretur,  
Mos pandehni se kam vdekur;  
jam i gjall' e jam ndë jetë  
jam në dritët të vërtetë,  
Unë jam në shpirtit tuaj,  
Mos më kini për të huaj,  
M'është falurë durimi,  
Andaj po digjem si trimi,

Në bazë të tekstit, nxirr përfundimin:

- a) Është theksuar origjinaliteti i autorit dhe i subjektit lirik
- b) Është i qartë dallimi midis autorit dhe subjektit lirik
- c) Raporti midis autorit dhe subjektit lirik nuk mund të vërehet
- d) Subjekt lirik është qiri

**292.** Llojet letrare të cilat paraqiten në letërsinë popullore dhe në letërsinë e shkruar (artistike) janë:

- a) Balada,
- b) Përralla,
- c) Poema,
- ç) Tregimi,
- d) Romani,
- dh) Kënga lirike.

Rretho shkronjat para përgjigjeve të sakta.

**293.** Fjala me të trasha në fjalinë: “Kishte gjashtë frymë për të ushqyer”, është:

- a) Metonimi
- b) Metaforë
- c) Sinekdotë
- d) Sinonim

**294.** Lexo vargjet e mëposhtme

Rini, thueja kangës ma të bukur që di!  
Thueja kangës sate, që të vlon në gji.  
Nxirre gëzimin tand, të shpërthejë me vrull.  
Mos e freno kangën! Le të marri udhë.

(Kanga e rinisë)

(...)

Por a do të vijë dita kangët me u zgjue  
Apo ndoshta shekujt me ne prapë po tallen  
Jo, Jo! Se liria filloi me lulzue  
Dhe e ndej nga Dielli (alegorik) valën.

(Migjeni)

Përgjigju në pyetjet e mëposhtme

- a) Për çka flet autori në këto vargje?
- b) A mendon poeti se ndokush mund ta pengojë lulëzimin e lirisë?

---

---

**295.** Lexoji këto vargje dhe trego si quhen?

“O, si nuk kam një grusht të fortë  
t’i bij mu në zemër malit që s’bëzanë  
ta dij dhe ai se ç’domethënë i dobët,  
n’agoni të përdridhet si vigan i vramë”

Kur vëmë re se nga një varg në tjetrin mungojnë  
rima dhe numri i caktuar i rrokjeve, siç shihet dhe  
në vargjet e sipërshtënuara të Migjenit:  
Këto quhen vargje\_\_\_\_\_.



**296.** Lexo vargjet e mëposhtme:

Emri i Zotit

Zot i vërtetë,  
Bota e tërë  
Gjithë ç'ke bërë  
E ç'ka në jetë  
Të gjitha ç'janë  
Yje dhe diej,  
E dhé e qiej,  
Një gjuhë kanë,  
Që thotë emrin tënt!  
Ngado që shikonj,  
Atë emër dëgjonj.  
E shoh më ç'do vënt.  
Dheu, që rrimë ne,

(...)

Emrin tënt thonë,  
Ty të tregojnë  
E të lëvdojnë,  
Ty gjithë monë!  
Po njeriu, o Zot!  
S'ta di emrin tënt,  
Se s'gjendet me mënt.  
Ah! S'ë thotë dot;

(Naim Frashëri)

Lexo me vëmendje dhe përgjigju:  
Si e paramendon poeti Zotin në këto vargje?

---

**297.** Autor i librit të parë të gjuhës shqipe është:

- a) Gjon Buzuku
- b) Pjetër Budi
- c) Lekë Matrënga
- d) Pjetër Bogdani

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**298.** Si quhet gruaja e murosur në kështjellën e Shkodrës, e cila e ka lënë këtë amanet i cili gjendet në këtë vjershë popullore:

Amanet – o po ju la  
Kur ne mur o do t'me muroni  
syn' e djathtë t'ma leni jashtë  
kamben e djathte t'ma leni jashtë,  
dorn' e djathte t'ma leni jashtë,  
gjinë djathte t'ma leni jashtë,  
se kam lane djalin e vogël  
e kur t'nisi djali gjamën  
me njan sy ta shikoj,  
me njan dore ta limoj  
me njan gji ta ndergoj  
me njan kambe ta lurtoj.  
Gjini em u nguroftë,  
e kalaja u forcoftë  
djali em e gezoftë!

Ajo quhet:

- a) Dhoqina;
- b) Rozafa;
- c) Nora;
- d) Teuta.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**299.** Lexo me kujdes vargjet e poshtëshënuara të Asdrenit, të cilat janë nxjerrë nga përmbledhja “Vepra të zgjedhura” :

Me sy habie shoh tej largësirën  
dhe retë nën vetull si dremitin,  
shoh rrezet qysh e prekin errësirën,  
me mijëra shtiza syresh që rrëshqitin.

Në vargun e dytë: dhe retë nën vetull si dremitin,

Cilën figurë stilistike e ka përdorur poeti:

- a) personifikimi
- b) metofora
- c) alegoria
- d) metonimia

**300.** Cila karakteristikë i përket metaforës?

- a) Vë në dukje një cilësi të sendit a frymorit
- b) Emërton një send a dukuri me emrin e një sendi tjetër
- c) I zmadhon sendet ose dukuritë
- d) Shpreh një mendim të nënkuptuar

**301.** Lexo fjalët e mëposhtme dhe shkruaj cilës figure stilistike i takojnë:

Bleta	-punë
Qengji	-ëmbëslë, pafajësi
Shqiponja	-fuqi, shqiptar, zotërim, perandori, gjeni
Gomari	-thjeshtësi, mediokritet, budallëk
Hiri	-vdekje, shkatërrim, pleqëri
Hekuri,	-durueshmëri, forcë, papërkulshmëri
Ulliri	-paqe, pafajësi,
Flutura	-lehtësi imoralitet

---

**302.** Lexo vargjet e mëposhtme dhe në vizën e mëposhtme trego prej sa rrokjesh përbëhen vargjet e dhëna:

fryn e çfryn veriu,        a  
ngrin, mërdhin i ziu  
Dhe mangallit i afrohet  
Që të ngrohet.

(Shën Pjetri mbi mangall”, Fan Noli)

---

**303.** Metonimia në vargjet: “Bota kish ndërruar lisa/ ujë i ri në det/ kaltëronte në ditën e re”, është ndërtuar:

- duke zëvendësuar shkakun me pasojën
- duke përdorur mjetin në vend të punës që kryen
- duke përdorur emrine sendit në vend të asaj që ndodhet brenda

**304.** Lexo me kujdes fjalët e Hamletit të Shekspiri:

Hamleti: E desha o Felinë! Dyzet mijë vllazër  
Me dashurinë tyre bashkë s'muntnim  
T'arrinin timen. Ç'the se bën për të?

Në këto vargje është përdorur:

- hiperbola;
- metafora;
- personifikimi;
- epiteti.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

**305.** Lexo vargjet:

Nuseja në rrugë,  
Karajfili me tubë;  
Nuseja në derë  
Karajfil me erë...

(Kangë popullore)  
Ulu, rreze malit,  
Njatje posh-o zallit,  
Me zylyf të ballit,  
ç'po i vjen era djalit,  
Si gjyljak pazarit.

Me çfarë vargu janë shkruar këto vargje.

---

**306.** Lexo fragmentin e dhënë dhe përgjigju në pyetje:

Gjeneralët e Napoleonit Davendi, Ney dhe Murati, që ndodheshin në afërsinë e rrethit të zjarrit dhe nganjëherë hynin brenda në të, hodhën shumë herë me radhë në këtë rreth të zjarrtë masa të rregullta dhe të shumta trupash. Po, në kundërshtim me sa kishte ndodhur përherë në të gjitha betejat e mëparshme, në vend që të arrinte lajmi i pritur i shpartallimit të armikut, masat e rregullta të trupave ktheheshin që andej si kope të tmerruara në rrëmujë. Ata i vinin përsëri në rregull, po numri i ushtarëve po paksohej gjithnjë. Aty nga mezi i ditës, Murati i dërgoi Napoleonit një agjutant kampi të tij për t'i kërkuar përforcime.

Napoleoni rrinte ulur poshtë kodrinës dhe pinte një ponç, kur agjutanti i Muratit arriti me vrap dhe e siguroi se rusët do të thyheshin, në rast se Madhëria e Tij do të jepte edhe një divizion.

“Përforcime!” mejttoi Napoleoni. “Si është e mundur të kërkojnë përfocime, kurse kanë në dorë gjysmën e ushtrisë së drejtuar kundër një krahu të dobët dhe të pafortifikuar të rusëve.”

Nga fragmenti që ke lexuar shkruaj cilit lloj romani i takon ky tekst:

- a) Historik
- b) Shoqëror
- c) Filozofik
- d) Psikologjik

Në planin dhe programin e lektyrës sate ke lexuar disa romane të cilat i takojnë këtij lloji:  
Thekso ndonjërin prej tyre: \_\_\_\_\_

**307.** Lexo vargjet e vjershës Mëngjesi të Lasgush Poradeci. Krahaso kuptimin e titullit me kuptimin e vargjeve të vjershës.

Si shpirt i zi në kraharuar  
U mbyll liqeri nënë male.  
Nga fundi i tij, e pasqyruar  
Po shuhet nata mengadale

Tashi dhe agimi llamburitës  
Po svagullon në fund liqeri  
Po tretet tinëz yll'i dritës  
Posi një sumbull prej sheqeri.  
Pra, ja! Pra, ja! Se dita ndezi,  
Se fund' i ujit vetëti,  
Se posi lajmëtar mëngjesi  
Del zogu i bardh'i i një nositi.

Agimi – koha kur zbardh dita

llamburitës – që bën dritë

svagullon – ndrit përsëri

Sumbull-a – kopsë, këtu: kokërr sheqeri

vetëti – këtu; u shfaq mallëngjimi

Pelikan, shpend i madh uji me pendë të bardha

Lasgush Poradeci

Pse autori ia ka dhënë titullin kësaj vjershe Mëngjesi? Kujt ia ka kushtuar këtë vjershë?

---

---

---

---

---

**308.** Lexo fragmentin nga tregimi Livadhi i D.K.

Livadhi

Shkonte pranë lumit, si Bakshi. Në ajër ndihej një aromë e ozonit e përzier me aromë të shtogut. Dheu të cilin sapo e kishte gërmuar urithi dukej i skuqur si dregëza. Kur përnjëherë doli dielli. Në livadh u paraqitën luleshqerrat. Kamomilja lëshoi aromë, pastaj u mbush ajri me një mori aromash. E shikonte se si qeni i tij e kafshonte lulen e pranverës, derisa nga feçka i rridhnin jargët e gjelbërta. Pastaj edhe ai u shtri në bark, afër urithit i cili avullonte si kulaç. E kafshonte me dhëmb gjethin e lëpjetës së egër ende të njomë.

Ishte zbathur, me pantallona të shkurtër blu nga liri. Midis gishtërinjëve në duar i dukeshin dregëzat e zgjebes.

Nënvizo në tekst përshkrimin e natyrës i cili në mënyrë figurative dhe sipas kuptimit ka të bëjë me pamjen e duarve të heroit nga ky fragment.

**309.** Në një poezi ku poeti bënë fjalë për gjendjen e vështirë të popullit të tij nën sundimin e feudalëve, derbederëve, mercenarëve dhe fashizmit italian, përveç tjerash ai thotë

( Dhe një zë vëngon nga lumi,  
Më buçet, më zgjon nga gjumi  
se mileti po gatitet  
se tirani lebetitet,  
se pelcet, kercet furtuna,  
fryhet Vojsa, derdhet Buna)

Për kryeveprën e cilit shkrimtar është fjala?

Si quhet titulli - \_\_\_\_\_

Cili është autori - \_\_\_\_\_

Cilës gjini letrare i përket vepra- \_\_\_\_\_

**310.** Lexo vargjet nga Ninulla popullore Nina-nana djalin

**Nina – Nana djalin...**

Nina-nana, o more bir,  
Flej se gjumi të ban mirë  
Të ban mirë e të rehaton,  
Shtatin, bir, ta pushton.

Gjumi, gjumi rehatshumi,  
Vjen me të marrë porsi pëllumbi  
Nina-ninë sheqer në letër,  
M'u bafsh, bir, plak i vjetër!  
Ç'po i këndon-o djali djepit  
Si bylbyli në gemb të plepit.

Gemb – bisku, dega

Flej, o djalë, ti flesh i bardhë  
E gjithkund t'u dhashtë mbarë!  
Ma gzosh emnin që ta kam ngjitë  
Mori mollë, ma gëzofsh të ritë!  
Lumja nana, bir, që të ka,  
Bir që t'ka edhe të pastë,  
Me të mirë mprapa të lantë  
Të mira, bir, sa zemra të dashtë!

Për çfarë poezie bëhet fjalë në këtë tekst?

Për poezinë:

- a) E cila vështirë kuptohet;
- b) Me ndjenja të sinqerta;
- c) Me urime të përzemërta;
- d) Pa rimë.

**311.** Lexo vjershën “Lora” të Ismail Kadaresë, e pastaj përgjigju në pyetje.

Tani shiu godet me shkelma xhamat.  
Atje qielli i zi si negativi i një shkretëtire.  
Lora,  
Më ka marrë malli  
Malli bojë hiri.  
Tani natë si një mbulesë vigane  
Qëndisur me drita anëve,  
Karfosur me paralele dhe meridianë  
Nga lindja në perëndim  
Na mbulon e shqetësuar.  
Ne shtrihemi nën të,  
Si në ethe zbulohemi  
Të ndarë,  
Të largët,  
Të vetmuar.

Lexo vjershën „Lora“ të Ismail Kadaresë. Me fjalët e tua arsyeto pse mendon se shkrimtari ka dhënë një pasqyrë reale të hidhërimit dhe të vuajtjes për shkak të dashurisë ose pse nuk e ka arsyetuar këtë ndjenjë. Thekso së paku dy shkaqe.

---

---

---

**312.** Lexo fragmentin nga romani “Eleganca e iriqit “ e Mjuriel Barbarit. Në këtë fragment autori është përpjekur që në mënyrë figurative të përshkruajë një familje.

Nëse doni të kuptoni familjen tonë, vetëm shiko macet. Dy macet tona janë trashulaqe të cilat nuk kanë kurrfarë afrie të përbashkët me njerëzit. Zvarriten nga një krevat në tjetrin, kudo i gjen qimet e tyre, dhe askush sikur nuk e ka kuptuar se ato ndaj askujt nuk e kanë as simpatinë më të vogël. Të vetmen dobi nga macet e kemi se janë sende stolisëse që lëvizin, gjë nga pikëpamja intelektuale është interesant koncepti, por nuk mund të aplikohet në këto tonat, sepse e kanë barkun mjaft të lëshuar.

A e ka realizuar autori me sukses qëllimin e vet?

PO JO

Arsyetoje përgjigjen tënde duke iu referuar tekstit.

---

---

---

---

**313.** Lexo me kujdes vargjet e mëposhtme:

JA TOKA IME

Ja toka ime, - mes dritash kredhur  
Mes brohorish të gëzueshme Mesdheu  
Shtatin me malet në qiell hedhur,  
nga grykë e Vjosës  
nga grykë e Bunës,-  
gurgull legjendash  
e zemrash dheu.

Ja toka ime, - e ashpra, e buta.

Një krismë pushke

Pastaj lahuta

Një piramidë.

Një lapidar.

Linja tensioni që ecin tutje.

Ja toka ime -

Me statuja mbjellë

E fragmente shekujsh të mermertë në zemër.

Lexoni vargjet dhe thuani kush i ka shkruar këto vargje?

Kur lindi poeti?

**314.** Lexo fragmentin e dhënë nga drama “Burri i dheut” i Andon Zako Çajupit shkruaj kujt ia dedikon autori këtë dramë dhe ku zhvillohet ngjarja?:

**Fragment nga drama “Burri i dheut”**

Murati\*)

Ndëgjo mirë se ç'të themi,  
Të duamë gjithë ç'jemi  
sulltana, një shqipëtarë,  
të mban për drek' e për darkë,  
dhe unë, ti e di vetë,  
të nderoj me të vërtetë,  
të mirat që të kam bërë  
i di, zonjë, bot' e tërë.  
Të dua si time bijë,  
prandaj rende mos te vije,  
Tani nder' i Shqiperise  
dhe madhëri e Turqisë  
një punë nga ti kërkojnë  
dhe mir e ndë paq' të rrojnë.



Duhetë, ti dhe Selimi,  
q'u rrëfye kaqë trimi,  
me luftëra që ka bërë  
q'ë lëvdon një bot' e tërë,  
duhetë, them të bashkoni  
dhe që sonte, të martoni.  
Të kam dashur si një pjellë,  
shumë ligsht më je sjellë,  
po shumë do të të dua,  
zonjë, po të ndëgjosh mua,  
ndryshe do të qash me lot,  
se me mua s'ë nxjerr dot.

(...)

Sot lajme të mira mora:  
të ka shpëtuar nga dora  
Skënderbeu Kastrioti.  
im vëlla, me faltë zoti.  
Nështë e vërtetë kjo fjale,  
në kam sot vëlla të gjallë,  
është mbret' i Shqipërisë,  
dridhu, sulltan' i Turqisë,  
dhe futu vëtë mbë vërë,  
se shumë faje ke bërë.

(...)

Mamica

S'ë dua. se e ke djalë')  
mos ma trego, e di vetë  
q'është trim me të vërtetë;  
vendet që ka sot ndër duar,  
ay trim i ka zotuar;  
tërë bota e lëvdojnë  
me gisht të tër' e tregojnë,  
Selimi shum' u ndëgjua.  
Do të qe burrë për mua,  
të mos e keshe ti djalë,  
këtë trim kaqë të rrallë.  
Murat, preje këtë shprese,  
hiq dorë nga kjo martesë,  
se Selimi zëmërmirë  
s'ka sot të tillë dëshirë,  
dhe di që s'mund ta marre burre,  
kjo krushqi s'bëhet dot kurrë,  
Mamica, të thonë, mori  
të bir' e një gjakëtori?  
Ku e botoi autori Dramën?

---

---

---

**315.** Lexo vargjet nga poema “Bagëti e bujqësi” të Naim Frashërit.

O malet e Shqipërisë e ju, o lisat e gjatë,  
fushat e gjera me lule q’u kam ndër mend dit ` natë,  
ju, bregore bukuroshe, e ju, lumenjt’ e kulluar,  
çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pyje të gjelbëruar,  
do të këndoj bagëtinë që mbani ju e ushqeni  
o vendëthit e bekuar ju mendjen ma dëfreni

(...)

Kur dëgjon zëthin e sëmës qysh e lë qingji kopenë  
blegërinë dy a tri herë edhe ikën e merr dhenë,  
edhe në i prefshin udhën njëzet a tridhjetë vetë,  
e ta trembin ai s’kthehet, po shkon në mes si shigjetë.  
Ashtu dhe zemra ime, më lë këtu, tek jam, mua,  
vjen me vrap e me dëshirë aty, në viset e tua.

(...)

Ti Shqipëri, më ep nder, më ep emrin shqipëtar,  
zemrën ti ma gatove plot me dëshirë e me zjarr.

Për çka shkruan poeti? Shkruaj për ndjenjat dhe për shqetësimet e tij të cilat i shpreh në këtë poemë.

---

---

---

---

---

---

---



## Zgjidhjet

1. d) informon
2. b) letrar
3. b) Informues
4. a) Paraqit argumente për një çështje, vërtetoj me argumente, sjell prova.
5. b) Emra;
6. a) P,  
b) Sh,  
c) A
7. a) P (publicistik)  
b) A (administrativ)
8. a) stilit shkencor, joletrar;
9. a) 107-110  
b) 110
10. c) citat
11. a) Gjahu i malësorëve
12. a) citat
13. a) Qengji që ra në ujë quhet Curri
14. 1. Viti 1907;  
2. Vëllezërit Manaki;  
3. Nga viti 1930.
15. b) tekst informativ
16. - poeti francez La Fonteni;  
- një mik i tij  
- kam futur helm brenda në të  
- desha të di, kush e ka ngrënë mollën.
17. c) Qeni e shpëtoi qengjin
18. “Gjatë njëzet minutave të fundit, - ne ju paraqitëm shkaqet kryesore pse fëmijët po i braktisin shkollat gjithnjë e më shumë. Të dhënat e mbledhura tregojnë qartë se shkaqet kryesore janë varfëria në rritje, niveli i ulët i mësimdhënies dhe i kushteve të mësimin në shkollë, si dhe problemet esenciale në familje. Çështja është se çfarë duhet bërë përtej këtij konstatimi. Të gjithë, që nga organet e larta të pushtetit deri te qytetari më i thjeshtë, kemi përgjegjësi për fatin e këtyre fëmijëve. Përgjegjësia e disave është ligjore. – e të tjerëve, morale. Edhe sa kohë do të vazhdojmë kështu, duke bërë një sy qorrr dhe një vesh shurdh?

- 19.** Të ndalohet ngrohja globale  
Në Berlin u mbajt Konferenca Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për mjedisin. Merrnin pjesë 2000 veta nga 170 vende të botës. Konferenca u drejtoi një apel vendeve të industrializuara dhe vendeve tjera që të mbrojnë mjedisin jetësor dhe të pakësojnë gazin karbonik të hedhur në hapësirë, që shkakton efektin serë. Vendet e Bashkimit Evropian kanë vendosur që pas vitit 2000 të mos e rrisin sasinë e gazit karbonik që hedhin në hapësirë. Këtë shembull duhet ta ndjekin edhe vendet e tjera të industrializuara.  
Pasojë e problemeve serioze të teknologjisë  
Rritja e rrezatimit  
Dyfishimi i dioksidit të karbonit
- 20.** “Është provuar se neurogjeneza, simptomi i mirëqenies së trurit zgjat gjithë jetën”. Kjo mund të arrihet duke mos e lënë trurin të gjenerojnë drejt plakjes. Mirë është ta stërvitësh atë pavarësisht moshës, por jo me aktivitete pasive si shikimi i televizorit, por me stimuj të rinj kulturorë, si loja me letra, zgjidhja e fjalëkryqeve dhe njohja e njerëzve të rinj. Por sot dihet edhe një tjetër faktor i rëndësishëm: kujdesi i nënës në fëmijëri.
- 21.** a) Qengji ( Curri ) ra në ujë 4;  
b) Djemtë u mërztën shumë për qengjin ( Currin ) dhe qenin 3;  
c) Qeni e shpëtoi qengjin ( Currin ) 5
- 22.** 2,  
3,  
4,  
1
- 23.** a) parashtrimi  
d) zgjidhja e konfliktit
- 24.** Për një çast mbeta si i ngrirë, pastaj vrapova jashtë, duke bërëtitur nga qejfi e duke përqafuar të gjithë ata që takoja. Gjithçka kishte shkuar për mirë. Në rregull. Por vitin tjetër nuk dua ta përsëris më këtë përvojë të keqe.
- 25.** Përgjigja është: simes
- 26.** c) stilin gazetaresk
- 27.** trajtat e shkurtra të bashkuara.
- 28.** 17,4% e qytetarëve e shikojnë programin televiziv
- 29.** Pjesët e ligjëratës janë:  
Emri Ndajfolja  
Numërori Lidhëza  
Mbiemri Pjesëza  
Përemri Parafjala  
Folja Psthirrma
- 30.** p. sh. - Agron Ibrahim  
- “Naim Frashëri” Bujanoc  
- E tetë  
- 12 lëndë  
- të shkëlqyeshëm  
- 4,87  
- Gjuha dhe letërsia shqipe
- 31.** Në secilën fjali vlerësohet a është e kuptueshme ajo dhe a është në rregull në kuptimin gramatikor.

- 32.** Përngjitja u bë në tri mënyra:  
 1) me bashkëngjitjen e dy shkronjave të njëjta  $l + l = ll$ ,  $r + r = rr$   
 2) me bashkëngjitjen e dy shkronjave të ndryshme kur e dyta është j:  $g+j = gj$ , dhe  $n+j = nj$   
 3) duke bashkuar një shkronjë me shkronjën h:  $d+h = dh$ ,  $t+h = th$ ,  $z+h = zh$
- 33.** Në secilën fjali vlerësohet a është e kuptueshme ajo dhe a është në rregull në kuptimin gramatikor.
- 34.** Fjalja vlerësohet sa është e kuptueshme dhe sipas rregullave gramatikore.
- 35.** baballarë, etër
- 36.** b) Jo formale
- 37.** Kjo punë nuk mund të përfundohet brenda një dite, as edhe brenda një nate.  
 Ti do të mendosh gjatë , do të gjeshë idetë për të sajuar një tregim fantastik si ky.
- 38.** a) Përgjigjja: c) p , b, m, f, v
- 39.** *Unë jam nxënës në shkollën "Dituria".*
- 40.** 1. *Taulanti dhe Leonora, në orën e gjuhës shqipe treguan tregime të bukura.*
- 41.** d) kërkesë (lutje)
- 42.**

Paraqitem për regjistrim në _____ <b>GJIMNAZ</b> _____ (emërtimi i shkollës së mesme)	
në	
Profili arsimor për shkollë profesionale, përkatësisht për gjimnaz:	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	Ron Shkoza
Dita, muaji dhe viti i lindjes	14.11.1996
Emri dhe mbiemri i babait, profesioni i tij dhe adresa	
Emri dhe mbiemri i nënës, profesioni dhe adresa	
Emri dhe mbiemri i kujdestarit, profesioni i tij dhe adresa (nëse nxënësi nuk ka prindër)	
Adresa e nxënësit: komuna, vendbanimi, rruga dhe numri	

- 43.** p.sh - Valon Musliu  
 -03.07.1990  
 -Tërnoc  
 -për çertifikatë të lindjes  
 -Zyrës se Vendit Tërnoc  
 -84000-69-75-19000  
 -20.06.2012 Tërnoc
- 44.** p. sh. - Agron Ibrahim  
 - "Naim Frashëri" Bujanoc  
 - E tetë  
 - 12 lëndë  
 - të shkëlqyeshëm  
 - 4,87  
 - Gjuha dhe letërsia shqipe  
 - në "Sezai Surroi" në Bujanoc
- 45.** Presja vihet pas këtyre fjalëve: Në mbrëmje, u ngrys, brenda, fyejsh, lahutash, i një shtëpie,

46. “Gjithnjë më ka pëlqye futbollli. Ndashja e zhvilluar të dielën ishte shumë tërheqëse. Si skuadra jonë ashtu edhe ajo e “Besës” luanin mjaftë mirë. Loja bëhej më e rreptë dhe më e bukur pas çdo goli”
47. c) Letër
48. MCMXCIX  
XV  
CDXLVII  
XII
49. c) Tregti, arsye, trathti
50. c) Vetat e njëjësit të së kryerës së thjeshtë
51. a) Fonemat zanore: a-e; e-ë; ë-ë; o-ë; u-ë; y-i  
